



Projekt i financuar nga  
Bashkimi Evropian



QENDRA E SHËRBIMEVE  
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA  
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



**Save the Children**

# Angazhimi Qytetar për Sistem Gjyqësor FunkSIONAL dhe Qasje në Drejtësi në Shqipëri

*Arritjet, Gjetjet dhe Rekomandimet nga Organizatat e  
Shoqërisë Civile për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri*

**Tiranë, 2019**

## Falënderime

Ky raport u hartua nga konsulentja e jashtme Mirela P. Bogdani në kuadrin e “Angazhimit Qytetar për Sistem Gjyqësor Funkcional dhe Qasje në Drejtësi në Shqipëri” (AQSGJFQDSH), i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children Shqipëri, në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI).

Për përmbajtjen e këtij raporti mban përgjegjësi vetëm konsulenti i jashtëm dhe pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe QSHPLI-së.

Botuar nga Save the Children

Rruga Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji (Vila Lami); Kutia Postare 8185, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2261840/2261929 E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo shumëfishohet lirisht për qëllime jotregtare, përmes çfarëdolloj metode, me kusht që çdo shumëfishim të shoqërohet me miratimin e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe QSHPLI-së.

Tiranë, shtator 2019

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>Shkurtesa</b> .....	5
<b>I. Hyrje</b> .....	6
Informacion për historikun e AQSGJFQDSH-së .....	6
Konteksti shqiptar.....	7
<b>II. Metodologjia</b> .....	9
<b>III. Çështjet kryesore të trajtuara nga projektet e financuara me nëngrante</b> .....	10
Çështjet kryesore mbi Qasjen në Drejtësi të trajtuara nga projektet e financuara me nëngrante.....	10
Çështjet kryesore mbi Monitorimin e Institucioneve të Drejtësi të trajtuara nga projektet e financuara me nëngrante.....	13
<b>IV. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËNGRANTE</b> .....	16
<b>IV. I. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËNGRANTE</b>	
<b>MBI QASJEN NË DREJTËSI</b> .....	16
1. Organizata: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë/ TLAS .....	16
2. Organizata: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara/FSHDPAK .....	17
3. Organizata: Të ndryshëm & të Barabartë/D&E.....	19
4. Organizata: Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë/ QSNNN.....	21
5. Organizata: Shoqata Komuniteti Papa Gjon XXIII.....	22
6. Organizata: Together for Life/ Së Bashku për Jetën .....	24
7. Organizata: Streha .....	25
8. Organizata: Rromano Kham .....	27
9. Organizata: Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale/ ALTRI .....	28
10. Organizata: Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik/IPSED .....	30
11. Organizata: Fondacioni Shqiptar “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”/ AFCE .....	31
12. Organizata: Meridia.....	33
13. Organizata: Young Man Christian Association/YMCA.....	35
14. Organizata: Për ju nëna dhe fëmijë.....	36
15. Organizata: Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza/ LKGV .....	38
16. Organizata: Qendra Psiko-Sociale “Vatra” .....	40

17. Organizata: Lëvizja Rinore për Demokraci/LRD .....	42
18. Organizata Rrjeti i Grave në Demokraci/WDNA .....	44
19. Organizata: Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale/CDRW .....	45

#### **IV.II. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËN GRANTE MBI**

<b>MONITORIMIN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË .....</b>	<b>47</b>
1. Organizata: Instituti për Studime Publike dhe Ligjore/ISPL.....	47
2. Organizata: Qendra Evropiane/EC.....	49
3. Organizata: Instituti për Politika të Qëndrueshme/ISP.....	51
4. Organizata: Qendra për Zhvillim dhe Integrim Demokratik/QZHID.....	53
5. Organizata: Qendra për Zhvillimin Komunitar “Sot për të Ardhmen”.....	55
6. Organizata: Qendra EDFAT:.....	57
7. Organizata: Qendra për Edukimin Social dhe Mbrojtjen e Mjedisit/SEEP.....	58
8. Organizata: Njerëz në Fokus/PF.....	60
9. Organizata: Komiteti Shqiptar i Helsinkit/KSHH .....	63
10. Organizata: Instituti për Kontratën Sociale/SCI.....	65
11. Organizata: Instituti i Migracionit, Zhvillimit dhe Integritimit/IMZHI.....	67
12. Organizata: Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe të Torturës/QSHRTT ...	69
13. Organizata: Fondacioni Progres/FP .....	71
14. Organizata: Antigonea .....	73
15. Organizata: Shoqata e Gazetarëve Profesionistë Rajonalë/ARPJ .....	75

#### **V. PËRFUNDIME .....**

<b>PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËN GRANTE MBI QASJEN</b>	<b>77</b>
<b>NË DREJTËSI.....</b>	<b>77</b>
<b>PËRFUNDIMET E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËN GRANTE .....</b>	<b>79</b>
<b>MBI MONITORIMIN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË.....</b>	<b>79</b>

#### **Shtojca 1: Lista e kontakteve të OSHC-ve .....**

## Shkurtesa

<b>GJA</b>	- Gjykata e Apelit
<b>GJASHP</b>	- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë
<b>QD</b>	- Qasje në Drejtësi
<b>KED</b>	- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
<b>KP</b>	- Kodi Penal
<b>AQSGJFQDSH</b>	- Angazhimi Qytetar për Sistem Gjyqësor Funkcional dhe Qasje në Drejtësi në Shqipëri
<b>KKEED</b>	- Këshilli i Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
<b>QSHPLI</b>	- Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara
<b>NJMF</b>	- Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës
<b>KDPAK</b>	- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>GJRR</b>	- Gjykatat e Rrethit
<b>KEDNJ</b>	- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>GJEDNJ</b>	- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>DHBGJ</b>	- Dhunë me Bazë Gjinore
<b>PGJ</b>	- Prokurori i Përgjithshëm
<b>DHGJ</b>	- Dhunë Gjinore
<b>KLGG</b>	- Këshilli i Lartë Gjyqësor
<b>UMM</b>	- Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
<b>DM</b>	- Drejtësia për të Mitur
<b>KDM</b>	- Kodi i Drejtësisë për të Mitur
<b>NJQV</b>	- Njësitë e Qeverisjes Vendore
<b>MM</b>	- Memorandum Mirëkuptimi
<b>DK</b>	- Deputet Kuvendi
<b>ZSHP</b>	- Zyra e Shërbimit të Provës
<b>ELP</b>	- Edukimi Ligjor i Publikut
<b>UM</b>	- Urdhrat e Mbrojtjes
<b>SHM</b>	- Shkolla e Magjistraturës
<b>PP</b>	- Prokurori i Përgjithshëm
<b>SC</b>	- Save the Children
<b>SPAK</b>	- Struktura e Posaçme Antikorrupsion
<b>SELP</b>	- Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut
<b>NVA</b>	- Ndërmjetësimi viktimë-autor

## I. Hyrje

Ky raport paraqet arritjet, gjetjet dhe rekomandimet kryesore të projekteve të 34 OSHC-ve të financuara përmes nëngranteve, të zbatuara në kuadër të AQSGJFQDSH-së (Angazhimi Qytetar për Sistem Gjyqësor Funkcional dhe Qasje në Drejtësi në Shqipëri), një nismë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe e zbatuar nga Save the Children (SC) dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), me qëllim dhënien e kontributit në fuqizimin e shoqërisë civile për pjesëmarrje aktive dhe ushtrim të ndikimit në funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor në Shqipëri.

Ky dokument ndahet në 5 pjesë si vijon: prezantim i shkurtër i AQSGJFQDSH-së dhe partnerëve zbatues (SC dhe QSHPLI); metodologjia e ndjekur për hartimin e raportit; vështrim i përgjithshëm i dy fushave kryesore të ndërhyrjes së projekteve të financuara me nëngrante (monitorimi i sistemit të drejtësisë dhe qasjes së grupeve të cënueshme në drejtësi); arritjet, gjetjet dhe rekomandimet e 34 të financuarve me nëngrante; përfundimet.

Ky punim synon kryesisht të ndajë me palët e interesit<sup>1</sup> tablonë reale të gjendjes aktuale të sistemit gjyqësor nga pikëpamja e shoqërisë civile dhe t'i ofrojë institucioneve të gjyqësorit, si dhe vendimmarrësve në rang kombëtar disa sugjerime dhe zgjidhje të mundshme se si sistemi i drejtësisë në Shqipëri të bëhet më llogaridhënës, transparent dhe i qasshëm për kategoritë e cënueshme.

## Informacion për historikun e AQSGJFQDSH-së

Nisma e AQSGJFQDSH-së, e cila u zhvillua nga Save the Children<sup>2</sup> dhe QSHPLI-ja<sup>3</sup> së bashku, është një projekt 45 mujor (Janar 2016-Shtator 2019) që synon fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor dhe përmirësimin e qasjes së grupeve të cënueshme në Shqipëri në drejtësi. Projekti kishte si objektiv kryesor grupet e OSHC-të. Përfituesit fundorë të tij ishin grupet e cënueshme (veçanërisht të miturit në kontakt me ligjin, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e DHBGJ-së dhe DHF-së), profesionistët që operojnë në sektorin e drejtësisë, autoritetet vendore dhe qendrore, si dhe institucionet e gjyqësorit.

Projekti, i cili përfshin të gjithë vendin, ka tre komponentë kryesorë:

- 1) Program për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve që punojnë në fushën e Drejtësisë dhe të Drejtave të Njeriut për zhvillim organizativ, menaxhim projekti, advokaci dhe lobim, udhëzime ndërkombëtare dhe praktikant më të mira të lidhura me drejtësinë.
- 2) Skemë nëngrantesh për financimin e 34 OSHC-ve të përzgjedhura për zbatimin e ndërhyrjeve në fushat e monitorimit të sistemit të drejtësisë dhe qasjes së kategorive të cënueshme në drejtësi.
- 3) Ngritjen e rrjetit të shoqërisë civile (Koalicioni Drejtësi për të Gjithë) për ndërmarrjen e nismave të përbashkëta të advokacisë, si dhe ndarjen e informacioneve dhe praktikave më të mira në sektorin e drejtësisë.

---

1. Institucionet shtetërore, institucionet e gjyqësorit (gjykatat e rrethit dhe të apelit, prokuroritë, burgjet, zyrat e shërbimit të provës, drejtoritë e policisë etj.), profesionistët (avokatët, gazetarët, psikologët, ndërmjetësit etj.), OSHC-të dhe organizatat ndërkombëtare.

2. Save the Children është një Organizatë Ndërkombëtare që punon në 120 vende. Misioni i saj është që bota t'i shohë fëmijët me sy tjetër, si dhe të sjellë ndryshime të menjëhershme e afatgjata në jetën e tyre.

3. QSHPLI-ja është një organizatë vendore që ka qenë funksionale në Shqipëri që prej vitit 2000. Misioni i saj është t'i ndihmojë personat e cënueshëm, duke përfshirë fëmijët, t'i qasen sistemit të drejtësisë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e sistemit gjyqësor.

Ai i mundësoi 34 OSHC-ve që të ofronin një sërë shërbimesh dhe produktesh si: mbështetje ligjore për grupet e cënueshme; ndërmjetësim viktimë-autor; promovim dhe mbështetje për ekzekutimin e masave alternative; ngritje kapacitetesh për profesionistët, duke përfshirë oficerë policie, avokatë, prokurorë dhe gjyqtarë; advokaci me të gjitha palët përkatëse të interesit mbi të drejtat e viktimës; informim dhe edukim ligjor për publikun (të rinj, profesionistë ligjorë, aktivistë të shoqërisë civile, gazetarë etj.) mbi disa tema (kuadrin ligjor, reformën në drejtësi, ndihmën ligjore falas, mbrojtjen e viktimave të trafikimit, dhunës në familje, DHBGJ-së etj.); monitorim i institucioneve të gjyqësorit (gjykatat, qendrat e paraburgimit etj.), hartim i raporteve të vlerësimit, si dhe riintegrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin.

OSHC-të e përfshira në nismë i zbatuan projektet e financuara me nëngrante në përputhje me ekspertizën e tyre dhe zonën gjeografike të ndërhyrjes, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse vendore dhe institucionet e gjyqësorit. Ata u përzgjodhën në bazë të dy Thirrjeve për Propozime (të shpallura në Prill dhe Nëntor 2017). 10 prej tyre përfituan një grant deri në 50,000 euro, 12 deri në 25,000 euro dhe 12 të fundit deri në 15,000 euro. Kohëzgjatja e projektit luhatej nga 7 deri në 20 muaj (dhjetor 2017 - qershor 2019). Të 34 OSHC-të janë mbështetur vazhdimisht nga SC-ja dhe QSHPLI-ja që prej fillimit të projekteve përmes ofrimit të instrumenteve të posaçme (për planifikimin, monitorimin, menaxhimin financiar, mbrojtjen e fëmijës, rregullat e vizibilitetit etj.), organizimin e vizitave në terren dhe zhvillimin e mbledhjeve për trajtimin e aspekteve financiare, programatike dhe operacionale.

## Konteksti shqiptar

Shqipëria ka ndërmarrë disa reforma themelore për axhendën e hapjes së negociatave me BE-në, ndër të cilat mund të përmendim reformën në drejtësi, që synon luftën ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e gjyqësorit, institucione shtetërore dhe në shoqëri në përgjithësi, duke forcuar shtetin e së drejtës dhe vlerat themelore demokratike. Reforma në drejtësi bazohet kryesisht te procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i shoqëruar me nismat e ngritjes së institucioneve të reja të qeverisjes së gjyqësorit dhe miratimin e disa ligjeve për përmirësimin e gjendjes dhe mënyrës së operimit të gjyqësorit, duke rritur performancën, efikasitetin dhe qasjen në institucionet e drejtësisë.

Progres Raportet e BE-së për Shqipërinë theksojnë problematikat e lidhura me efikasitetin dhe cilësinë e sistemit të drejtësisë ku konstatohet se “Sistemi gjyqësor në Shqipëri nuk është efikas, nëse i referohemi kohëzgjatjes së procedurave, raportin çështje të zgjidhura-çështje të depozituara dhe çështjet pezull në të gjitha shkallët e gjykatave”.<sup>4</sup> Monitorimi i mënyrës së funksionimit të institucioneve të drejtësisë është thelbësore për mënyrën e operimit të përditshëm, mënyrën se si i ofrojnë qytetarëve shërbime, deri në ç’skallë i përmbushin standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si e vendosin drejtësinë në vend, si i bëjnë publike aktivitetet për të informuar qytetarët, nëse veprojnë brenda afateve kohore të arsyeshme apo nëse hasin vonesa gjatë kryerjes së aktivitetit për arsye objektive ose subjektive, si i ofrojnë shërbimet administrative, si koordinohen midis tyre etj. Nga ana tjetër, monitorimi i ndihmon ata të vlerësojnë pozitat e tyre, ta masin aktivitetin me syrin e një të jashtmi, të mbështesin punën e organizatave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri<sup>5</sup> dhe të kontribuojnë në përmirësimin e performancës bazuar në rezultate.

4. Për informacione të mëtejshme shihni “Progres Raportin e BE-së për Shqipërinë, 2018” - Efikasiteti i sistemit të drejtësisë, f. 21/4. Raporti më i ulët çështje të zgjidhura-çështje të depozituara vërehet te gjykatat e apelit, veçanërisht te Gjykata Administrative e Apelit (37 %) për shkak të numrit të lartë të apeliave dhe numrit të ulët të gjyqtarëve të caktuar në këtë gjykatë. Raporti më i lartë çështje të zgjidhura-çështje (100 %) vërehet te gjykata e krimeve të rënda të shkallës së parë. Numri më i lartë i çështjeve pezull konstatohet në Gjykatën e Lartë (çështjet e mbartura përlllogariten në 22,500 çështje).

5. Delegacioni i BE-së, KiE, Euralius, etj. Për informacione të mëtejshme, shihni “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, hartuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, qershor, 2015, 4.1. Struktura e qeverisjes së Administratës së Drejtësisë dhe aktorët e palët kyçe të interesit.

Për informacione dhe të dhëna të mëtejshme mbi organizimin e gjykatave referojuni Kuadrin Institucional “Kapacitet e Organizimit të Gjykatave dhe Administratorëve të Gjykatave në Shqipëri: Studimi i parë eksplorues”, përgatitur nga SEJ I “Mbështetja e Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri.

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri vuan nga fenomeni i korrupsionit dhe influencat e jashtme gjatë vënies së drejtësisë në vend, niveli i ulët i profesionalizmit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë, efikasiteti i dobët i gjykatave, mungesa e stafit gjyqësor, mungesa e mbështetjes së mjaftueshme nga shërbimet administrative, infrastruktura e papërshtatshme, vonesat gjatë proceseve gjyqësore, etj.<sup>6</sup> Pjesëmarrja e publikut nuk garantohet plotësisht në asnjë gjykatë të çfarëdo shkalle qoftë ajo dhe grupet e cënueshme të qytetarëve hasin shumë vështirësi në qasjen e institucioneve të drejtësisë. Një pjesë e konsiderueshme e proceseve gjyqësore zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, pasi në shumicën e gjykatave mungojnë sallat publike të gjyqit. Për më tepër, vërehet mungesa e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe faqeve të internetit, çka e bën të pamundur qasjen në vendimmarrjen publike apo në procese gjyqësore. Shqipëria është një prej vendeve me raportin më të ulët të numrit të stafit gjyqësor administrativ dhe numrit të gjyqtarëve, përkatësisht 3 punonjës për gjyqtar, çka është nën standardin mesatar evropian.<sup>7</sup>

Përpjekjet për të përmirësuar sistemin e drejtësisë nuk kanë reshtur deri më sot, por praktikisht këto përpjekje kanë qenë të pjesshme pasi kanë synuar përmirësimin e sistemit përmes masave me natyrë operacionale, si modernizimit të infrastrukturës, vënies në përdorim të pjesshëm të teknologjisë së informacionit për përmirësimin e komunikimit me publikun etj.<sup>8</sup>

---

6. *Po aty*. "Efikasiteti i Gjyqësorit", f. 106/-107.

7. Për informacione dhe të dhëna të mëtejshme mbi gjyqësorin në Shqipëri, referojuni dokumentit "Raporti i Vlerësimit Rrënjësor të Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri" Jacques Bühler & Jon Johnsen, 2015, SEJ I – Mbështetja e Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri - Projekt i BE/KiE-së; <https://rm.coe.int/eu-coe-support-to-efficiency-to-justice-sej-a-joint-project-between-th/1680788435>

8. Shihni "Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", hartuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, qershor, 2015, Kreu I - Hyrje.



## II. Metodologjia

Ky raport u hartua përmes një metodologjie të miratuar paraprakisht, që ndërthurte shqyrtimin e raporteve të zbatimit të projekteve, metodologjinë e përdorur në secilin projekt për arritjen e qëllimit dhe objektivave, mbledhjen e të dhënave dhe studimin veçanërisht të projekteve që trajtonin performancën e institucioneve të drejtësisë. Të gjitha OSHC-të u treguan të disponueshme për të ofruar bashkëpunim të plotë dhe informacionin e nevojshëm.

Procesi i hartimit përfshiu hapat e mëposhtme:

- Shqyrtimi i dokumentacionit të të financuarve me nëngrante (propozimet e projektit, raportet përshkruese, planet e monitorimit dhe vlerësimin, produkte si raportet e monitorimit dhe vlerësimin për performancën e institucioneve të gjyqësorit).
- Hartimi dhe dorëzimi i Fletushkës Informuese në çdo OSHC, të ndarë në seksionet e mëposhtme: informacion i përgjithshëm mbi OSHC-në dhe projektin (titulli i projektit, fusha tematike kryesore, përfituesit e projektit dhe grupet e synuara, afati kohor i projektit, objektivat kryesore, stafi i projektit, arsyetimi shkurtimisht i projektit); aktivitetet e projektit; institucionet e drejtësisë të përfshira; metodologjia e projektit; treguesit (*cilësorë/sasiorë*); rezultati dhe ndikimi i projektit; gjetjet, (*duke përfshirë të dhëna, por edhe informacion josasior*), rekomandime (*për institucionet e drejtësisë dhe/ose institucionet e tjera të përfshira në projekt*); praktikat më të mira të evidentuara gjatë zbatimit të projektit; sidat dhe kundërmasat përkatëse.
- Analizimi i të gjithë informacionit të mbledhur dhe organizimi i mbledhjeve me disa OSHC për informacione dhe qartësime të mëtejshme.
- Hartimi i raportit me në fokus problematikat tematike të hasura nga të financuarit me nëngrante dhe arritjet kryesore të projekteve të tyre, së bashku me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Përfundimet përfshijnë të përbashkëtat e projekteve, sfidat më të rëndësishme dhe pikëpamjet.

Gjatë ravijëzimit të raportit, u hasën disa vështirësi me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe informacioneve nga projektet për shkak të metodologjive të larmishme të përdorura nga çdo i financuar me nëngrant, zonat e ndërhyrjes, tipologjisë së aktiviteteve, grupeve të synuara dhe problematikave të hasura. Megjithatë, krahas ndryshimeve, u arrit të identifikoheshin disa aspekte të përbashkëta dhe u arrit të lërohej rruga për programet e ardhshme në fushën e qasjes dhe monitorimit të institucioneve të drejtësisë.

### III. Çështjet kryesore të trajtuara nga projektet e financuara me nëngrante

Të financuarit me nëngrante në kuadrin e AQSGJFQDSH-së i prezantuan projektet e tyre bazuar në çështjet e lidhura me dy kategori kryesore (1) Qasjen në drejtësi dhe (2) Monitorimin e institucioneve të drejtësisë. Më poshtë paraqiten çështjet kryesore të evidentuara prej tyre gjatë fazës së hartimit të projektit.

#### Çështjet kryesore mbi Qasjen në Drejtësi të trajtuara nga projektet e financuara me nëngrante

19 OSHC kanë trajtuar në projektet e tyre kryesisht ose vetëm qasjen në drejtësi. Çështjet kryesore të trajtuara nga këto të financuar me nëngrante lidheshin me qasjen e dobët ose mungesën e qasjes së kategorive të ndryshme të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, veçanërisht të grupeve/komuniteteve të cenueshme ose të marginalizuara, mungesën e informacionit dhe ndërgjegjësimit mbi çështjet ligjore, mungesën e asistencës së specializuar veçanërisht të ndihmës ligjore dhe këshillimit psikologjik, si dhe aftësive të dobëta të profesionistëve ligjorë dhe avokatëve.

Problemet kryesore të adresuara vijojnë hollësisht si më poshtë:

- **Mungesa e qasjes së komuniteteve të cenueshme (Rom, komunitetet rurale, familjet me të ardhura të ulëta etj.) në institucionet e drejtësisë:** mungesë e ndihmës ligjore (*shërbimet parësore dhe dytësore*) për këto komunitete/grupe për të mbrojtur më mirë të drejtat e tyre dhe kërkuar kompensim: aktualisht, Shqipëria ka miratuar ligjin për ndihmën ligjore nga shteti (2017), megjithatë ky ligj nuk është zbatuar siç duhet për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit rreth qasjes në institucionet e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi, mungesës së edukimit të këtyre komuniteteve/grupeve se si mund të përfitojnë më mirë nga burimet aktuale, mospërfshirjes së institucioneve shtetërore si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të mbrojtur më mirë të drejtat e tyre, mungesës së koordinimit institucional veçanërisht nga MD-ja dhe gjykatat për ofrimin e ndihmës ligjore falas etj. Personat me aftësi të kufizuara hasin vështirësi të panumërta në qasjen e institucioneve të drejtësisë, pasi iu mungon këshillimi ligjor, përfaqësimi ligjor në procese gjyqësore apo në institucione të tjera, dhe ndërgjegjësimi. kuadri ligjor i Shqipërisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është pjesërisht në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky grup vijon të hasë vështirësi në qasjen në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe pjesëmarrje në vendimmarrje. Ka ende vështirësi në kapërcimin e barrierave mjedisore dhe infrastrukturale<sup>9</sup>.
- **Mbrojtje e dobët për viktimat e krimit** - legjislacioni shqiptar nuk e rregullon plotësisht statusin e viktimave të krimit, veçanërisht të viktimave të trafikimit dhe vërehet mungesë kapacitetesh institucionale për garantimin e të drejtave të tyre, siç parashikohet nga standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni i vendeve të tjera. Institucionet shtetërore nuk kanë mundur t'u ofrojnë asistencë ligjore këtyre viktimave dhe t'i ndërgjegjësojnë qytetarët, si dhe trajnimet për profesionistët e drejtësisë mungojnë. Edhe të rinjve viktimat iu mungon qasja në institucionet e drejtësisë për shkak të mendësisë dhe mosbesimit në sistemin gjyqësor, të ndërthurura me

9. Shihni Progres Raportin e BE-së për Shqipërinë, 2018, f. 30/1.

sjelljet e dhunshme, mostolerancën, fajësimin e viktimës etj. Mentaliteti tradicional ka sjellë lëndime të rënda psikologjike dhe fizike. Publikut dhe shoqërisë nuk i është vënë në dispozicion analiza e faktorëve që ndikojnë në dhunë dhe profilet e viktimave të dhunës; mungojnë seancat ndërgjegjësuese për qytetarët mbi këto çështje, asistenca ligjore për viktimat e dhunës, si dhe politikatat sociale për fuqizimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

- **Mbrojtje e dobët e të drejtave të pacientëve në sistemin e drejtësisë:** lidhet kryesisht me pacientët me sëmundje të rënda kronike; në Shqipëri qytetarët përballen me qasje, informim dhe përfitime të pabarabarta në kujdes shëndetësor, mungesën e politikave për mbrojtjen e të drejtave, mungesën e dispozitave ligjore që trajtojnë këto çështje, mungesën e ndihmës ligjore për të mbrojtur të drejtat në nivel administrativ apo procese gjyqësore. Në përgjithësi, qytetarët përballen edhe me informimin e pamjaftueshëm për parandalimin (*kontroll, diagnozë prenatale*) dhe trajtimin, të dhëna të pasakta mbi numrin/shpërndarjen e pacientëve me sëmundje të rënda dhe prevalencën e tyre, të ndërthurura me mungesën e laboratorëve të specializuar ekzaminues, diagnostikimit dhe monitorimit të gjendjes së qytetarëve që kërkojnë kujdes shëndetësor, staf mjekësor të pamjaftueshëm dhe ndonjëherë edhe jo plotësisht të specializuar, kosto të larta të kontrolleve mjekësore dhe trajtimit etj.
- **Qasje e dobët e komunitetit LGBTI në institucionet e drejtësisë:** ata përballen me më tepër vështirësi në marrjen e ndihmës së specializuar ligjore.<sup>10</sup> Qendrat që ofrojnë kujdes, mbështetje dhe advokaci veçanërisht për popullatën e të rinjve LGBT të pastrehë mungojnë në Shqipëri. Pavarësisht fushatave të ndërgjegjësimit dhe advokimit të zhvilluara deri më tani mbi të drejtat e komunitetit LGBTI, qytetarët ende nuk kanë arritur ta pranojnë dhe të jenë përgjigjës ndaj këtij komuniteti.
- Edukim ligjor i dobët për publikun: është shpërfillur konsiderueshëm në Shqipëri, prandaj nuk ka asnjë strategji kombëtare për zbatimin e tij, mungojnë institucionet shtetërore dhe kuadri rregullator, së bashku me logjistikën dhe buxhetin përkatës. Krahas kësaj, ka mungesë njohurish apo informacionesh mbi ELP-në, prandaj qytetarët ndihen të shkëputur nga institucionet publike e private dhe nuk mund t'i ushtrojnë të drejtat e tyre. Deri më tani, ELP-ja është ofruar në mënyrë sporadike vetëm nga OSHC-të me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë; komuniteti i gjerë nuk ka informacion të detajuar mbi ndihmën ligjore të ofruar nga shteti, qasjen në institucionet e drejtësisë, të drejtat e njeriut, të drejtat e viktimave, programet dhe procedurat e drejtësisë për të mitur, ndërmjetësimin, si dhe institucionet që luajnë rol jetik në mbrojtjen e qytetarëve si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale etj.
- **Zbatim i dobët i Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM):** Megjithëse KDM-ja është miratuar së fundi (hyrë në fuqi në janë 2018), profesionistët e drejtësisë nuk kanë informacion mbi parimet dhe procedurat që shtjellohen në brendësi, si dhe nuk trajnohen vazhdimisht mbi këto çështje, komuniteti nuk ka informacion mbi çështjet e DM-së për shkak të nismave sporadike ndërgjegjësuese, kryesisht të ndërmarra nga OSHC-të vendore, dhe institucionet nuk i koordinojnë përpjekjet e tyre për zbatimin e detyrueshëm të kërkesave ligjore mbi çështjet e DM-së. **Krahas kësaj, zbatimi i masave të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-autor për të miturit në konflikt me ligjin është i dobët:** nuk ka informacione të mjaftueshme nga institucionet shtetërore se si do të zbatohen masat e drejtësisë restauruese apo ndërmjetësimi për të miturit në konflikt me ligjin. Këtë gjë e reflekton edhe numri i ulët i çështjeve që referohen për ndërmjetësim nga gjyqësori (*prokuroritë dhe gjykatat*). Megjithëse KDM-ja parashikon përdorimin

10. Për më tepër informacion, shihni Progres Raportin e BE-së për Shqipërinë, 2018 – ‘Megjithëse legjislacioni shqiptar kundër diskriminimit e ndalon diskriminimin e personave lesbikë, gei, biseksualë, transgjinjorë dhe interseks (LGBTI), ndërgjegjësimi dhe pranimi i këtyre personave mbetet sërish i ulët, veçanërisht në zonat rurale. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese vijon të mbetet problem në media, veçanërisht në median online’, f. 30/2.

e diversionit dhe ndërmjetësimit viktimë-autor, praktikuesit e drejtësisë për të mitur (*gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë, zyrtarët e shërbimit të provës, Specialistët e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës dhe ndërmjetësit*), pavarësisht trajnimeve të marra, nuk janë të gatshëm ta përdorin diversionin për ndërmjetësim dhe për të përfituar prej tij. Mungojnë ende aktivitetet ndërgjegjësuese mbi drejtësinë restauruese dhe praktikën e ndërmjetësimit për qytetarët. Krahas kësaj, Shqipëria nuk ka studime dhe politika institucionale mbi përsëritjen e veprës penale nga të miturit në konflikt me ligjin, ri-edukimin me bazë komunitetin dhe programet e ri-integrimit, si dhe as planifikim e as buxhetim të përshtatshëm. Vërehet gjithashtu edhe mungesë koordinimi institucional për përfshirjen e institucioneve përkatëse shtetërore në këto çështje, si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës në Shqipëri, si aktorë të rëndësishëm në riintegrimin e të miturve në shoqëri.

- **Zbatimi i dobët i ndërmjetësimit si masë alternative ndaj burgimit për zgjidhjen e konflikteve:** është sfidë më vete aktualisht në Shqipëri, pasi nuk ka sistem efikas për menaxhimin e zbatimit të ndërmjetësimit në vend të procedurave gjyqësore, si në çështjet civile, ashtu edhe në ato penale. Mungojnë personat e kontaktit apo strukturat vendore (dhomat/shoqatat) që mund t'i informojnë dhe ndërgjegjësojnë qytetarët rreth këtyre mundësive, si metodë e re alternative për zgjidhjen e konflikteve, si dhe për ndërtimin e urave lidhëse midis institucioneve të gjyqësorit dhe ndërmjetësve. Krahas kësaj, ka ende mungesë informacioni, ndërgjegjësimi dhe asistencë ligjore për zgjidhjen në mënyrë alternative të konflikteve të gjakmarrjes, për shkak të traditës kanunore.
- **Dhuna në familje**<sup>11</sup> paraqitet si problem mjaft shqetësues për shoqërinë shqiptare, veçanërisht në zonat rurale. Numri i çështjeve të depozituara pranë institucioneve të gjyqësorit si në prokurori, gjykata dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës në bashki është rritur. Komuniteti po përballlet ende me çështje që lidhen me mungesën e ndërgjegjësimit mbi këto çështje, veçanërisht në zonat rurale, si dhe me mungesën e asistencës ligjore dhe psikologjike falas të ofruar për këto raste. Krahas kësaj, profesionistëve të drejtësisë, veçanërisht prokurorëve, nuk i ofrohen trajnime mbi DHF-në dhe DHBGJ-në dhe media nuk i mbulon këto situata me profesionalizëm. Për rrjedhojë, të drejtat e viktimave të DHF-së dhe DHBGJ-së nuk garantohen plotësisht për shkak të mungesës së ndihmës ligjore cilësore, mungesës së dispozitave ligjore që mbështesin statusin e tyre dhe rolit pasiv të gjyqtarëve gjatë procesit gjyqësor. Në shumë rrethe në Shqipëri, viktimat e kanë thuar se të pamundur të gjejnë një avokat profesionist për të ofruar orientime ligjore dhe të merren me çështjet e tyre.<sup>12</sup> Qasja miqësore me viktimat në çështjet e DHF-së dhe DHBGJ-së nuk zbatohet sistematikisht dhe rehabilitimi i autorëve në qendrat e burgimit nuk ofron këshillim ligjor dhe psikologjik. Nevojat e veçanta të grave dhe fëmijëve nuk merren aq sa duhet parasysh nga politikën specifike për parandalimin e krimit në rang kombëtar dhe strategjitë e drejtësisë penale.
- **Mungesa e profesionalizmit të gazetarëve dhe medias në raportimin e çështjeve ligjore:** ata nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre lidhur me informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e njeriut, veçanërisht kur vjen puna te gazetaria investigative, ku vërehen mungesë trajnimesh për gazetarët. Nga ana tjetër, profesionistëve ligjorë (*gjyqtarëve, prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore*) i mungojnë njohuritë dhe trajnimet mbi raportimin në media, kancelarët e gjykatave nuk janë plotësisht të aftë dhe nuk marrin përsipër informimin e publikut

11. Për informacione të mëtejshme, shihni Progres Raportin e BE-së për Shqipërinë 2018 “*Dhuna në familje mbetet shqetësim serioz. Gjatë vitit 2017, u raportuan 3,243 raste (kundrejt 3,700 në 2016-n) dhe u lëshuan 2,593 urdhra mbrojtjeje (kundrejt 2,207 në 2016-n). Për vitin 2017, 129 prej këtyre urdhrash mbrojtjeje nuk u zbatuan (kundrejt 119 në 2016-n). Për më tepër, në vitin 2016, u regjistruan si vepra penale 1,950 çështje të dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve.* – f. 29/2.

12. Për informacione të mëtejshme, shihni Progres Raportin e BE-së për Shqipërinë 2018, “*Ligji për ndihmën ligjore e zgjeron më tej kategorinë e personave që përfitojnë ndihmë ligjore, megjithatë skema e ndihmës ligjore për të drejtat e viktimave duhet të zhvillojë një mekanizëm depërtimi dhe qasjeje në shërbime; shumica e rasteve që përfshijnë grupet e cënueshme menaxhohen ende nga shoqëria civile me mbështetjen e donatorëve”- f. 30/4.*

mbi proceset gjyqësore që zhvillohen për shkak të fushëveprimit të gjerë të kompetencave të tyre administrative në menaxhimin e gjykatave dhe për faktin se kjo kompetencë i përket gjyqtarit përgjegjës për median, një strukturë kjo që nuk është ngritur ende në gjykatat shqiptare edhe pas reformës ë drejtësi.

## Çështjet kryesore mbi Monitorimin e Institucioneve të Drejtësi të trajtuara nga projektet e financuara me nëngrante

15 OSHC kanë trajtuar në projektet e tyre kryesisht ose vetëm monitorimin e institucioneve të drejtësisë. Çështjet kryesore të trajtuara nga të financuarit me nëngrante fokusoheshin te monitorimi dhe matja e performancës së gjykatave dhe institucioneve të tjera të drejtësisë si Shërbimi i Provës, shërbimet e tyre administrative, faqet e internetit të gjykatave, informacioni i ofruar për publikun, infrastruktura e gjykatës, cilësia e vendimeve gjyqësore veçanërisht e atyre që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin, mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe organet e reja të qeverisjes. Fushat kryesore të hetimit vijojnë hollësisht si më poshtë:

- **Monitorimi i performancës së gjykatave të shkallës së parë** në Shqipëri mbetet sfidë më vete për gjykatat shqiptare nga këndvështrimi i përdoruesve të gjykatës dhe publikut lidhur me aktivitetin e tyre gjyqësor dhe administrativ. Shumica e statistikave gjyqësore prodhohen nga vetë gjykata, pa u mbështetur në metodologji dhe tregues të përbashkët të miratuar paraprakisht (nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, tashmë Këshilli i Lartë Gjyqësor). Prapëseprapë, këto statistika janë mjaft të varfra për nga cilësia, pasi informacioni që ofrojnë nuk është i detajuar. Krahas kësaj, gjykatat shqiptare nuk kanë një sistem të unifikuar të menaxhimit të çështjeve që mund të ofrojë statistika dhe të gjenerojë të dhëna dhe raporte kurdo për aktivitetin e gjykatave. Për shkak të reformës në drejtësi dhe procesit të rivlerësimit kalimtar, të dhënat statistikore më të fundit për gjykatat datojnë që prej vitit 2017. Pas monitorimi apo matja e performancës së gjykatave për nga kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, numri i seancave gjyqësore të zhvilluara, arsyet për shtyrjen e seancave, arsyetimi i vendimeve gjyqësore, harku kohor nga njëra seancë në tjetrën, përputhshmëria me procesin e drejtë gjyqësor brenda standardit të afatit të arsyeshëm kohor (*Neni 6 i KEDNJ-së*), cilësia e vendimeve gjyqësore, transparenca, infrastruktura, qasja e grupeve të marginalizuara, të dhënat financiare etj, mungojnë. Deri më sot, vetë gjykatat as nuk kanë përcaktuar dhe miratuar bazën e krahasimit të aktivitetit të tyre me vitet e mëparshme, dhe as nuk kanë organizuar monitorim të jashtëm nga këndvështrimi i përdoruesit/publiku për të ditur pozitat e tyre. Këto aktivitete janë kryer më së shumti së jashtëmi nga projekte dhe donatorë të ndryshëm, me raste. Disa prej gjykatave kanë filluar të përdorin treguesit e KKEED-së për të matur performancën e tyre gjyqësore, por këto raste kanë qenë sporadike, si dhe të dhënat nuk kanë qenë të unifikuara për të gjitha gjykatat, në mënyrë të që të bëhej krahasimi me vendet dhe sistemet gjyqësore evropiane.
- **Monitorimi i performancës së gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të apelit**<sup>13</sup> - Ligji për Funkionimin e Sistemit Gjyqësor Administrativ<sup>14</sup> u ndryshua për shkak të reformës në drejtësi, prandaj ka shumë rëndësi që të monitorohet dhe vlerësohet funksionimi i sistemit gjyqësor administrativ. Statistikat për kohëzgjatjen e proceseve, numrin e seancave, dhe

13. "Lidhur me drejtësinë administrative, kapaciteti i sistemit gjyqësor administrativ për menaxhimin e çështjeve të mbartura është përmirësuar për shkallën e parë, por çështjet e mbartura mbeten problem për apelin për shkak se vendi ka mbetur vetëm me një gjykatë administrative apeli." "Megjithëse është miratuar legjislacioni për mbrojtjen e të drejtës së qytetarëve për të kërkuar kompensim (për shkeljen e të drejtës për proces gjyqësor të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor/vonesat në procese gjyqësore), numri i këtyre çështjeve në gjykata është mjaft i ulët për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të publikut mbi këtë të drejtë", shihni Progres Raportin e BE-së për Shqipërinë, f. 15/4.

14. Ligji 39/2017.

arsyet për shtyrjen e seancave gjyqësore për vitin 2018 mungojnë për gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit.

- **Monitorimi i ofrimit të shërbimeve të gjykatës administrative për qytetarët/përdoruesit e gjykatës** - marrja dhe kthimi i përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion është shërbim kryesor që ofrohet nga gjykatat administrative apo gjykatat me juridiksion të përgjithshëm (*shkalla e parë ose apeli*). Në këtë drejtim, ka nevojë të monitorohet se si ofrohen shërbimet e gjykatës administrative për qytetarët dhe/ose përdoruesit. Në Shqipëri, këto lloje të monitorimit të performancës së administratës gjyqësore mungojnë.
- **Monitorimi dhe matja e integritetit gjyqësor** - Gjyqësori në Shqipëri perceptohet si i korruptuar nga opinioni i gjerë publik.<sup>15</sup> Perceptimi i korrupsionit përcaktohet nga disa faktorë objektivë si tejzgjatja e proceseve gjyqësore, vonesat në zbardhjen e arsytimit të vendimeve gjyqësore, shërbimi i dobët gjyqësor, sjellja armiqësore e gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, mungesa e transparencës dhe komunikimit efikas midis gjykatave dhe përdoruesve të shërbimeve të tyre, kontaktet informale midis gjyqtarëve dhe palëve, mënyra e pajustificuar e jetesës së gjyqtarëve etj. Pavarësisht matjes periodike të perceptimit të korrupsionit të gjyqësorit nga publiku, nuk janë kryer studime specifike për faktorët që fshihen pas korrupsionit në Shqipëri, dhe nuk ka as kuadër funksional të përhershëm për monitorimin e vazhdueshëm të integritetit të gjyqësorit (*sistemi i vlerësimit të hapësirave për korrupsion në gjyqësor*) dhe as mekanizëm të përhershëm për monitorimin e vazhdueshëm të integritetit të gjyqësorit.
- **Monitorimi i institucioneve të reja qeverisëse të drejtësisë<sup>16</sup> KLGJ, KLP, KED, ILD** mbi mënyrën se si institucionet e përfshira në proces do të respektojnë ligjin dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për këto institucione, si masë paraprake për llogaridhënien, transparencën dhe efikasitetin e tyre në të ardhmen. Përpara reformës në drejtësi, caktimi dhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve që qeverisin gjyqësorin nuk monitoroheshin nga OSHC-të dhe nuk bëheshin publike, çka sillte mungesë transparence në procedurat e përzgjedhjes, ose në plotësimin e vendeve të lira me kandidatë që nuk i përmbushnin ose i përmbushnin vetëm pjesërisht kriteret, duke marrë parasysh edhe faktin se për disa pozicione mjaft të rëndësishme si në Prokurorinë e Përgjithshme apo në Këshillin e Lartë të Drejtësisë kriteret ishin bazike. Kjo situatë e ka përkeqësuar performancën, efikasitetin, llogaridhënien dhe transparencën e aktiviteteve të tyre për afro tre dekada tranzicion.
- **Monitorimi i çështjeve të kriminalitetit të të miturve dhe sistemit të mbrojtjes ligjore<sup>17</sup> veçanërisht gjatë procedimeve penale** për të miturit në konflikt me ligjin - meqenëse Shqipëria e ka miratuar rishtas Kodin e Drejtësisë për të Mitur, nuk ka studime apo statistika mbi zbatimin e dënimeve alternative për të miturit në konflikt me ligjin, studime mbi shkeljen e të drejtave të tyre themelore, si dhe nuk ka monitorim të proceseve gjyqësore, veçanërisht kur bëhet i ditur identiteti i fëmijës. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore për çështjet e kriminalitetit të të miturve është i dobët dhe vërehet mungesa e analizës së detajuar të rrethanave sociale dhe emocionale të të miturve apo edhe e të gjitha rrethanave të veprës penale, mosmarrje parasysh e interesit më të lartë të fëmijës dhe parimit të proporcionalitetit, mosreferimi i praktikës gjyqësore/doktrinës ligjore ndërkombëtare se si gjykata i identifikon dhe i mat këto rrethana, mosanalizimi i rrethanave që merren parasysh kur caktohet masa e dënimit, mungesa

15. Shihni studimin e IDRA-s 2009 'Korrupsioni në Shqipëri: Perceptimet dhe Përvojat' – "Shqiptarët besojnë se vendimet gjyqësore ndikohen kryesisht nga interesat financiare, lidhjet për qëllime biznesi, njohjet personale të gjyqtarëve dhe fjetet politike".

16. Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

17. Për më shumë informacion, shihni Progres Raportin e BE-së për vitin 2018 për Shqipërinë, Të Drejtat Themelore – 'Megjithëse është miratuar legjislacioni i ri për të drejtat e fëmijëve, mekanizmat institucionale mbeten të dobëta dhe duhen bërë më shumë përpjekje për të zbatuar angazhimet ekzistuese. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për t'u siguruar se sistemi i mbrojtjes së fëmijës funksionon me efikasitet' - f. 25/3 & 29.

e elementeve që garantojnë ofrimin e trajtimit të individualizuar për të miturit dhe e gjykimit në bazë të parimeve, rregullave dhe standardeve të përbashkëta.

- **Monitorimi i zbatimit të Dënimeve Alternative:** aktualisht, vërehen boshllëqe të konsiderueshme në përdorimin më të mirë të mundshëm të dënimit alternativ në Shqipëri, lidhur kryesisht me Shërbimin e Provës, i cili nuk është aspak efikas për shkak të lëvizjes së shpeshtë të stafit, mungesës së trajnimeve, mungesës së ligjeve organike që mund të rregullojnë mënyrën se si ata operojnë, mungesës së studimeve mbi mënyrën se gjyqtarët marrin vendimet, mungesës së statistikave të prodhuara së brendshmi dhe nga burime të jashtme si OSHC-të apo institucione të tjera.
- **Monitorimi i (mos)ekzekutimit të vendimeve për detyrim ushqimor:** mosekzekutimi i detyrimit ushqimor dhe mospërbushja e përgjegjësive prindërore sjellin ngarkesa emocionale për fëmijët, duke shkaktuar dështimin e të gjithë procesit të vendosjes së drejtësisë në vend pavarësisht marrjes së vendimit. Këtyre çështjeve nuk iu është kushtuar vëmendje nga OSHC-të apo institucionet e tjera shtetërore, prandaj ka mungesë të statistikave dhe studimeve për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore në Shqipëri në përgjithësi dhe të atyre mbi detyrimin ushqimor në veçanti.

## IV. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËNGRANTE

### IV. I. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËNGRANTE MBI QASJEN NË DREJTËSI

#### 1. Organizata: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë/TLAS

<b>Titulli i projektit</b>	Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës ligjore në nivel vendor përmes rrjeteve bashkëpunuese
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi përmes ndihmës ligjore falas për individët dhe grupet e cënueshme për të rritur ndërgjegjësimin rreth të drejtave të njeriut për qasje në drejtësi, ndryshuar Legjislacionin “Për gjendjen civile”, zgjeruar zonën e mbulimit ku partnerët vendorë kanë ofruar qasje në drejtësi për njerëzit në nevojë, si dhe informuar qytetarët mbi edukimin ligjor.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017- maj 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Berat, Fier

#### Aktivitetet kryesore

- **Ofrimi i shërbimeve ligjore** (shërbime paraligjore, shërbime ligjore, shërbime ligjore telefonike dhe në faqe interneti, klinikë ligjore, shërbime të lëvizshme) për grupet e synuara. Është ofruar asistencë për 257 raste në Fier dhe Berat, prej të cilave për 47 raste u ofrua përfaqësim ligjor në gjykatë, për 48 raste përfaqësim ligjor në shkallë administrative, 87 raste u menaxhuan përmes klinikës ligjore dhe 75 raste u asistuan përmes linjës telefonike dhe nga interneti (*duke ofruar shërbime ligjore online*). Çështjet kryesore: regjistrimi i fëmijës, kujdestaria ligjore, divorc, kombësi etj.
- **Organizoi 4 trajnime** me partnerët, vendimmarrësit dhe përfituesit, nëpunësit e gjendjes civile, administratorët e asistencës sociale, nëpunësit e institucioneve shëndetësore, njësitë e mbrojtjes së fëmijës etj. në Berat, U.Vajgurore, Fier dhe Lushnjë mbi çështjet e divorcit, kujdestarisë ligjore, regjistrimit të fëmijës, martesave të rreme etj. (*morën pjesë 95 veta*).
- Zhvilloi 9 aktivitete informuese ligjore në rrugë dhe 2 mbledhje prezantuese - një në Berat (37 pjesëmarrës) dhe një në Fier (26 pjesëmarrës) për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut dhe qasjen në drejtësi, veçanërisht në zonat e largëta dhe aktivitete informuese ligjore në rrugë në mënyrë që njerëzit të mësojnë të adresojnë problemet e tyre dhe të përfitojnë asistencë ligjore (*u dha informacion për 490 qytetarë dhe u shpërndanë fletushka/broshura për 560 qytetarë*).

#### Përmbledhje e gjetjeve

- Në shumicën e zonave të largëta të këtyre dy rrethëve (*Berat dhe Fier*) jetojnë shumë familje dhe individë në nevojë për shërbimet e ndihmës ligjore falas. Bazuar në vlerësimin e nevojave që u krye përpara propozimit të projektit, për asistencë ligjore kishin nevojë 360 persona.



- Institucionet shtetërore nuk ishin në gjendje t'i ndihmonin apo informonin qytetarët se si t'i kërkonin të drejtat e tyre dhe se si mund të përfitonin nga mjetet ligjore të ofruara nga vetë shteti dhe OSHC-të.

### Rekomandime

- Shërbimet e ndihmës ligjore falas për personat në nevojë duhet të ofrohen nga institucionet shtetërore.
- Duhet organizuar trajnime, workshop-e dhe konferenca për specialistët e institucioneve shtetërore për të ndërgjegjësuar, aftësuar dhe ngritur kapacitetin rreth të drejtave të qytetarëve, në mënyrë që këto njohuri dhe informacione mbi regjistrimin e fëmijës, kujdestarisë ligjore, divorcit, pensioneve dhe çështjeve të tjera familjare t'ia përcjellin qytetarëve në nevojë.

## 2. Organizata: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara/ FSHDPAK

<b>Titulli i projektit</b>	Qasjet e reja gjithëpërfshirëse të qasjes në drejtësi për të siguruar qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuara
<b>Qëllimi i projektit</b>	Krijimi i një sistemi drejtësie më miqësor dhe më të qashtëm për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri, për të mundësuar qasje të barabartë në drejtësi duke rritur ndërgjegjësimin dhe llogaridhënien e institucioneve përkatëse shtetërore në sistemin e drejtësisë, duke ndikuar në miratimin e ndryshimeve ligjore të QD-së për personat me aftësi të kufizuara, dhe duke i fuqizuar këta persona përmes ngritjes së kapaciteteve në sistemin e drejtësisë mbi monitorimin dhe advokimin.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017- qershor 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Mat, Lezhë, Gjirokastrë, Durrës, Tiranë

### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi 5 trajnime** për stafin e institucioneve qeveritare për ngritje kapacitetesh mbi qasjen e personave me aftësi të kufizuara në drejtësi si Gjykata e Lartë, Gjykatat e Rrethit, Gjykatat e Apelit dhe Administrative, Prokurorët, Oficerët e Policisë Gjyqësore, Zyra e Buxhetit Gjyqësor, Avokati i Popullit, Komisioneri kundër Diskriminimit. *Morën pjesë 19 institucione dhe 70 përfaqësues të institucioneve të drejtësisë shqiptare.*
- **Organizoi 5 trajnime** për organizatat e shoqërisë civile dhe personat me aftësi të kufizuara mbi çështjet e QD-së (*142 pjesëmarrës dhe përfaqësues nga 10 organizata jofitimprurëse*).
- **Hartoi udhëzues** se si institucionet mund të bëhen më të qashtë nga personat me aftësi të kufizuara. **U organizuan 5 workshop-e** me qëllim hartimin e udhëzuesve me pjesëmarrjen e 138 përfaqësuesve të personave me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile, institucionet përkatëse publike dhe institucionet e drejtësisë në nivel vendor (u përgatitën dhe u prezantuan 9 udhëzues për institucionet e drejtësisë në zonat e synuara).
- **Xhiroi dhe transmetoi 4 video** mbi qasjen në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara: u fokusua në 4 histori/raste të personave me aftësi të kufizuara duke identifikuar mungesën e qasjes fizike në institucionet e drejtësisë, mungesën e interpretëve të gjuhës së shenjave gjatë

proceseve gjyqësore që përfshinin persona të shurdhër, problemet e personave me dëmtime pamore dhe të verbër lidhur me mosfrimin e dokumenteve zyrtare në gjuhën Braille, çështjet e lidhura me paaftësinë apo aftësinë e tyre të kufizuar ligjore për të vepruar, dhe mungesa e dispozitave ligjore për “nënshkrimin dixhital” për personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Videoja ishte pjesë e një programi televiziv e një televizioni kombëtar dhe u transmetua në RTSH 2 dhe u hodh në faqen e Facebook-ut të FSHDPAK-së.

- Hartoi dhe shpërndau një dokument orientimi dhe 2 fletushka informuese që përmbanin informacion për të drejtat dhe qasjen në drejtësi, informacion në formate lehtësisht të lexueshme në Braille.
- **Hartimi i raportit monitorues** mbi qasjen e personave me aftësi të kufizuara në Drejtësi duke ndërthurur metodologjinë cilësore dhe sasiore, bazuar në ligje dhe akte nënligjore, strategji, politika, raporte monitoruese, të dhëna të disponueshme përmes rrugëve zyrtare, mbledhjeve, seancave informuese, shkëmbimit të informacionit, vëzhgimeve të drejtpërdrejta. Pyetësi mblodhi të dhëna nga 250 persona me aftësi të kufizuara në 5 rrethe të synuara nga projekti. Raporti u prezantua në konferencën kombëtare në maj të vitit 2019, të organizuar në kuadër të projektit.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri hasin shumë shpesh barriera në zbatimin e parimit të barazisë së armëve dhe proceseve të drejta gjyqësore për shkak të dokumentacionit dhe procedurave jo të qasshme, të ndërthurura me përjashtimin nga procedimet apo dënimet e padrejta.
- Kodi i Procedurës Penale vijon të mbështesë zbatimin e parimit të “papërshatshmërisë për të marrë pjesë në proces gjyqësor” apo përjashtimit të një personi nga përgjegjësia penale mbi bazën e dëmtimit psikologjik dhe intelektual.
- Kuadri ligjor shqiptar përmban dispozita që nuk janë në përputhje me KDPAK-në, veçanërisht me garancitë e nenit 13 “Qasja në drejtësi”.
- Për sa i përket administrimit të drejtësisë dhe edukimit ligjor, SHM-ja ka asnjë kurs specifik në programet e trajnimit për konceptet e reja që janë parashtruar në Nenin 12 “Trajtim i Barabartë Përpara Ligjit” dhe Nenin 13 “Qaje në drejtësi” të KDPAK-së. E njëjta situatë vërehet edhe në kurrikulën e Fakultetit të Juridikut, ku shumë tema të rëndësishme janë lënë jashtë.

### Rekomandime

- Ngritja e një grupi pune që të përfshijë trupën e profesorëve dhe akademikë nga i gjithë vendi, në konsultim të ngushtë me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat përfaqësuese, si dhe stafin teknik të ministrive të linjës, për të zhvilluar debatin tekniko-ligjor për standardet e KDPAK-së, për përputhshmëri të plotë të kuadrit ligjor shqiptar me KDPAK-në.
- Ngritja e një grupi pune ndërministror në konsultim të ngushtë me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre për hartimin e akteve ligjore/nënligjore dhe udhëzuesve për asistimin e punës së gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe të gjitha palëve të përfshira në sistemin e drejtësisë.
- Rishikimi dhe përmirësimi i legjislacionit lidhur me parimin e drejtësisë penale të “*paaftësisë penale, për shkak të gjendjes mendore*” si dhe e eliminimit të masave të sigurisë që përfshijnë trajtimin e detyrueshëm mjekësor ose psikiatrik në institucionet përkatëse.
- Ngritja e grupit të punës nga KLGJ-ja për të inspektuar të gjitha ambientet ku operojnë gjykatat në Shqipëri, si ato të brendshme, edhe ato të jashtme, për të identifikuar të gjitha elementet që nuk i përmbushin standardet, si dhe në komunikim dhe informim.

- Planifikimi, ofrimi dhe shpërndarja e programeve trajnuese të detyrueshme dhe periodike për punonjësit e administratës dhe sistemit të drejtësisë, duke përfshirë oficerët e policisë, administratën dhe profesionistët që punojnë si mbrojtës publikë, që ofrojnë asistencë ligjore apo ushtrojnë profesione të ngjashme, dhe në veçanti për trupën e gjyqtarëve, prokurorëve, ndërmjetësve apo avokatëve.
- Përfshirja e standardeve të KDPAK-së (Neni 12-13) në kurrikulën e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.
- Rishikimi i kuadrit ligjor për të përmbushur standardet ndërkombëtare të parashtruara në KDPAK dhe unifikuar terminologjinë ligjore përkatëse për personat me aftësi të kufizuara, duke ngritur grupin e punës për të punuar mbi çështjen.

### 3. Organizata: Të ndryshëm & të Barabartë/D&E

<b>Titulli i projektit</b>	Drejtësia është histori e vërtetë kur në plan të parë janë viktimat
<b>Qëllimi i projektit</b>	Sigurimi i mbrojtjes efikase dhe mbështetjes ligjore për viktimat bazuar në qasjen me në qendër viktimat, si përgjigja më e mirë për gëzimin e të drejtave të tyre dhe luftën kundër këtij fenomeni në përgjithësi.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017- qershor 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tiranë, Korçë, Elbasan, Fier, Kukës, Dibër

#### Aktivitetet kryesore

- **Ofrimi i ndihmës ligjore falas për viktimat** për të gjithë përfituesit e programit të riintegritimit, duke përfshirë çështjet e reja të referuara gjatë kohëzgjatjes së projektit. Përfituesit janë informuar mbi të drejtat e tyre dhe iu është ofruar asistencë për shërbimet ligjore rast pas rasti dhe për disa çështje janë iniciuar edhe procedurat për përfaqësimin e tyre në gjykatë. Në total, 124 përfitues të drejtpërdrejtë (*viktima të trafikimit, abuzimit seksual dhe të dhunës në familje*).
- Në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare u arrit të paraqitej mbrojtje e suksesshme për një çështje (*29 seanca*) që përfshinte një viktimë trafikimi, pasi gjykata vendosi të jepte kompensim për viktimën, duke u kthyer në model të strategjisë së litigimit për përmirësimin e sistemit të kompensimit të të gjithë viktimave të veprave penale.
- **Organizoi 23 mbledhje me tematikë ligjore** për përfituesit e D&E, për informimin e viktimave mbi çështje të ndryshme ligjore dhe forcuar kapacitetet e tyre mbi edukimin ligjor në përgjithësi. Çështjet e diskutuara u identifikuan nga vetë përfituesit gjatë seancave informuese të organizuara në fillim të projektit dhe mbledhjet u mbajtën në grupe të vogla me nga 2-5 persona.
- **Ngritja e linjës së këshillimit për të ofruar asistencë ligjore për viktimat** për çështjet nën shqyrtim nga gjykata, apo në stade të tjera, duke përfshirë edhe çështje të reja.
- **Organizoi 18 seanca informuese “Të prezantojmë dhe të njohim të drejtat e viktimave”** për të informuar përfituesit mbi të drejtat e tyre si viktima të veprave penale, me viktima që vinin nga Qendra Shtetërore e Viktimave të Dhunës në Familje, përfaqësues të institucioneve shtetërore si Shërbimit Social Shtetëror, bashkive, drejtorive të policisë, NJMF-ve, studentëve dhe profesorëve nga universitetet, OSHC-v vendore që kanë kontakt të drejtpërdrejtë

me viktimat, vullnetarëve të qendrës D&E, studentëve të Fakultetit të Juridikut dhe Shkencave Sociale, anëtarëve të Komiteteve Rajonale Kundër Trafikimit, si dhe 20 oficerë policie nga Akademia e Policisë në Tiranë.. Seancat informuese janë organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin Kombëtar Antitrafik, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Fakultetin e Shkencave Sociale në Tiranë dhe Fakultetin e Juridikut në Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër. (462 pjesëmarrës).

- **Organizoi 6 trajnime për “Të drejtat e viktimave të veprave penale”** në Tiranë, Fier, Korçë, Elbasan, Dibër dhe Kukës që synonin shtimin e njohurive dhe përmirësimin e aftësive të agjencive ligjzbatuese mbi legjislacionin kundër trafikimit, aspektet praktike të veprimeve dhe rolin e çdo aktori në ofrimin e asistencës për viktimat e trafikimit, me përfaqësues nga agjencitë ligjzbatuese, prokurorët, gjyqtarët, policia dhe avokatët, përfaqësues të institucioneve vendore që ofrojnë shërbime ligjore për viktimat e veprave penale, si dhe avokatët e organizatave jofitimprurëse që i ofrojnë këto shërbime (174 pjesëmarrës).
- **Ndërmori veprimtari advokacie për hartimin e një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit:** bazuar në kërkesën e D&E për hartimin e ligjit të veçantë mbi mbrojtjen e viktimave të trafikimit, kjo nismë u bë pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 770, 26.12.2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për periudhën 2018-2020”. Në qershor të vitit 2019, në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Ministri i Brendshëm ngriti grupin e posaçëm për vlerësimin e nevojës për të hartuar ligjin e veçantë mbi mbrojtjen e viktimave të trafikimit. U hartua edhe një raport.
- **Hartoi, shpërndau dhe publikoi** materiale informuese të fokusuara në promovimin e linjës së këshillimit dhe të drejtat e viktimave (**1,000 broshura dhe 200 postera** mbi të drejtat e viktimave dhe vënia në përdorim e linjës së këshillimit).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Avokatët nga sektori privat kanë bashkëpunuar me D&E për ofrimin e ndihmës ligjore *pro bono* për përfituesit e D&E, por vërehet mungesë e avokatëve profesionistë për të përfaqësuar veçanërisht interesat e viktimave të trafikimit.
- Agjencitë ligjzbatuese nuk janë plotësisht të vetëdijshme për ndryshimet e ligjit që përmirësojnë të drejtat e viktimave të veprave penale. Ata fokusohen te autori dhe më pak te interesi i viktimave.
- Seancat informuese treguan interes të madh për aktivitetet e trajnimit mbi të drejtat e viktimave të trafikimit.

### Rekomandime

- Nevoja për trajnim të vazhdueshëm mbi ndryshimet ligjore të lidhura me përfaqësimin ligjor (në procese gjyqësore), veçanërisht në fushat e dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit dhe drejtësisë për të mitur.
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të avokatëve për përfaqësimin e interesave të viktimave në gjykatë.
- Nevoja për hartimin e një ligji të veçantë mbi mbrojtjen e viktimave të trafikimit si një instrument i veçantë për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit
- Nevoja për përmirësimin e kurrikulës për studentët e juridikut dhe shkencave sociale për të shtuar njohuritë e tyre mbi të drejtat e viktimave të veprave penale, veçanërisht të viktimave të trafikimit.

#### 4. Organizata: Qendra Sociale në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë/ QSNNN

<b>Titulli i projektit</b>	Promovimi i të drejtave themelore të njeriut; E drejta e qasjes në drejtësi
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes, barazisë dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe rritja e besimit të komunitetit.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Pukë dhe Fushë-Arrëz

##### Aktivitetet kryesore

- **Ngriti Qendrën e Mbështetjes Ligjore** për të rritur numrin e çështjeve të zgjidhura përmes procedurave ligjore në gjykatën e Pukës - 24 çështje ligjore të referuara në QSNNN, 18 prej të cilave u zgjidhën.
- **Organizoi seanca informuese** me përfaqësues të institucioneve ligjzbatuese dhe bashkive të Pukës dhe Fushë-Arrëzit për të prezantuar projektin dhe diskutuar se si mund të përmirësohet zbatimi i aktiviteteve të projektit (10 mbledhje - 136 pjesëmarrës).
- **Ngriti 12 sportele informuese jodixhitale** në të dy bashkitë (Pukë dhe Fushë-Arrëz) dhe në njësitë e tyre administrative përkatëse, si dhe shpërndau fletushka dhe postera informuese për qytetarët.
- **Ngriti Grupin e Vëzhgimit** të përbërë nga anëtarë të bashkive dhe Njësive Administrative për mirëmbajtjen teknike të sporteleve informuese në të dy bashkitë, për të vendosur dhe fuqizuar urat e komunikimit midis komunitetit dhe institucioneve publike.
- **Ngriti Lidhjen Rinore të Drejtësisë/LRD**, të përbërë nga 5 të diplomuar të juridikut që morën pjesë në 2 procese gjyqësore në Gjykatën e Pukës dhe bashkëpunuan ngushtësisht me ekspertët e Qendrës së Mbështetjes Ligjore.
- **Organizoi maratonën “Vrapojmë për drejtësi”** si aktivitet ndërgjegjësues për komunitetin e të dy bashkive, si shembull i fushatës masive ndërgjegjësuese të cilës palët e interesit dhe shoqëria duhet tii kushtojnë vëmendje.

##### Përmbledhje e gjetjeve

- Të rinjtë kanë shfaqur interes për të marrë pjesë në projekte që trajtojnë problemet domethënëse me të cilat përballlet komuniteti i tyre.
- Aktivitetet e projektit treguan bashkëpunimin e shkëlqyer midis komunitetit dhe stafit të institucioneve për t’i ardhur në ndihmë pjesës më të marginalizuar të komunitetit.
- Komunitetet dhe institucionet kanë shumë pak besim te OSHC-të në përgjithësi, për shkak të faktit se aktiviteti i tyre kufizohet vetëm në disa rrethe të caktuara, për shkak të aftësive të dobëta në litigim strategjik, advokaci dhe lobim kombëtar, qasjes së kufizuar në institucione, burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare etj.

##### Rekomandime

- Institucionet shtetërore dhe donatorët duhet t’i mbështesin më tepër projektet e shoqërisë civile për t’i ardhur në ndihmë jo vetëm pjesës më të marginalizuar të komunitetit, por edhe për të

angazhuar të rinjtë, të cilët janë tepër pasivë në jetën sociale.

- Institucionet shtetërore dhe donatorët duhet të mbështesin më tepër projekte për qasjen, barazinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, si dhe të vendosin ura komunikimi midis institucioneve dhe anëtarëve të komunitetit për të rritur besimin e tyre në sistemin e drejtësisë.

## 5. Organizata: Shoqata Komuniteti Papa Gjon XXIII

<b>Titulli i projektit</b>	Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve dhe ndihma ligjore për zgjidhjen e çështjeve të gjakmarrjes
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi për grupet e cënueshme dhe familjet në gjakmarrje.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Shkodër dhe zonat nënurbane, Tropojë, Kamëz

### Aktivitetet kryesore

- **Ofrim i këshillimit ligjor falas për familjet në gjakmarrje:** Ofroi këshillim ligjor për 1 familje në gjakmarrje në Shkodër dhe 1 familje në Tropojë, duke angazhuar institucionet vendore dhe kombëtare.
- Ofroi mbështetje për të lehtësuar gëzimin e të drejtave themelore të njeriut për 56 çështje gjakmarrjeje në total (*shoqërimi i familjarëve në burgje për të mundësuar takimin midis tyre dhe të burgosurve, shoqërimi në intervista pune në shërbimet sociale vendore, spitale dhe në takimet me familjarë*)
- Kreu vizita te familjet në gjakmarrje për të ofruar ndërmjetësim viktimë-autor si teknikë për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve duke ndarë, dëgjuar në mënyrë aktive dhe zbatuar parimin *equivocinanza (afërsi e barabartë)* për të dy palët, duke bërë që ndërmjetësi të fitojë besimin dhe besueshmërinë e tyre me qëllim orientimin e ndërmjetësimit drejt pajtimit. (*198 vizita në 22 familje*).
- **Mblodhi të dhëna** për rastet e reja të hakmarrjes dhe gjakmarrjes përmes shtypit të përditshëm dhe vizitave periodike.
- **Organizoi fushatë ndërgjegjësimi** më 10 dhjetor 2018 me rastin e 70 vjetorit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Fushata kombëtare Kundër Gjakmarrjes u prezantua në Shkodër për të ndërgjegjësuar popullsinë shqiptare për fenomenin e hakmarrjes dhe ftuar çdo qytetar që të mbajë qëndrimin e tij/saj të qartë dhe aktiv kundër gjakmarrjes.
- **Organizoi tryezë të rrumbullakët** me institucionet publike dhe OSHC-të për të paraqitur idetë për bashkëpunim në këto fusha, organizuar trajnime dhe ndarë informacion për çështje specifike, si dhe kuptuar më mirë dhe plotësuar nevojat dhe kërkesat e shprehura nga familjet në gjakmarrje (15 pjesëmarrës).
- **Ofroi këshillim ndërkombëtar mbi fenomenin e gjakmarrjes** për gazetarët, shoqatat, institucionet dhe zyrtarë ligjore të cilat në disa vende të tjera përfshihen në mbrojtjen e të drejtave të azilkërkuesve për arsye që lidhen me fenomenin e gjakmarrjes (përfituan 10 profesionistë).

## Përmbledhje e gjetjeve

- 18 familje në gjakmarrje të monitoruara në Shkodër dhe Tiranë i përkasin kryesisht klaneve nga Dukagjini dhe Tropoja. Më tepër se gjysma e tyre kanë migruar brenda për brenda Shqipërisë nga zonat malore të origjinës drejt periferive të qyteteve për t'i shpëtuar pasojave të mundshme dhe rreziqe të gjakmarrjes dhe reduktuar tensionin midis palëve, por fatkeqësisht siguria nuk garantohet pasi shoqëria tradicionale shqiptare bazohet në marrëdhëniet midis familjeve të mëdha që mund të marrin fare lehtësisht informacione për vendndodhjen e njerëzve të tjerë.
- Mjedisi social ku jetojnë këto familje (*fqinjët, marrëdhëniet, shkolla dhe/ose kolegët e punës etj.*) ndikojnë negativisht në vendimet e klanit dhe mund t'i shtyjnë drejt marrjes së vendimit për të marrë hak.
- Mungesa e bashkëpunimit me popullsinë vendase nuk i ndihmojnë institucionet e drejtësisë në punën që bëjnë. Heshtja për interesa vetjake, apo për shkak të frikës së shpagimit siç ndodh zakonisht, e ngadalëson vënien e drejtësisë në vend dhe parandalon raportimin e hakmarrjes.
- Gjakmarrjet cenojnë rëndë të drejtat themelore të njeriut, ku më të rëndësishmet vijojnë si më poshtë:
  - **e drejta e barazisë**, pasi ata që përfshihen në gjakmarrje përjetojnë zakonisht përjashtim social;
  - **e drejta për të jetuar, e lirisë dhe sigurisë**, e cila cenohet nga hakmarrja, gjakmarrja dhe ngujimi;
  - **barazia para ligjit**, e cila shkelet nëse autori nuk ndëshkohet;
  - **e drejta e privatësisë**, e cila shkelet kur autoritetet apo media i përdorin në mënyrë të papërshtatshme të dhënat personale të atyre që përfshihen në hakmarrje;
  - **e drejta për të punuar dhe për t'u arsimuar**, individët në gjakmarrje nuk kanë qasje në arsim apo punësim.

## Rekomandime

- Institucionet shtetërore duhet ta mbështesin ndërmjetësimin në mënyrë të institucionalizuar midis familjeve që janë viktime të gjakmarrjes dhe të krijojnë një proces pajtimi kombëtar përmes drejtësisë restauruese.
- Ndryshimi dhe zbatimi i Ligjit Nr. 9389, datë 04.05.2005, për ngritjen e Këshillit Koordinativ për Luftën kundër Gjakmarrjes.
- Prezantimi sistematik i programeve arsimore dhe kulturore bazuar në menaxhimin jo të dhunshëm të mosmarrëveshjeve, edukimin për paqen, pajtimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në shkolla, vende pune dhe në qytetet më të populluara.
- Marrja e masave për të siguruar sigurinë e shqiptarëve që janë viktime të hakmarrjes dhe qasjen e tyre në shërbime bazë (spitale, vende pune, shkolla etj.)
- Ngritja e fondit të kompensimit dhe mbështetjes për familjet në zi si pasojë e hakmarrjes.
- Ngritja e shërbimit të posaçëm të emergjencës për trajtimin e rasteve të gjakmarrjes.
- Prezantimi dhe zbatimi i programeve të veçanta në burgje dhe i planeve të riedukimit dhe riintegrimin për të burgosurit që kanë kryer veprën penale të gjakmarrjes.
- Prezantimi i kriterëve standarde për identifikimin e familjeve të përfshira në gjakmarrje.
- Publikimi i të dhënave zyrtare mbi shkallën aktuale të gjakmarrjes.

## 6. Organizata: Together for Life/ Së Bashku për Jetën

<b>Titulli i projektit</b>	Të drejtat e pacientëve brenda sistemit të drejtësisë / Përmirësimi i qasjes së pacientit në drejtësi
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i nivelit të qasjes në drejtësi për pacientët dhe bashkëpunëtorët e tyre në nivel vendor
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Dibër, Lushnjë

### Aktivitetet kryesore

- Organizoi 1 mbledhje prezantuese dhe 2 seanca informuese (në Dibër dhe Lushnjë) me pacientë kronikë, autoritetet vendore të kujdesit shëndetësor, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit etj., për të përmirësuar nivelin e njohurive të pacientëve kronikë mbi qasjen në drejtësi lidhur me të drejtat e tyre si pacientë dhe se si ata mund t'i qasen sistemit të drejtësisë nëse të drejtat e tyre shkelen (*45 pjesëmarrës në Tiranë, Seanca Informuese - 42 pjesëmarrës në Dibër, 45 pjesëmarrës në Lushnjë*)
- Botoi 5 artikuj në gazetën e shtypur “Shëndet+” (*botuar në 1500 kopje të shtypura*), së bashku me 17 artikuj në portalin shendeti.com.al (*me mbi 30.000 klikime/ditë*) të cilat u ndanë edhe nga faqja e fansave “Gazeta Shëndeti” me mbi 100,000 ndjekës mbi të drejtat e pacientit, çështjet e kujdesit shëndetësor, ligjeve më të fundit mbi kujdesin shëndetësor etj.
- **Organizoi 2 mbledhje** me pacientë kronikë, autoritetet vendore të kujdesit shëndetësor në Dibër dhe Lushnjë, për ndarjen e përvojave dhe historive të suksesit të projektit për qasjen e pacientëve në institucionet e drejtësisë dhe të drejtat e tyre (*në Dibër me 30 pjesëmarrës, në Lushnjë me 45 pjesëmarrës*).
- **Organizoi 7 seanca këshillimi** ku morën pjesë 7 pacientë kronikë dhe të afërmit e tyre, të cilët paraqitën edhe dokumentet mjekësore për të provuar shkeljen e të drejtës së tyre për kujdes shëndetësor. Eksperti ligjor u shpjegoi kuadrin ligjor dhe procedurat për të kërkuar të drejtën për kujdes shëndetësor përmes përfshirjes së institucioneve të drejtësisë (2 çështje iu dërguan Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi).
- **Organizoi 2 trajnime me gazetarët** e mediave vendore në Lushnjë dhe Dibër rreth mënyrave se si të hetojnë rastet e shkeljeve në sektorin e kujdesit shëndetësor, procedurave ligjore dhe institucioneve që mund t'i mbështesin përmes ofrimit të informacioneve të nevojshme, duke përmirësuar njohuritë, kapacitetin dhe aftësitë profesionale në raportimin e shkeljeve në sektorin e kujdesit shëndetësor (*morën pjesë 30 gazetarë*).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Seancat informuese dhe të këshillimit nxorën në pah mungesën e informacionit të pacientëve kronikë se si të mbrojnë të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor përmes institucioneve të drejtësisë, mekanizmave dhe procedurave ligjore, ofrimit të dokumenteve të nevojshme etj. Ata nuk kishin informacione për institucionet e pavarura si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit të cilëve mund t'i adresojnë ankesat apo kërkesat e tyre për informacion, përpara se t'i drejtohen gjykatës.
- Gjithashtu, pacientët kronikë nuk besojnë se institucionet e kujdesit shëndetësor janë në gjendje



t'i respektojnë të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor.

- Gazetarët vendorë dhe korrespondentët mediatikë nuk kanë kapacitetet e nevojshme profesionale në raportimin e shkeljeve në sektorin e kujdesit shëndetësor.

## Rekomandime

- OSHC-të dhe institucionet e tjera shtetërore që trajtojnë të drejtat e njeriut duhet të vijojnë të luajnë rol të rëndësishëm në ofrimin e asistencës ligjore për të sëmurët kronikë dhe pacientët e tjerë për të përmirësuar qasjen e tyre në informacione dhe në institucionet e drejtësisë, dhe si të kërkojnë respektimin e të drejtës së tyre për kujdes shëndetësor.
- OSHC-të, në bashkëpunim me institucionet shtetërore duhet të organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese mbi çështjet e kujdesit shëndetësor për të gjithë qytetarët, si seanca informuese me mjekë të specializuar, prej të cilave të mund të përfitojë edhe mbarë audienca (*programe televizive, artikuj mjekësorë, reklama të shkurta informuese në televizor, publikime në mediat sociale etj.*), për të rritur llogaridhënien e autoriteteve publike shëndetësore, garantuar të drejtën e pacientëve dhe ofruar kujdes të përshtatshëm/efikas në shërbimet e kujdesit shëndetësor.
- OSHC-të duhet të vijojnë të përmirësojnë aftësitë mediatike për raportimin profesional të shkeljeve në sektorin e kujdesit shëndetësor duke i trajnuar ata mbi çështjet e kujdesit shëndetësor dhe promovuar historitë e suksesit se si mund të garantohen të drejtat e pacientëve për kujdes shëndetësor.

## 7. Organizata: Streha

<b>Titulli i projektit</b>	Advokim për asistencë ligjore për komunitetin LGBTI
<b>Qëllimi i projektit</b>	Fuqizimi dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi për të rinjtë LGBT, duke identifikuar dhe hequr barrierat e hasura në këtë proces.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tiranë, Shkodër, Dibër, Durrës, Vlorë, Korçë, Gjirokastër

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi raportin e monitorimit** mbi sfidat aktuale që has komuniteti LGBTI në qasjen në drejtësi, bazuar në të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e plotësuar nga 64 anëtarë të komunitetit LGBTI, 12 intervista të thelluara me anëtarët e po këtij komuniteti, 12 intervista me profesionistët dhe aktivistët e çështjeve LGBTI, si dhe në studimet e kryera mbi sfidat që has komuniteti LGBTI në qasjen në institucionet e drejtësisë.
- **Ofroi ndihmë ligjore (këshillim)** dhe referim për 21 të rinj LGBTI, viktime të diskriminimit dhe dhunës në familje.
- **Rriti ndërgjegjësimin** mbi ligjet dhe sistemet e mbrojtjes për të rinjtë LGBTI të cenueshëm nga diskriminimi dhe dhuna në familje si Ligji Nr. 10 221, datë 04.2.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat kundër dhunës në familje”, E drejta penale (*200 fletëpalosje të shtypura dhe të shpërndara, 8 seanca informuese mbi të drejtat LGBTI dhe*

si ta mbrojmë më mirë veten kundër diskriminimit- 54 pjesëmarrës, workshop-e advokacie për të ndarë rezultatet e analizës së situatës - 15 përfaqësues nga organizatat e përfshira në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI ).

### **Përmbledhje e gjetjeve**

- Barriera në qasjen e komunitetit LGBTI në drejtësi - një prej gjetjeve kryesore të projektit lidhet me vështirësitë e hasura në qasjen e komunitetit LGBTI në shërbime ligjore, të ndërthurura me frikën e paragjyqimit për shkak të orientimit seksual/identitetit gjinor, bindjen se asgjë nuk do të ndryshojë edhe pas denoncimit, korrupsionin në gjykata, frikën se mos zbulohet orientimi seksual, vonesat e proceseve gjyqësore, pamundësinë e komunitetit LGBTI për të punësuar një avokat, për të paguar shpenzimet gjyqësore, apo përfituar ndihmë ligjore.
- Sipas perceptimit të 64 të të intervistuarve, për sa i përket nivelit të besimit në institucione, anëtarët e këtij komuniteti kanë më tepër besim te OSHC-të që merren me/mbrojnë çështjet e LGBTI-së. Ata kanë më pak besim te shërbimet sociale, Avokati i Popullit, oficerët e policisë, prokuroritë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe gjykatat/institucionet e drejtësisë (duke përfshirë edhe institucionet e qeverisjes vendore).
- Më tepër se 53% e personave LGBTI përjetojnë dhunë apo diskriminim.
- Dy prej sfidave më të mëdha që hasen në denoncimin e dhunës dhe diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI janë:
  - Frika se do të zbulohet orientimi seksual dhe identiteti gjinor dhe
  - Ndjesia se personi do të diskriminohet për shkak të orientimit të tij/saj seksual.
- Shumë prej të rinjve të komunitetit LGBTI bëjnë jetë të “fshehtë”, pasi nuk e ekspozojnë orientimin seksual dhe si rrjedhojë nuk mund të kërkojnë asistencë ligjore në rast nevojë.

### **Rekomandime**

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Policia dhe institucionet e tjera duhet të luajnë rol më proaktiv kundrejt komunitetit LGBTI dhe të promovojnë mënyrat se si ky komuniteti mund të ketë qasje më të mirë te këto komunitete. Ata duhet ta informojnë komunitetin mbi mënyrat konkrete të ngritjes së pretendimeve dhe ankesave për të denoncuar dhunën. Institucionet duhet t'i trajnojnë punonjësit mbi këto procedura, si dhe t'i ndërgjegjësojnë qytetarët përmes fushatave audio-vizuale, mediave dhe mbledhjeve. Ministria e Drejtësisë duhet të promovojë të drejtën për ndihmë ligjore falas, duke e informuar komunitetin LGBTI mbi mekanizmat konkretë të qasjes dhe përfitimet prej tij.

## 8. Organizata: Romano Kham

<b>Titulli i projektit</b>	Edukimi dhe fuqizimi i komunitetit rom për qasjen në drejtësi përmes së drejtës së informimit
<b>Qëllimi i projektit</b>	Informimi, edukimi dhe fuqizimi i komunitetit rom për të pasur qasje në sistemin e drejtësisë përmes së drejtës për informim.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Pogradec, Lushnjë

### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi 2 mbledhje prezantuese** me nivel bazë në Lushnjë dhe Pogradec për të informuar komunitetin rreth qëllimit dhe aktiviteteve të projektit. Në mbledhje mori pjesë edhe koordinatori për transparencë i bashkisë së Pogradecit dhe Specialisti për Zhvillimin Rural dhe Ekonomik i bashkisë së Lushnjës (*morën pjesë 63 veta*).
- Organizoi 2 seanca trajnuese mbi të drejtat e njeriut dhe institucionet kyçe që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të grupeve minoritare në Lushnjë dhe Pogradec (*temat e trajnimit ishin ndërvepruese dhe jepnin informacion bazë mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, institucionet e pavarura që mbrojnë të drejtat e njeriut në Shqipëri dhe raste praktike - morën pjesë 33 veta*).
- **Hartoi raportin e vlerësimit** për nivelin e informacionit që komuniteti rom ka mbi të drejtat e njeriut, të drejtën për informim dhe për institucionet si Avokati i Popullit, Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen së të Dhënave Personale, dhe ndihmën ligjore falas, bazuar në informacionin e mbledhur përmes 2 fokus grupeve që identifikuan nivelin e njohurive të romëve dhe joromëve mbi legjislacionin dhe institucionet e pavarura për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (*morën pjesë 19 vetë*) dhe pyetësorë/intervista në Lushnjë dhe Pogradec (*140 intervista derë më derë në mënyrë rastësore*).
- **Organizoi 2 seanca informuese** me Avokatin e Popullit dhe Komisionierin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*morën pjesë 80 veta*) dhe 2 seanca informuese me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me Klinikën Ligjore pranë Ministrisë së drejtësisë mbi qasjen e komunitetit rom në drejtësi dhe se si ky komunitet të përfitojë asistencë nga institucionet shtetërore (*morën pjesë 45 romë dhe përfaqësues të OJF-ve rome*).
- **Organizoi 2 workshop-e** në Lushnjë dhe Pogradec për informimin e anëtarëve të komunitetit rom rreth hartimit të një kërkesë për informacion drejtuar bashkisë apo institucioneve të tjera përkatëse në varësi të rastit dhe ngritjes së shqetësimeve e problematikave të tyre në mënyrë më të gjithanshme përmes një ankese (*morën pjesë 25 veta*).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Romët në Lushnjë dhe Pogradec kanë pak ose aspak informacion mbi të drejtat e njeriut si e drejta për proces të drejtë gjyqësor, e drejta e barazisë me të tjerët, e drejta për informim, të drejtat pronësore, të drejtat familjare etj., si dhe instrumentet e ndihmës ligjore falas.
- Romët në Lushnjë dhe Pogradec hasin vështirësi në qasjen e strehimit dhe shërbimeve publike. Ata hasin vështirësi edhe në qasjen në sistemin e drejtësisë si depozitim dhe çështjeve të divorcit në gjykatë, apo pagimin dhe ndjekjen e procedurave për birësim fëmije.
- Afro 50% nga 70 të intervistuar zbuluan nuk kishin thuar asnjë informacion për institucionet që

merren me çështjet e të drejtave të njeriut dhe ato rrome, si avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Komuniteti rom has shumë problematika dhe përfshihet në çështje ligjore lidhur dhe qasjen në skemat t mbrojtjes sociale, punësimit, infrastrukturës, dëbimit, divorcit dhe birësimit të fëmijëve në Shqipëri, por ka mungesë informacioni mbi të drejtat, procedurat dhe institucionet që mund t'i zgjidhin këto çështje, ose mund t'i ndihmojnë ata duke i ofruar ndihmë ligjore falas.

### Rekomandime

- OSHC-të dhe institucionet shtetërore që merren me çështjet e të drejtave të njeriut dhe rrome si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të vijojnë të organizojnë seanca informuese periodike për të ofruar informacione dhe ndërgjegjësuar anëtarët e komunitetit rom mbi të drejtat e njeriut, procedurat dhe institucionet që mund t'i zgjidhin çështjet e tyre. Krahas kësaj, duhen organizuar një sërë seancash informuese për të drejtën e informimit, ligjin e ndihmës ligjore falas, konceptet bazë të të drejtave të njeriut dhe qasjen në sistemin e drejtësisë (për shembull, sistemi i gjykatave dhe gjykata administrative) etj.
- OSHC-të që punojnë me komunitetet rrome duhet të vijojnë të organizojnë workshope rreth hartimit të kërkesave për informacion drejtuar institucioneve publike, ngritjes së shqetësimeve në mënyrë më të detajuar me shkrim, hartimit të përfundimeve, depozitimit të shkresës në institucionin e duhur shtetëror etj.

## 9. Organizata: Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale/ ALTRI

<b>Titulli i projektit</b>	Fuqizimi i qasjes së qytetarëve në drejtësi përmes edukimit ligjor të publikut
<b>Qëllimi i projektit</b>	Vlerësimi i situatës së edukimit ligjor të publikut (ELP) në Shqipëri, për hartimin e Strategjisë ELP, e cila do të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, krahas Planit Kombëtar të Veprimit për t'u zbatuar në të ardhmen, si dhe ndërgjegjësimi rreth çështjeve ELP.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017- maj 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Në të gjithë Shqipërinë

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi vlerësimin e nevojave** për Edukimin Ligjor të Publikut/ELP;
  - Shqyrtoi raportet dhe materialet e lidhura me aktivitetet ELP në Shqipëri
  - Shqyrtoi praktikat më të mira ndërkombëtare të ELP-së
  - Organizoi fokus grupe dhe intervista me institucionet e sektorit publik, jofitimprurës, arsimor dhe privat të angazhuara në ELP
- **Projektoi** strukturën dhe hartoi Strategjinë Kombëtare të Edukimit Ligjor të Publikut/SKELP.
- **Organizoi 4 mbledhje konsultuese** me përfaqësues të institucioneve publike dhe të shoqërisë civile për të diskutuar çështjet e ELP-së (167 përfaqësues të përfshirë).
- **Finalizoi SKELP-in** pas procesit konsultues, të cilën ia paraqiti Kuvendit (u miratua në maj 2019),

duke ngritur një kuadër ligjor dhe rregullator të konsoliduar për përmirësimin e ELP-së, si premisë e parë për ngritjen e burimeve dhe mekanizmave për ofrimin e saj për qytetarët shqiptarë.

- **Organizoi 5 mbledhje konsultuese** për të diskutuar Planin Kombëtar të Veprimit/PKV për zbatimin e SKELP-it (220 përfaqësues të përfshirë).
- **Organizoi 2 mbledhje konsultuese** për të zhvilluar PKV-në për zbatimin e SKELP-it, një me përfaqësuesit e institucioneve publike dhe një me donatorët, ambasadat, shoqërinë civile, qytetarët dhe studentët (82 përfaqësues të përfshirë).
- **Organizoi 2 mbledhje konsultuese /tryeza të rrumbullakëta** për finalizimin e PKV-së dhe organizoi mbledhje me përfaqësues të institucioneve publike, shoqërisë civile dhe donatorëve (82 përfaqësues të përfshirë).
- **Ndërmori fushata për edukimin e publikut** mbi SKELP-in dhe PKV-në për të ndërgjegjësuar dhe shtuar numrin e individëve dhe institucioneve të informuara përmes 4 intervistave televizive, një interviste në radio, një mesazhi ndërgjegjësues i cili i transmetua në 7 radio dhe media sociale, si dhe 2 artikuj të botuar në revistën "Avokatia".
- **Organizoi 4 trajnime** me institucionet dhe zyrtarët kryesorë publikë të autorizuar për zbatimin e SKELP-it dhe PKV-së në Shkodër, Vlorë, Tiranë dhe Korçë (121 pjesëmarrës).
- **Organizoi aktivitetin "Rishikimi i Progresit dhe Hapi i Ardhsëm"**: aktiviteti përmbyllës "Sfidat në hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Edukimin Ligjor të Publikut dhe veprimet pasuese" u organizua më 14 qershor 2019 me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet publike vendore dhe qendrore, OSHC-të, fakultetet etj.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Institucionet publike nuk kanë plane mbi ofrimin e ELP-së.
- Nuk ka koordinim midis institucioneve lidhur me ELP-në.
- ELP-ja ofrohet kryesisht nga OSHC-të me mbështetjen e donatorëve.
- Nevoja për ELP në Shqipëri ishte e ngutshme, pasi vendi po i nënshtrohet reformimit ligjor dhe institucional, duke i kërkuar gjyqësorit të luftojë korrupsionin dhe të konsolidojë shtetin ligjor.
- Trajnimet për institucionet përgjegjëse për ELP-në zbuluan se këta të fundit nuk kanë njohuri të thella mbi çështjet ligjore.
- Mbledhjet me qytetarët treguan se ata nuk kishin njohuri dhe se informacionet për këto çështje i merrnin kryesisht përmes televizorit, veçanërisht reformës në drejtësi.

### Rekomandime

- Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit brenda afateve të caktuara.
- Parashikimi i kostove përkatëse për zbatimin e strategjisë në programin buxhetor afatmesëm 2020-2022 të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera përkatëse.
- Zbatimi i strategjisë sipas Planit të buxhetuar të Veprimit pas miratimit të këtij të fundit.
- OSHC-të, në koordinim me institucionet përkatëse dhe fakultetet e juridikut, të vijojë të ndërgjegjësojë qytetarët mbi çështjet e ELP-së.
- OSHC-të, në koordinim me institucionet përkatëse, duhet të organizojnë trajnime për nëpunësit publikë përgjegjës për ELP-në në mënyrë që këta të fundit të thellojnë njohuritë e tyre, si dhe të koordinojnë trajnimet për ELP-në për nëpunës publikë të niveleve të tjera (niveli i mesëm apo specialist, për institucionet vendore dhe qendrore, puna e të cilëve lidhet drejtpërdrejt me qytetarët).

## 10. Organizata: Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik/IPSED

<b>Titulli i projektit</b>	Informimi i qytetarëve dhe qasje më e mirë në drejtësi në qarkun e Lushnjës
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në sistemin e drejtësisë duke ngritur kapacitetet vendore, bazuar në përfundimet dhe rekomandimet nga prizmi i qytetarëve, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Edukimin Ligjor të Publikut
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	mars - dhjetor 2018
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Lushnjë

### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi 5 tryeza të rrumbullakëta** mbi “Informimin e Qytetarëve për Qasjen në Drejtësi” në Lushnjë për të diskutuar parimet e ELP-së, se si mund të zbatohet ajo në rrethin e Lushnjës, si mund të rriten mundësitë që palët e interesit të trajtojnë popullatat e cenueshme, si dhe si të përmirësohet qasja e qytetarëve në drejtësi (p.sh Bashkia e Lushnjës e rihartoi Marrëveshjen për Mekanizmin e Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje duke zgjeruar pjesëmarrjen përmes rritjes së numrit të palëve vendore të interesit) (përfituan 110 palë interesi).
- **Organizoi 12 seanca trajnuese** në Lushnjë për kuadrin ligjor mbi qasjen në drejtësi, si të zbatojmë parimet e qytetarisë aktive për qasjen në drejtësi dhe si të promovohen parimet e ELP-së në komunitet (190 qytetarë të trajnuar). Feedback-u nga trajnimet u përmbledh në raport, ku u pasqyruan disa prej temave kyçe të diskutuara, si dhe disa vështirësi që u hasën nga grupet e cenueshme kur kërkuan respektimin e disa prej të drejtave të tyre.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Tryezat e rrumbullakëta dhe trajnimet zbuluan nevojën urgjente për të adresuar mungesën e barazisë në qasjen në drejtësi, veçanërisht për personat me nevoja të veçanta dhe kategoritë e cenueshme, dhe pikat e dobëta të ndihmës ligjore për shkak të mungesës së buxhetit, specializimit apo edukimit/trajnimet të vazhdueshëm të avokatëve për ndihmën ligjore falas, mungesën e koordinimit institucional etj. Krahas kësaj, mungonin shërbimet e këshillimit dhe ndihmës ligjore në dispozicion të grave, veçanërisht për ato nga minoritetet etnike apo gjuhësore, në zonat rurale dhe të mbijetuarat e dhunës në familje.
- Rreth 78% e të trajnuarve apo të pranishmëve në tryezat e rrumbullakëta (komuniteti rom dhe kategori të tjera të cenueshme) deklaruan se tarifat gjyqësore pengonin qasjen e tyre në drejtësi/gjykata, pasi e kishin të pamundur të punësonin dhe të paguanin një avokat për të marrë asistencë profesionale.
- Qytetarët në përgjithësi, por veçanërisht qytetarët nga grupet e cenueshme hasnin vështirësi në identifikimin e procedurave dhe institucioneve ku mund të drejtoheshin për zgjidhjen e problemeve dhe shqetësimeve të tyre. Në këtë aspekt, nuk kishin informacion për kompetencat dhe procedurat në institucione shtetërore dhe gjykata.
- U vërejt mungesë e edukimit ligjor në arsimin/shkollat parauniversitare dhe fillore, si dhe mosbesimi i të rinjve në institucionet shtetërore.

## Rekomandime

- Ofruesit e ndihmës ligjore si Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë në nivel kombëtar dhe vendor, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për t'iu ofruar shërbimet e tyre edhe personave që nuk kanë njohurinë apo mjetet për t'iu drejtuar këtyre institucioneve. Këto institucione duhet të punojnë ngushtësisht me OSHC-të për të koordinuar punën e tyre në mënyrë më efektive.
- Ministria e Arsimit duhet të hartojë kurrikulën informuese mbi QD-në, të drejtat e njeriut, institucionet shtetërore që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe fushën e tyre të kompetencave, gjykatat, ndërmjetësimin etj.
- OSHC-të apo institucionet e tjera shtetërore duhet t'i përfshijnë dhe motivojnë të rinjtë që të marrin pjesë në seanca informuese dhe aktivitete të tjera për ndërgjegjësimin e publikut në media/media sociale, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin, aftësitë dhe kapacitetet mbi çështjet ligjore. Krahas kësaj, edhe studentët e juridikut duhet të përfshihen (përmes *gjykatave, zyrave të ndërmjetimit apo OSHC-ve që ofrojnë ndihmë ligjore*) në aktivitete vullnetare, për t'iu ofruar informacion ligjor dhe ndihmë ligjore bazë (kur është e mundur) këtyre komuniteteve të cënueshme apo të marginalizuara.

## 11. Organizata: Fondacioni Shqiptar "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve"/ AFRC

<b>Titulli i projektit</b>	Viktimat dhe autorët e mitur: Mbështetja e tyre përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në masat alternative të dënimit përmes zbatimit të ndërmjetësimit viktimë-autor dhe drejtësisë restauruese për të miturit në kontakt me ligjin.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017- maj 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tiranë, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë

### Aktivitetet kryesore

- **Ofroi shërbime ndërmjetësimi viktimë-autor dhe praktika restauruese:** janë menaxhuar 161 çështje përmes ndërmjetësimit dhe praktikave restauruese në rrethet e synuara, të referuara nga Policia (91 çështje), Shërbimi i Provës (36), Prokuroria (12) dhe Instituti i të Miturve në Kavajë (22), prej të cilave 150 çështje u zgjidhën me sukses.
- **Organizoi 7 tryeza të rrumbullakëta informuese dhe ndërgjegjësuere** mbi Drejtësinë Restauruese dhe Ndërmjetësimin në Kodin e Drejtësisë për të Mitur me përfaqësues të institucioneve shtetërore si prokurorë dhe gjyqtarë nga Departamenti i të Miturve, oficerë të hetimit të krimeve dhe oficerë policie në komunitet, zyrtarë të shërbimit të provës, përfaqësues nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës në bashkitë përkatëse, avokatë dhe ndërmjetës, si dhe përfaqësues të shërbimeve psikosociale nga Drejtoritë Arsimore Rajonale (*113 profesionistë të drejtësisë për të mitur*)
- **Organizoi workshop-in** me 34 avokatë mbi çështjet e drejtësisë restauruese, në bashkëpunim

me Dhomën e Avokatisë (*morën pjesë 4 studentë në Master për Sociologji dhe Zhvillim Social*)

- **Shpërndau fletëpalosje** mbi ndërmjetësimin viktimë-autor dhe përfitimet që kanë viktimat e mitur dhe autorët prej tij.
- **Ndërmori fushata në media sociale** për të promovuar drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin viktimë-autor (NVA), veçanërisht për të miturit.
- **Organizoi 3 seanca trajnuese** me profesionistët e drejtësisë për të mitur mbi drejtësinë restauruese dhe programet e ndërmjetësimit viktimë-autor, me fokus të veçantë te të miturit në konflikt me ligjin (*90 pjesëmarrës*).
- **Hartoi dhe shpërndau udhëzime** (200 kopje) për praktikuesit, lehtësuesit dhe ndërmjetësit e DR-së mbi kuadrin ligjor për përdorimin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për të miturit në kontakt me ligjin, si dhe menaxhimin e programeve të drejtësisë restauruese për të miturit.
- **Organizoi workshop njëditor** me ndërmjetësuesit dhe lehtësuesit e drejtësisë për të mitur mbi Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, DR-në dhe ndërmjetësimin (*22 pjesëmarrës*).
- **Hartoi raportin e monitorimit** mbi praktikën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin viktimë-autor të kryer në rrethet e synuara. Raporti përfshin informacion mbi perceptimet e viktimave dhe autorëve të mitur, prindërve të tyre, specialistëve të drejtësisë për të mitur, ndërmjetësve, dhe ofruesve të drejtësisë restauruese, si dhe informacion mbi qasjet e DR-së, ndërmjetësimin dhe ndikimin e tyre.

### **Përmbledhje e gjetjeve**

- Shumë pak avokatë (rreth 15% e pjesëmarrësve) që morën pjesë në workshop mbi DR-në dhe Ndërmjetësimin kishin informacion paraprak mbi përdorimin e masave të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për të miturit.
- Prokurorët nuk i kishin të qarta procedurat e referimit në programet e ndërmjetësimit, ndaj ishin në pritje të udhëzimeve nga Prokuroria e Përgjithshme.
- Specialistët e Drejtësisë për të Mitur shprehën shqetësimin se mungonte infrastruktura e nevojshme për zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur të miratuar rishtas.
- Asnjë prej specialistëve të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës nuk kishte informacion paraprak mbi drejtësinë restauruese dhe qasjet alternative të ndërmjetësimit.
- U vërejt në përgjithësi se njerëzit nuk janë të ndërgjegjshëm për mundësitë për të kaluar në programet e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese.
- Kapacitetet dhe profesionalizmi i ofruesve të ndërmjetësimit nuk janë në nivelin e duhur (**mendimet e shprehura gjatë trajnimeve**).
- DR-ja dhe ndërmjetësimi mund të ofrohen vetëm në rrethet më kryesore, pasi këto shërbime mungojnë në zonat e largëta.
- Shërbimi i ndërmjetësimit për të miturit duhet ofruar falas (në zbatim të Kodit të DM-së), po për këtë nuk është planifikuar asnjë buxhet. Shërbimet e ndërmjetësimit varen kryesisht nga OSHC-të.
- Profesionistët e DM-së nuk janë të mirinformuar për ofruesit e shërbimit të ndërmjetësimit në rrethet e tyre.
- Grupet shumëdisiplinore për autorët e mitur (*të përbërë nga punonjës social, psikologë, profesionistë ligjorë etj., për t'i ndihmuar të miturit në programet individuale të riintegritit*), siç parashikohen në KDM nuk janë ende funksionale për shkak të koordinimit të papërshtatshëm midis agjencive përkatëse dhe paqartësisë për rolin e secilës agjenci.



## Rekomandime

- Të gjithë profesionistët e DM-së, duke përfshirë psikologët, stafin e NJMF-ve, punonjësit socialë, avokatët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për mundësitë e kalimit të çështjes së të miturit në programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit.
- Nevojitet ndërgjegjësimi i publikut mbi kalimin në programet e ndërmjetësimit.
- Aftësitë e ndërmjetësve gjatë lehtësimit të proceseve restauruese me palët e mitura duhen përmirësuar dhe shërbimi duhet të jetë i qasshëm në të gjitha rrethet e vendit, jo vetëm në qytetet kryesore. Sipas Kodit të DM-së, të gjithë ndërmjetësit duhet të jenë të specializuar në DM, të regjistruar në MPJ; nuk ka nevojë për program specifik trajnimi.
- Lista e ndërmjetësve të specializuar në DM duhet ngarkuar në faqen e internetit të MPJ-së, të gjykatave dhe të prokurorive.
- Nevojitet më tepër lobim dhe advokim pranë Ministrisë së Drejtësisë për buxhetimin e shërbimeve të ndërmjetësimit.

## 12. Organizata: Meridia

<b>Titulli i projektit</b>	Qasje më e mirë në drejtësi dhe praktika të mira për të reduktuar përsëritjen e veprës penale nga të miturit në konflikt me ligjin
<b>Qëllimi i projektit</b>	Reduktimi i nivelit të përsëritjes së veprës penale nga të miturit në konflikt me ligjin përmes shërbimeve të drejtpërdrejta të riintegritimit të tyre në shoqëri.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Kavajë, Krujë

### Aktivitetet kryesore

- **Ofroi shërbime** për fëmijët në konflikt me ligjin në Kavajë dhe Krujë: janë mbështetur 27 fëmijë në konflikt me ligjin të cilët janë në proces riintegrimi në shoqëri përmes:
  - Planeve individuale të riintegritimit bazuar në edukimin gjatë heqjes së lirisë, formimin dhe sjelljen profesionale, si dhe aktivitetet e paskujdesit për të mbështetur familjet gjatë kthimit në komunitet.
  - Dita e Familjes: u organizuan 4 aktivitete në partneritet me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Burgun e Kavajës për ndërgjegjësimin e prindërve mbi rolin e tyre në procesin e riintegritimit të fëmijëve të tyre në shoqëri (morën pjesë 40 prindër).
  - Formim në vendin e punës: Nga skema 5 mujore e formimit në vendin e punës përfituan 5 fëmijë nën mentorim; pas vlerësimit të kapaciteteve dhe kompetencave, iu dha një pagesë minimale (duke përfshirë edhe sigurimet).
- **Organizoi 9 mbledhje** me Grupet Bërthamë Rajonale në Krujë dhe Kavajë me pjesëmarrjen e shërbimeve sociale të bashkive, zyrave vendore dhe kombëtare të punës, OSHCve, ofruesve të shërbimeve në nivel vendor, qendrave të formimit profesional, komunitetit të biznesit dhe familjarëve për të lehtësuar procesin e riintegritimit dhe për të siguruar përshtatshmërinë e çështjeve të menaxhuara.

- **Organizoi 2 kurse trajnimi në nivel rajonal:** një në Kavajë dhe një në Krujë mbi kodin e drejtësisë për të mitur, legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për drejtësinë për të mitur, me fokus të veçantë te komponenti i riintegrit, me përfaqësues të autoriteteve shtetërore vendore, zyrtarë rajonale të punës, institucioneve rajonale të formimit profesional, njësitë të mbrojtjes së fëmijës, specialistëve të mbrojtjes së fëmijës, bashkisë dhe komunitetit të biznesit (30 pjesëmarrës).
- **Zhvilloi workshop për ndarje njohurish** me qëllim promovimin e veprimeve, arritjeve dhe rezultateve, transferimin e njohurive dhe ndarjen me njëri-tjetrin të mësimëve të nxjerra dhe praktikave më të mira. Në këtë workshop morën pjesë përfaqësues të autoriteteve shtetërore në nivel vendor dhe kombëtar si: Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, bashkia Durrës, Zyra Rajonale e Punës, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës - specialistët e NJMF-së, përfaqësues të OSHC-ve në nivel vendor dhe kombëtar, si dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit (42 pjesëmarrës).

### **Përmbledhje e gjetjeve**

- Marrëdhënia midis OSHC-ve dhe kompanive të biznesit është paksa e ndërlikuar pasi palët nuk ndajnë qëllime të njëjta.
- Programet e formimit profesional nuk janë gjithnjë në përputhje me nevojat e komunitetit, çka do të thotë se këto programe janë hartuar në rang kombëtar dhe nuk marrin parasysh veçantitë e rretheve apo dallimet midis komuniteteve, ose veçantitë e qarqeve/rretheve.
- Marrëdhënia me familjarët dhe të afërmit e të miturve në konflikt me ligjin luan rol kyç në procesin e suksesshëm të riintegrit.

### **Rekomandime**

- Institucionet shtetërore duhet të ofrojnë politika nxitëse për kompanitë private, që këta të fundit të punësojnë (*përkohësisht ose përherë*) të miturit në konflikt me ligjin, si pjesë e riintegrit të tyre në shoqëri.
- Institucionet shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e programeve të formimeve profesionale duhet të rivlerësojnë përmbajtjen dhe tipologjinë e kurseve formuese bazuar në kërkesën dhe nevojat e komunitetit. Këto kurse duhet të kenë kurrikul dhe literaturë të miratuar paraprakisht për të mbështetur personat që ndjekin këto kurse dhe në veçanti të miturit në konflikt me ligjin që dëshirojnë të riintegrohen në shoqëri duke mësuar një zanat dhe punuar në kompanitë e biznesit në rrethet e tyre ose si sipërmarrës privatë.
- Institucionet shtetërore duhet të hartojnë programe të posaçme për të fuqizuar lidhjet midis të miturve dhe familjarëve/të afërmeve të tyre për integrim sa më të mirë në shoqëri.
- Gjatë hartimit të planeve individuale për riintegrim në shoqëri u duhet kushtuar vëmendje kapaciteteve individuale dhe aftësive profesionale të të miturve.

### 13. Organizata: Young Man Christian Association/YMCA

<b>Titulli i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe plotësimi i nevojave të viktimave të dhunës për fuqizim dhe integrim nga komuniteti dhe institucionet
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes së publikut të gjerë në drejtësi përmes edukimit ligjor dhe ofrimit të shërbimeve ligjore falas për çështjet penale dhe civile për grupet e synuara të cenueshme.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tropojë, Krujë

#### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi 13 seanca informuese** me të rinj dhe anëtarë komuniteti mbi çështjet e DM-së, ndryshimet e legjislacionit për të miturit, çështjet e QD-së, DHF-në, UM-të dhe u dhanë këshilla praktike se si mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas (*morën pjesë 426 veta, 278 prej të cilëve ishin të rinj nën 18 vjeç dhe 148 veta mbi 18 vjeç*).
- **Ofroi ndihmë ligjore për 60 çështje/konflikte të identifikuara** (*çështjet u referuan nga bashkitë dhe njësitë administrative dhe lidheshin me çështje administrative, penale, civile, dhunë në familje, divorc, kujdestarinë e fëmijëve, daljen në pension, kufijtë pronësorë, konflikt me OSHEE-në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike etj.*). Në Tropojë u zgjidhën 22 çështje, të cilat u mbyllën brenda afatit të projektit, ndërsa në Krujë u zgjidhën 38 të tilla (*34 të mbyllura, 4 në proces*).
- **Ndërmori fushata ndërgjegjësuere:** Anëtarëve të komunitetit, institucioneve dhe palëve të tjera vendore të interesit iu shpërndanë 3000 fletëpalosje mbi qasjen në drejtësi

#### Përmbledhje e gjetjeve

- Mbledhjet dhe seancat informuese treguan se angazhimi i palëve vendore të interesit, veçanërisht i bashkive dhe zyrave të ndihmës ekonomike ka shumë rëndësi për të zbatuar më mirë kërkesat ligjore të lidhura me drejtësinë për të mitur, dhunën në familje, konfliktet në të drejtën familjare, kujdestarinë e fëmijëve, konfliktet për pronën etj.
- Seancat informuese në disa shkolla ishin tepër interesante për sa i përket njohurive dhe informacioneve të ndara; përfituesit shprehën interes për informacione shtesë.

#### Rekomandime

- Gjykata duhet të jetë më efikase gjatë gjykimit të çështjeve: koha midis dy seancave është tepër e gjatë; edhe procesi në vetvete është i gjatë.
- Institucionet shtetërore duhet të ofrojnë ndihmë ligjore falas jo vetëm për palët ndërgjyqëse (*qasje në gjykatë*), por edhe kur qytetarët ngrenë pretendimet/depozitojnë çështjet te institucionet administrative (*qasje në institucionet administrative*). Njëkohësisht, ndihma ligjore duhet ofruar jo vetëm nga OSHC-të, por edhe nga institucionet shtetërore në mënyrë efikase.

## 14. Organizata: Për ju nëna dhe fëmijë

<b>Titulli i projektit</b>	Drejtësia për të mitur siguron të ardhmen
<b>Qëllimi i projektit</b>	Zbatimi i duhur i të drejtave ligjore të të miturve të bashkisë Kukës në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin gjatë procedimeve civile, administrative dhe penale.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Kukës

### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi seanca informuese me të miturit (14-18 vjeç)** në shkollat fillore dhe të mesme në bashkinë Kukës dhe njësitë administrative Bardhoc, Shtiqen dhe Bicaj në formë diskutimi dhe bisede të lirë mbi të drejtat e fëmijëve dhe të miturve në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin (18 seanca; morën pjesë 442 nxënës).
- Organizoi seanca informuese me prindërit mbi të drejtat e fëmijëve dhe të të miturve në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin, si dhe rolin dhe kompetencat e NJMF-ve (2 seanca, 52 anëtarë komuniteti).
- **Organizoi workshop-e** me mësuesit mbi çështjet e DM-së, Kodit për të Mitur, të drejtat e fëmijëve dhe të miturve në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin, qasjen e të miturve në sistemin e drejtësisë, komunikimin me të miturit (2 seanca, morën pjesë 53 mësues).
- **Zhvilloi mbledhje** për të caktuar kontaktet, diskutuar çështjet që përfshijnë të mitur në kontakt dhe/ose në konflikt me ligjin, koordinuar përpjekjet e përbashkëta për t'i shqyrtuar dhe zgjidhur çështjet me Policinë (12 mbledhje), Shërbimin e Provës (6), Gjykatën e Kukësit (12), Gjykatën e Shkodrës (8), Drejtoritë Arsimore Rajonale (11), shkollat (6) dhe NJMF-të e bashkisë Kukës (6).
- **Hartoi raportin** për zbatimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin gjatë proceseve gjyqësore (për proceset civile, administrative dhe penale), bazuar në të dhënat e mbledhura nga 6 çështjet që përfshinin të mitur në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin dhe monitorimin e seancave (6 u zhvilluan në Gjykatën e Rrethit Kukës dhe 1 në Gjykatën e Rrethit Shkodër)
- **Ndërmori fushata ndërgjegjësuere (1,000 fletëpalosje, 100 postera, 1 banderolë, si dhe postime në media sociale)** me mesazhe mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve. Gjatë aktiviteteve u shpërndanë materiale informuese, të cilat u afishuan në mjediset e institucioneve publike që merren me të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve (si gjykatat, prokuroritë, bashkitë, njësitë administrative, shkollat, vendet publike etj.) U informuan 442 të mitur të grupmoshës 14-18 vjeç.
- **Ofroi konsultim/informim ligjor** për të rinjtë në kontakt/konflikt me ligjin për 30 çështje.
- **Organizoi 3 tryeza të rrumbullakëta** me përfaqësues të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të institucioneve të tjera që merren me të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur (veçanërisht në Kodin për të Mitur) si gjyqtarë, prokurorë, përfaqësues të shërbimit të provës, njësisë për mbrojtjen e fëmijës, zyrës përmbartimore, administratës gjyqësore, policisë, Drejtorive Arsimore Rajonale, shërbimit psikosocial në shkolla (morën pjesë 76 veta).
- **Organizoi 2 trajnime** për institucionet e sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera që merren me të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur dhe restauruese, konsultimin e planeve për të miturit në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin, konsultimin psikosocial dhe rëndësinë e tij në procesin e vlerësimit dhe korigjimit të personalitetit të të miturit, rolin e oficerit edukues në shkolla etj. (morën pjesë 47 përfaqësues)

## Përmbledhje e gjetjeve

- Seancat informuese, workshop-et, mbledhjet dhe aktivitetet e tjera ndërgjegjësuere të ndërmarra nga projekti treguan se ka mungesë informacioni dhe ndërgjegjësimi në shkolla, komunitet, institucione shtetërore dhe shoqëri civile mbi çështjet e të miturve në konflikt me ligjin, si dhe rehabilitimin apo riintegrimin e tyre në shoqëri.
- Zakonisht, të miturit në konflikt me ligjin nuk i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e çështjeve, por zgjedhin rrugë alternative, pasi nuk duan të identifikohen në shoqëri si njerëz që kanë probleme me institucionet e drejtësisë.
- Trajnimet me oficerët e policisë dhe përfaqësues të tjerë nga institucionet e drejtësisë treguan se kishin pak apo aspak informacion se si t'i trajtonin të miturit në kontakt me ligjin, për shkak të faktit se legjislacioni mbi këto çështje sapo është miratuar dhe përditësuar.

## Rekomandime

- Trajnimi i punonjësve në institucionet e drejtësisë dhe ato shtetërore mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe njohjen e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për drejtësinë për të mitur.
- Krijimi i kushteve (*infrastrukturës*) për pritjen e fëmijëve në mjediset e Policisë dhe shtimi i mundësive që kriminelët e mitur të shoqërohen nga prindërit e tyre në rajonet e policisë (*për 72 orë maksimumi*).
- Rishikimi i kurrikulës së shkollës duke shqyrtuar mundësinë e përfshirjes së informacionit rreth Kodit për të Mitur në arsimin fillor dhe kryesisht në atë të mesëm.
- Organizimi i aktiviteteve edukuese midis shkollave dhe policisë si mjet për parandalimin e kriminalitetit të të miturve.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me institucionet e drejtësisë, të cilave duhet t'i kërkohet të vëzhgojnë dhe raportojnë ecurinë e çështjeve të të miturve.
- Zhvillimi i seancave informuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere edhe për prindërit dhe fëmijët mbi çështjet e DM-së, në bashkëpunim me OSHC-të dhe policinë.
- Shtimi i aktiviteteve edukuese dhe sportive (ambientet sportive) për të rinjtë, në mënyrë që kohën e lirë ta kalojnë duke u marrë me sporte dhe jo konflikte.
- Shtimi i mundësive për formim profesional për të rinjtë veçanërisht për migrantët dhe djemtë (*statistikat tregojnë se kriminelët e mitur janë kryesisht djem*).
- Forcimi i kapaciteteve të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës dhe Shërbimit Psikosocial nëpër shkolla, duke i trajnuar vazhdimisht mbi çështje të drejtësisë për të mitur dhe praktikat rehabilituese.

## 15. Organizata: Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza/ LKGV

<b>Titulli i projektit</b>	Mbrojtja e të drejtave të viktimave të DHBGJ-së dhe DHF-së, dhe promovimi i qasjes më miqësore të viktimës në drejtësi
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi përmes ndihmës ligjore për gratë viktimë të DHBGJ-së dhe DHF-së, për të konsoliduar dhe promovuar të drejtat e viktimës për qasje në sistemin e drejtësisë përmes ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve, rehabilitimit të autorëve dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik mbi të drejtat e viktimës në drejtësi.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2017 – janar 2018
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Krujë, Kurbin, Lushnjë, Pukë, Tiranë, Pogradec

### Aktivitetet kryesore

- **Ofri këshillim ligjor për viktimat** e DHBGJ-së dhe DHF-së (iu dha asistencë 1874 grave viktimë të DHBGJ-së dhe DHF-së, si dhe familjarëve të tyre. Afro 700 gra dhe vajza u mbështetën përmes këshillimit ligjor nga stafi i LKGV-së).
- **Zhvilloi aktivitete rehabilituese pikosociale** për autorët në burg (381 seanca këshilluese me 62 autorë).
- **Zhvilloi trajnime** për stafin e burgjeve dhe shërbimit të provës në zonat e ndërhyrjes (3 seanca trajnuese me punonjësit e institucioneve të vuajtjes së dënimit (penitenciare) dhe Shërbimit të Provës në Tiranë, Shkodër dhe Pogradec me pjesëmarrjen e 37 punonjësve në total).
- **Organizoi diskutime në panel të nivelit të lartë** mbi qasjen në drejtësi të viktimave të DHBGJ-së dhe DHF-së (u prezantua dhe diskutua studimi për Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes të lëshuara për gratë, viktimat e DHBGJ-së nga Gjykata e Rrethit Tiranë për vitin 2018).
- **Organizoi 4 workshop-e me të rinjtë** për informimin ligjor mbi DHBGJ-në dhe DHF-në, trajtimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe kuadrin ligjor shqiptar për DHBGJ-në dhe DHF-në (morën pjesë 180 të rinj).
- **Ofri informacion ligjor** për të drejtat e grave dhe procedurat e qasjes në drejtësi dhe institucione të tjera përmes shpërndarjes së posterave dhe fletëpalosjeve, fushatave në mediat tradicionale dhe sociale (shpërndau fletëpalosje dhe prodhoi një sport radiofonik për të drejtat e grave, ndihmën ligjore, programet e rehabilitimit)
- **Organizoi trajnime për gazetarët** që merren me çështjet e drejtësisë dhe ato sociale për mbulimin e historive që lidhen me DHBGJ-në (morën pjesë 15 gazetarë).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Ndhma ligjore që garantohet nga shteti, siç parashikohet në Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën ligjore nga shteti” nuk është plotësisht funksionale. Qytetarët e referuar nga Linja e Këshillimit në Gjykatën e Tiranës për të marrë ndihmë ligjore dytësore falas nuk e morën këtë ndihmë për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare.
- Oficerët e policisë ishin pjesërisht të informuar për ndryshimet e Ligjit “Për masat kundër dhunës në marrëdhënie familjare” dhe detyrat e përgjegjësitë që rridhnin prej tij, për shkak të mbingarkesës ditore në punë, e cila nuk ka të bëjë gjithnjë me DHF-në dhe ndryshimet organizative (stafi lëvizet nga një divizion në tjetrin) dhe kjo prek përvetësimin e njohurive. Gjithashtu, njohuritë

dhe informacionet e stafit të burgjeve dhe shërbimit të provës mbi këtë çështje ishin thuajse në të njëjtin nivel me të policisë.

- Nga trajnimet u vërejt qartë se punonjësit e policisë ndiheshin më të përgjegjshëm dhe më proaktivë në mbrojtjen e të drejtave të viktimave, për të garantuar sigurinë e tyre dhe parandaluar krimin. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për stafin e burgjeve dhe shërbimit të provës, të cilët janë disi më të shkëputur pasi nuk kanë komunikime të drejtpërdrejta me viktimat. Megjithatë, stafi i burgjeve dhe shërbimit të provës ishin më të informuar për shërbimet e rehabilitimit për autorët.
- Policët nuk i njihnin shërbimet e rehabilitimit, pasi nuk i referonin autorët në këto shërbime, por shprehën gatishmërinë për ta bërë këtë gjë në të ardhmen.
- Trajnuesit identifikuan mungesë bashkëpunimi midis policisë dhe gjykatave, veçanërisht për urdhrat e mbrojtjes. Policia nuk i mbështeste gjithnjë vendimet e gjykatave (*ndonjëherë gjykatat refuzonin të lëshonin urdhra mbrojtjeje*). Megjithatë, gjyqtarët shprehën pakënaqësi për cilësinë e kërkesave (*për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes*) që merrnin nga policia, pasi përmbanin shumë gabime, duke mos i lejuar gjyqtarët që të ecnin përpara me procesin gjyqësor.
- Të gjithë punonjësit e trajnuar ishin më se të hapur për trajnime dhe informim mbi çështje si qasja e viktimës në drejtësi, të drejtat e viktimës, të grave etj.
- Gjyqtarët nuk trajnohen për ndryshimet e reja ligjore mbi DHF-në dhe nuk përfshihen në proceset e konsultimit për këto ligje.

## Rekomandime

- Forcimi i rolit të gjykatave në Mekanizmat Kombëtare të Referimit. Rekomandohet pasja e një punonjësi të posaçëm në gjykatë për ndjekjen e procesit për çështjet e viktimave të dhunës dhe autorëve në koordinim me palët e tjera të interesit (punonjësit socialë, departamentet e policisë, prokuroritë dhe gjyqtarët) si një mënyrë për zbatimin e ligjit dhe përmirësimin e zbatimit të vendimeve të gjykatës nga autori.
- Zhvillimi i politikave më gjithëpërfshirëse lidhur me programet e ndërhyrjes dhe rehabilitimit për autorët, të cilat mund të shërbejnë si model të rrugëve civile dhe penale që ndiqen për autorët e dhunës në familje, për të përmirësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.
- Vlerësimi i ligjeve aktuale që specifikojnë metodat e raportimit lidhur me dhunën në familje për të analizuar nëse identifikimi i hershëm i çështjeve sjell rezultate më të mira për viktimat.
- Zbatimi i një mekanizmi për paralajmërimin e hershëm të gjyqtarëve për të gjurmuar shkeljet e mundshme të urdhrave të mbrojtjes, i ndërthurur me të dhëna/statistika dhe analizimin e efikasitetit të zbatimit.

## 16. Organizata: Qendra Psiko-Sociale “Vatra”

<b>Titulli i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës dhe i shërbimeve ligjore për to
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i mbrojtjes ligjore dhe qasjes në shërbimet e drejtësisë për viktimat e dhunës në familje
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	janar 2018- qershor 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Rrethi i Vlorës

### Aktivitetet kryesore

- **Ngriti Klinikën Ligjore, e cila ofroi:**
  - Shërbime ligjore/ndihmë ligjore për 192 çështje (*këshillim dhe asistencë ligjore - 20 përfitues të mbështetur me shërbime ligjore u akomoduan në Strehën “Vatra”*).
  - **Shërbime Psikologjike për 156 çështje** (*psikologët kishin ofruar mbikëqyrje të jashtme për 6 fëmijë në Shtëpinë e Fëmijë Vlorë që kishin shfaqur probleme emocionale*).
  - Ofroi shërbime profesionale psikologjike përmes Qendrës për Zhvillim dhe Promovim Social (CPSD) të kontraktuar nga Vatra (*48 çështje janë mbështetur me shërbime psikologjike nga CPSD-ja, si organizatë e specializuar që punon me fëmijët dhe prindërit e tyre*).
  - **Organizoi 1 trajnim** për Klinikën Ligjore dhe stafin administrativ të Vatrës, si dhe studentët e juridikut për ngritjen e ekipeve *pro bono* për ofrimin e shërbimeve ligjore përkatëse dhe monitorim të procesit gjyqësor (*7 punonjës*).
  - **Organizoi 2 trajnime** për shërbimet e ndihmës ligjore dhe monitorim të proceseve gjyqësore për studentët e Fakultetit Juridik “Ismail Qemali” në Vlorë (*morën pjesë 40 studentë*).
  - Organizoi 2 forume me studentët e Fakultetit Juridik “Ismail Qemali” në Vlorë mbi “Legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të viktimave të dhunës dhe trafikimit të personave” (*morën pjesë 65 studentë*) dhe mbi “Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Dhunës dhe Abuzimit: Instrumentet Kombëtare dhe Ndërkombëtare” (*morën pjesë 173 studentë nga Fakulteti i Shkencave Humane*).
  - **Organizoi 34 seanca informuese:** 17 me anëtarë komuniteti dhe 17 me nxënës të shkollave të mesme [u përfshinë 345 gra, vajza dhe burra nga komuniteti, 429 fëmijë të shkollave nëntëvjeçare (12-15 vjeç) nga 13 njësi administrative të Vlorës].
  - **Publikoi dhe shpërndau fletëpalosje** mbi qasjen në drejtësi të viktimave të dhunës.
  - **Zhvilloi 2 bisedime radiofonike** në një radio vendore gjatë së cilës publiku u informua mbi shërbimet falas të ofruara në Klinikën Ligjore të Vatrës.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Oficerët e policisë nuk kanë informacione të hollësishme mbi çështjet e dhunës në familje apo UMM-të (Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes); në disa raste ata i ngatërronin UM-të me UMM-të (dhe anasjelltas) duke i adresuar gjykatës nivelin, nevojën dhe urgjencën e gabuar për mbrojtjen e viktimës.
- Oficerët e policisë nuk kanë informacion mbi ndryshimet e fundit të ligjin për masat kundër dhunës në familje, të miratuar në gusht 2018, sipas të cilit policia luan rol thelbësor pasi Urdhri



Paraparak i Mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje lëshohet prej saj.

- Seancat informuese ngritën shqetësimin se anëtarët e komunitetit nuk kanë informacion mbi legjislacionin për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe kanë pak informacion mbi ndihmën ligjore falas. Vetëm personat që mund të jenë përfshirë në çështje penale mund të kenë informacion të kufizuar për të.
- Rreth 80% e viktimave të dhunës me UM që jetojnë në zonat rurale nuk marrin ndihmë ekonomike si viktimat të dhunës në familje nga Njësia administrative, siç parashikohet nga ndryshimet e ligjit për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale, për shkak të buxhetit të kufizuar.
- Administratorët socialë, kryesisht në zonat rurale nuk mund t'i adresojnë siç duhet nevojat për ndihmë ligjore falas të viktimave sepse nuk kanë informacione të detajuara mbi ligjin e ri për ndihmën ligjore falas. Ata mbulojnë shumë detyra brenda Njesisë Administrative dhe nuk janë të specializuar në ofrimin e informacionit për ndihmën ligjore falas.
- Zyra Përmbartimore has vështirësi në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore kur njëra prej palëve ndërgjyqëse ka detyrimin të paguajë pensionin e fëmijës në favor të fëmijës, për shkak të informalitetit të punësimit.
- Seancat informuese në shkolla ngritën shqetësimin e mungesës së psikologëve në shkollat e zonave rurale. Psikologët janë të pranishëm në shkollat përkatëse vetëm njëherë në javë ose një herë në dy javë, çka është e pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat për këtë asistencë të specializuar.
- Puna e kryer me nxënësit dhe ngritja e ekipit pro bono ka treguar se studentët nuk janë shumë të përfshirë në punë vullnetare dhe në përvetësimin e aftësive praktike në përputhje me profesionin që ata kërkojnë të mësojnë/praktikojnë në të ardhmen.

## **Rekomandime**

- Trajnimi i oficerëve të policisë për përgatitjen dhe hartimin e Urdhrit Paraparak të Mbrojtjes/ UMM-ve/UM-ve dhe çështjet mbi dhunën në familje.
- Trajnimi i administratorëve socialë në bashki apo njësi administrative mbi ligjin për ndihmën ligjore falas.
- Gjetja e mënyrave dhe praktikave të tjera alternative për ta detyruar personin përgjegjës që të paguajë pensionin e fëmijës. Një prej alternativave mund të jetë shtimi i përpjekjeve për luftën ndaj punës informale nga ana e Inspektoratit të Punës.
- Forcimi i rolit të psikologëve në shkolla, kryesisht në zonat rurale ku nuk janë fort të pranishëm.
- Trajnimi i mësuesve për menaxhimin dhe adresimin e situatave ku fëmija përjeton dhunë në familje.
- Nevojitet që universitetet t'i nxisin studentët që të përfshihen në punë vullnetare në organizata, institucione apo nivel komunitar.

## 17. Organizata: Lëvizja Rinore për Demokraci/LRD

<b>Titulli i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe plotësimi i nevojave të viktimave të dhunës për fuqizim dhe integrim nga komuniteti dhe institucionet
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe reagimit të komunitetit dhe institucioneve ndaj viktimave të dhunës në familjes.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill - mars 2018
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Pukë, Fushë Arrëz

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi një raport vlerësimi** mbi faktorët që ndikojnë te dhuna dhe profilet e viktimave të dhunës duke përfshirë stafin e bashkisë që punojnë me çështjet gjinore, stafin e zyrës së punës dhe oficerët e policisë në rajonin vendor të policisë.
- **Ofroi shërbime këshillimi për 36 viktimat të dhunës:** këshillim ligjor dhe emocional, si dhe shërbime informuese se si të mbrohen nga dhuna; më pas këto raste u referuan nga vetë stafi i bashkisë.
- **Ofroi 2 seanca trajnimi:** një për 33 të rritur për teknikat e ndërmjetësimit dhe një për 48 të rinj (*nxënës të shkollës së mesme*) për teknikat e ndërmjetësimit dhe menaxhimin paqësor të konflikteve.
- **Ngriti Grupet e Ndërmjetësimit:**
  - **Ngriti Grupet Komunitare të Ndërmjetësimit** në Pukë dhe Fushë Arrëz me pjesëmarrjen e 12 individëve (*6 individë për ekip*).
  - **Ngriti Grupet Studentore të Ndërmjetësimit** në Pukë dhe Fushë Arrëz me pjesëmarrjen e 37 studentëve.
- **Ofroi shërbime ndërmjetësimi** (në Pukë dhe Fushë Arrëz) për individët e rritur të përfshirë në konflikt (*30 raste, 18 prej të cilave u ndërmjetësuan me sukses*) dhe për nxënësit e shkollës së mesme (*19 raste, 17 prej të cilave u ndërmjetësuan me sukses*).
- **Organizoi workshop-e** për të ofruar informacion, ndërgjegjësuar dhe rritur kapacitetet e viktimave të DHF-së për ta referuar çështjen te autoritetet përkatëse shtetërore, me përfaqësues të bashkive, policisë vendore, OSHC-ve dhe shkollës së mesme (*morën pjesë 18 veta në Pukë dhe 17 në Fushë Arrëz*).
- **Organizoi një tryezë të rrumbullakët** së bashku kundër dhunës me pjesëmarrjen e 20 palëve të interesit nga Policia Vendore, Zyra e Punës, Bashkia (*Specialist Gjimore, Specialist i Ndihmës Ekonomike dhe Zyra për Mbrojtjen e Fëmijës*), OSHC-të vendore, shkollat dhe komuniteti, që synonte gjetjen e mënyrave për të forcuar reagimin e komunitetit dhe institucioneve kundër dhunës duke fuqizuar Sistemin e Referimit, si dhe alokimin dhe/ose rritjen e buxhetit të bashkisë për viktimat e dhunës në familje, duke ngritur një rrjet funksional midis bashkive, policisë vendore dhe OSHC-ve lidhur me nevojën për zgjerimin dhe modernizimin e shërbimeve bashkiake për fuqizimin e gruas dhe adresimin me sukses të rasteve të dhunës në familje, varfërisë dhe papunësisë.
- **Shpërndau materiale promovuese** për të ofruar informacion dhe rritur ndërgjegjësimin mbi çështjet e DHF-së dhe mekanizmat e raportimit (*p.sh kuadri ligjor për DHF-në, mekanizmi i referimit të rasteve të DHF-së te autoritetet shtetërore, teknikat e ndërmjetësimit dhe menaxhimin paqësor, si dhe informacion të dobishëm për viktimat/viktimat e mundshme të dhunës*) (*100 fletëpalosje*).

- **Hartoi planin e veprimit** për “Forcimin e sistemit të Mekanizmit të Referimit të viktimave të dhunës në familje” në vijim të tryezës së rrumbullakët “Së bashku kundër dhunës” me pjesëmarrjen e 23 palëve të interesit nga bashkia (*strukturat e ndihmës ekonomike, Zyra Ligjore dhe Zyra e Mbrojtjes së Fëmijës*), Departamenti i Policisë, Zyra Arsimore, OSHC-të vendore, Zyra e Punës dhe përfaqësues të komunitetit.
- **Promovoi projektin dhe rezultatet e tij në një emision televiziv** (televizion vendor), duke u fokusuar në Tryezën e Rrumbullakët “Së bashku kundër dhunës”.
- *Zhvilloi aktivitete shitesë ndërgjegjësuere* si ekspozita (*me vizatime dhe art të krijuar nga fëmijët*), murale, ditë marshimi, lojëra sportive, seanca për rrahje mendimesh dhe aktivitete pastrimi kundër dhunës (*në Pukë dhe Fushë Arrëz*) me pjesëmarrjen e 167 të rinjve dhe 70 anëtarë komunitetit.

### **Përmbledhje e gjetjeve**

- Aktivitetet e projektit treguan një interes dhe motivim të madh të palëve të interesit si Policisë Vendore, Zyrës së Punës, Bashkisë (*Specialist Gjnorë, Specialist i Ndhmës Ekonomike dhe Zyra për Mbrojtjen e Fëmijës*), OSHC-ve vendore dhe shkollave për informim mbi çështjet e DHF-së, referimin e rasteve te autoritetet përkatëse dhe dhënien e kontributit në planin e veprimit për forcimin e mekanizmave të referimit për rastet e DHF-së. Përfshirja e mësuesve dhe prindërve rezultoi tepër efikase pasi sollën perceptime të larmishme në diskutim.
- Qasja e projektit për të trajnuar një grup bërthamë studentësh që të shërbejnë si ndërmjetës kolegë, si dhe trajnimi i të rinjve për menaxhimin paqësor të konflikteve ishte tejet efikase dhe e arritshme.
- Rastet e DHF-së nuk raportohen plotësisht te autoritetet shtetërore (*polici, prokurori, apo bashki/njësi administrative*) - gratë viktime të DHF-së nuk kanë të ardhura vetjake, kanë mungesë vetëbesimi dhe frikë se do të humbasin kujdestarinë e fëmijëve për shkak të mentalitet të vendasve; në këto rrethana, e kanë të vështirë të ngrenë padi kundër autorëve, të referojnë rastin te institucionet përkatëse, apo ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit.
- Aktualisht, në Shqipëri nuk ka streha 48 orëshe të nevojshme për akomodimin e viktimave dhe fëmijëve të tyre, ndryshe nga shumë shtete të tjera, të cilat i kanë vënë këto streha në dispozicion.

### **Rekomandime**

- Shumëfishimi i programeve edukuese për fëmijët në shkolla mbi menaxhimin paqësor të konfliktit dhe ndërmjetësimin.
- Institucionet shtetërore duhet të angazhohen më tepër në ofrimin e mundësive të punësimit për gratë viktime të dhunës.
- Forcimi i Sistemit të Referimit për adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve të DHF-së te institucionet përkatëse (policia, gjykata, bashkia) përmes bashkëpunimit më të mirë të komunitetit dhe këtyre institucioneve, si dhe koordinimit më të mirë të punës midis tyre.

## 18. Organizata Rrjeti i Grave në Demokraci/WDNA

<b>Titulli i projektit</b>	Konsolidimi dhe promovimi i qasjes së të drejtave të viktimave të dhunës në drejtësi, përmes forcimit të kapaciteteve të avokatëve dhe ofrimit të rekomandimeve ligjore për reformën në fushën e dhunës me bazë gjinore
<b>Qëllimi i projektit</b>	Forcimi i kapaciteteve të avokatëve për mbrojtjen e viktimave të dhunës, për të përfaqësuar më mirë interesat e tyre përmes praktikave ndërvepruese, dhe zhvillimi i teknikave dhe strategjive të hetimit, mbledhjes së të dhënave mbi çështjen, intervistimit të dëshmitarëve, ruajtjes së provave dhe kërkesës për dëmshpërblimin e duhur të klientëve.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill - nëntor 2018
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Kurbin (Laç), Krujë, Pogradec, Sarandë

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi një manual për avokatët** mbi çështjet e DHBGJ-së, me fokus të veçantë te DHF-ja, për të shërbyer si një mjet trajnimi, i cili përmban një përmbledhje të legjislacionit shqiptar dhe të të gjitha konventave lidhur me këtë temë, të ratifikuara nga Shqipëria, si dhe çështje të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me këtë temë; 300 kopje të manualit u shpërndanë në trajnime, seanca informuese dhe në workshop-in përfundimtar.
- **Organizoi trajnime** për avokatët në katër qytete për ngritjen e kapaciteteve të tyre për të punuar mbi raste të DHBGJ-së, bazuar në instrumente të reja ligjore dhe konventa, duke përfshirë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së – (80 avokatë të trajnuar).
- **Organizoi Ditët e Informimit mbi DHBGJ-në** për t'i informuar qytetarët mbi të drejtat e tyre, me fokus të veçantë te DHF-ja, në katër qytetet përkatëse të synuara nga projekti, si dhe në Tiranë.
- **Hartoi dhe shpërndau materiale promovuese** mbi çështjet e DHF-në dhe DHBGJ-në (2.000 fletëpalosje iu shpërndanë qytetarëve në 4 qytetet e synuara, konkretisht në Kurbin, Sarandë, Pogradec dhe Krujë, si dhe 400 fletëpalosje në konferencën përmblylëse në Tiranë).
- **Organizoi një Konferencë Kombëtare** mbi “Ligjet për DHBGJ-në, Aktualiteti dhe Perspektiva” me profesionistë ligjorë, duke përfshirë punonjës policie, avokatë, prokurorë, gjyqtarë, deputetë nga të gjitha kahet politike dhe ekspertë të legjislacionit, për të përgatitur rekomandime ligjore për përparim-legjislacion të përmirësuar mbi DHBGJ-në (100 pjesëmarrës).
- **Publikoi rekomandimet ligjore** të konferencës kombëtare mbi “Ligjet për DHBGJ-në, Aktualiteti dhe Perspektiva” lidhur me rekomandime ligjore për përmirësimin e situatës aktuale (25 rekomandime të hartuara).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Gjatë seancave informuese të organizuara në katër qytete mbi çështjet e DHBGJ-së dhe DHF-së u vu re se gjysma e pjesëmarrësve nuk kishin asnjë informacion mbi urdhrat e mbrojtjes për viktimat e dhunës.
- Avokatët e vlerësuan trajnimin mbi çështjet e DHBGJ-së falë përdorimit të përmbajtjes dhe metodologjisë novatore, bazuar në konventat ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të ndërthurur me informacion praktik se si të kryhen intervistat e klientëve, si të

formulohen kërkesat dhe peticionet, si të kërkohej dëmshpërblim, si të hartohen UM dhe UMM, si të hartohet një strategji për trajtimin e një çështjeje të caktuar, etj.

## Rekomandime

- Ndryshimi i legjislacionit aktual mbi DHBGJ-në në përputhje me nevojat e veçanta të grave viktime të dhunës në Shqipëri, në përmbushje të plotë të standardeve ndërkombëtare (*KEDNJ-ja, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, legjislacioni i KiE-së, Konventa e Stambollit, etj.*).
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të, duhet të trajtojë avokatë në nivel kombëtar dhe vendor mbi çështjet e DHF-së dhe DHBGJ-së, për mbrojtje më të mirë të viktimave në konflikte të tilla. Të njëjtat trajnime të fokusuar në çështjet e DHF-së dhe DHBGJ-së duhet të organizohen edhe për gjyqtarët, prokurorët, magistratët, punonjësit e policisë, punonjësit e qeverisë vendore që merren me këto çështje, veçanërisht në fusha me shpeshtësi të lartë të konflikteve të DHF-së dhe DHBGJ-së (këto trajnime duhet të organizohen nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me OSHC-të).
- OSHC-të që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, DHF-së, DHBGJ-së, mbrojtjes së grave dhe/ose grupeve të cënueshme, duhet të vijojnë të organizojnë seanca informuese, takime me qytetarët dhe specialistët e institucioneve shtetërore, ditë të hapura, dhe aktivitete të tjera ndërgjegjësuese, si shpërndarja e fletëpalosjeve, spote televizive, dokumentarë televizivë, etj., për të rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit mbi çështjet e DHF-së dhe DHBGJ-së.

## 19. Organizata: Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale/CDRW

<b>Titulli i projektit</b>	Rritja e ndërgjegjësimin të komuniteteve rurale në bashkinë e Krujës, veçanërisht të grave, vajzave dhe studentëve, mbi nevojën e domosdoshme për të ndaluar dhunën në familje
<b>Qëllimi i projektit</b>	Rritja e ndërgjegjësimin mbi çështjet e dhunës në familje, në rrethin e Krujës ( <i>dhe njësitë e saj administrative</i> ).
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill – mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Krujë ( <i>Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël</i> )

### Aktivitetet kryesore

- **Botoi** fletëpalosjen “Unë dhe ligjet që rregullojnë marrëdhëniet në familje”, që përmban informacion mbi Kodin e Familjes, legjislacionin për dhunën në familje, mekanizmin e referimit në menaxhimin e rasteve të DHF-së në nivel bashkie, dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës (*1,100 kopje të shpërndara për grupet e veçanta të synuara gjatë prezantimeve të projektit, tryezave të rrumbullakëta, trajnimeve dhe takimeve informuese*).
- **Organizoi takime informuese** me gra shtëpiake, vajza të reja, mësues dhe studentë/nxënës të shkollave të mesme (*56 seanca*) për të prezantuar informacionin e përfshirë në broshurë, dhe se si të përdoret ai në rast të konflikteve të DHF-së. Këto seanca pasuruan njohuritë mbi ligjet që rregullojnë marrëdhëniet familjare.
- **Organizoi 5 tryeza të rrumbullakëta** me shtëpiake, gra, vajza dhe studentë mbi legjislacionin lidhur me DHF-në, rolin e autoriteteve shtetërore në nivel vendor, rolin e qendrave shëndetësore

dhe stafit mjekësor, mekanizmave të referimit, programeve të rehabilitimit të dhunuesve, etj., në Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Nikël dhe Bubq (98 pjesëmarrës).

- **Organizoi 5 tryeza të rumbullakëta** me përfaqësues të autoriteteve vendore (nga bashkia, anëtarët e këshillit bashkiak, përfaqësues të njësive administrative, punonjës socialë, mjekë, kryepleq fshatrash, drejtorë dhe mësues shkollash nëntëvjeçare dhe të mesme, dhe punonjës policie) mbi Përgjegjësitë e autoriteteve vendore në marrëdhëniet familjare dhe DHF-në në Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Nikël dhe Bubq (111 pjesëmarrës).
- **Organizoi 2 trajnime** me autoritetet dhe aktorët vendorë të angazhuar kundër DHF-sënë bashkinë e Krujës, për forcimin e kapaciteteve të aktorëve përgjegjës në zbatimin e ligjit dhe në mbështetjen e grave dhe vajzave të dhunuara (përfaqësues të bashkisë së Krujës, Komisarariatit të Policisë Krujë, qendrave shëndetësore, koordinatori vendor kundër dhunës në familje në bashkinë e Krujës, mjekë, infermierë, drejtorë shkollash, dhe mësues - 42 pjesëmarrës).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Gjatë seancave informuese, studentët shfaqën shumë interes për të mësuar më shumë mbi dhunën në familje dhe format e saj të shprehjes, ndërsa vajzat shfaqën shqetësimin real lidhur me vlefshmërinë e martesave në moshë të hershme në pikëpamjen ligjore, pasi ky fenomen është ende i pranishëm në këto zona për shkak të mentalitetit të prapambetur.
- Gjatë takimeve me një pjesë të stafit mjekësor në Krujë dhe Fushë-Krujë u vu re se ata nuk ishin të trajnuar ose informuar si duhet, lidhur me mënyrën e trajtimit të të lënduarve si pasojë e DHF-së, njoftimin ose referimin e këtyre rasteve pranë institucioneve kompetente, si në polici dhe prokurori.
- Në takimet me kryepleqtë e fshatrave u vu re se informacioni i tyre mbi çështjet e DHF-së ishte bazik; ata as nuk ishin angazhuar dhe as nuk ishin koordinuar me institucione të tjera ose OSHC për t'i informuar qytetarët dhe për të parandaluar rastet e DHF-së.
- Pjesëmarrësit në aktivitetet e projektit kishin shumë pak informacion mbi përmbajtjen e ligjeve që rregullojnë marrëdhëniet familjare, si dhe mbi detyrat e tyre përkatëse në këtë aspekt, por ishin shumë të interesuar dhe shumë proaktivë për të mësuar më shumë mbi rolin që ata mund të luajnë, për të ngritur kapacitetet e tyre profesionale në menaxhimin e çështjeve të DHF-së.

### Rekomandime

- OSHC-të duhet të vijojnë të bashkëpunojnë me komunitetet dhe institucionet vendore për të ndërgjegjësuar dhe informuar qytetarët mbi çështje të DHF-së, procedurat ligjore që duhen ndjekur në rast të konflikteve të DHF-së, institucionet që mund t'i zgjidhin me efikasitet këto konflikte, kompensimin e mundshëm të viktimave, programet e rehabilitimit, etj.
- OSHC-të, në bashkëpunim me institucionin përkatës, duhet të vijojnë të trajnojnë dhe ngrajnë kapacitetet e autoriteteve dhe aktorëve vendorë të angazhuar kundër DHF-së në të gjitha bashkitë, për zbatimin më efikas të ligjit për DHF-në, në mbështetje të grave dhe vajzave të dhunuara.

## IV.II. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËN-GRANTE MBI MONITORIMIN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

### 1. Organizata: Instituti për Studime Publike dhe Ligjore/ISPL

<b>Titulli i projektit</b>	Monitorimi i Integritetit Gjyqësor / MIGJ
<b>Qëllimi i projektit</b>	Promovimi i integritetit gjyqësor dhe ulja e mundësive për korrupsion në sistemin gjyqësor shqiptar, nëpërmjet ngritjes së një mekanizmi të përhershëm, konkretisht “Lista e kontrollit të masave mbrojtëse kundër korrupsionit në gjyqësor”, për monitorimin e vazhdueshëm të integritetit të gjyqësorit, duke iu ofruar në këtë mënyrë politikëbërësve, menaxherëve të gjykatave dhe publikut sinjalizime të hershme dhe të dhëna mbi mungesën e respektimit të standardeve të integritetit.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017 – maj 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tiranë, Korçë

#### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi** “Listën e kontrollit të masave mbrojtëse kundër korrupsionit në gjyqësor”, duke kryer studim mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira lidhur me masat rregulatore dhe të tjera mbrojtëse kundër korrupsionit (*objektivat e performancës*) në sektorin e drejtësisë, treguesit më të mirë cilësorë dhe sasiorë që përcaktojnë përmbushjen (*ose mospërmbushjen*) e masave mbrojtëse, dhe organizoi 2 aktivitete konsultimi me përfaqësues të përfituesve të drejtpërdrejtë (*Kuvendi, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (drejt shpërbërjes), Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe menaxherët e gjykatave, një në Tiranë me 20 pjesëmarrës dhe një në Gjykatën e Rrethit Korçë me 10 pjesëmarrës*), si dhe takime individuale me studiuesit dhe profesionistët ligjorë.
- **Zhilloi një metodologji kombëtare** për Monitorimin e Integritetit Gjyqësor në Shqipëri (e miratuar gjerësisht nga grupet e synuara dhe palët e tjera të interesit), e ndërthurur me kapacitetet e ngritura dhe të qëndrueshme të palëve të jashtme të interesit dhe vetë gjyqësorit, për monitorimin e rreptë të integritetit gjyqësor në Shqipëri.
- **Krijoi një faqe interneti** të quajtur Monitorimi i Integritetit Gjyqësor (*duke përfshirë mjete monitorimi, si pyetësorë, formate intervistash, etj.*) për komunikimin mbi monitorimin e integritetit gjyqësor në vitet e ardhshme.

#### Përmbledhje e gjetjeve

- “Lista e kontrollit të masave mbrojtëse kundër korrupsionit në gjyqësor” përmban shtatë tregues kryesorë, të cilët detajohen në disa nëntregues, siç paraqitet më poshtë, dhe secili prej tyre shtjellohet më tej lidhur me (i) Standardet e performancës, (ii) Treguesit e përmbushjes dhe (iii) Teknikën e matjes. Ajo përmban kapituj të ndryshëm mbi pavarësinë dhe paanshmërinë, llogaridhënien, transparencën dhe pjesëmarrjen efikase, efikasitetin, kompetencat dhe dedikimin, menaxhimin e brendshëm të gjykatës dhe të personelit jogjyqësor e burimeve (financiare dhe teknike) të gjyqësorit, dhe menaxhimin e tyre. Lista e kontrollit:
  - i përmbledh standardet mbi pavarësinë, llogaridhënien dhe korrupsionin në gjyqësor në kritere

- për të siguruar ekzistencën e një gjyqësori sistematikisht të pastër dhe pa korrupsion, dhe bazohet në studimin e faktorëve më të zakonshëm që mendohet se kontribuojnë ose shkaktojnë korrupsionin në gjyqësor, që është evidentuar se përfshin emërimet në gjyqësor të pabazuara në meritë, termat dhe kushtet e dobëta si mungesa e sigurisë dhe ngritja arbitrare në detyrë, llogaridhënia dhe disiplina e pamjaftueshme, dhe mungesa e transparencës publike.
- monitoron një larmi treguesish që lidhen me ekzistencën e masave mbrojtëse të përcaktuara për pavarësinë e gjyqtarëve, kushtet e mira të punës për gjyqtarët, proceset e drejta dhe të pavarura të emërimeve, llogaridhënien dhe transparencën e gjyqësorit.
  - mat performancën e gjyqësorit lidhur me integritetin institucional, pavarësinë, transparencën dhe llogaridhënien, duke identifikuar një larmi kriteresh që kanë lidhje me përzgjedhjen e gjyqtarëve, menaxhimin e karrierës në gjyqësor, administrimin e brendshëm, burimet, proceset gjyqësore dhe profesionin ligjor.
  - mundëson matjen e treguesve të performancës së gjykatës, duke përfshirë: buxhetin, ndihmën ligjore, gjykatat, stafin gjyqësor, profesionin, përdoruesit, teknologjinë e informacionit, trajtimin e çështjeve penale dhe civile, kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimin e vendimeve
  - përfshin masa që synojnë rritjen e qasjes në gjykata, ofrimin në mënyrë më efikase të drejtësisë, rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, rritjen e pavarësisë, drejtësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, dhe frenimin e korrupsionit në sektorin e drejtësisë.

## Rekomandime

- Treguesit e listës së kontrollit për matjen e performancës dhe frenimin e korrupsionit në gjyqësorin shqiptar përfaqësojnë bazën për MIGJ-in. Megjithatë, KLGJ-ja, vetë gjykatat dhe OSHC-të mund t'i shtjellojnë, shtojnë, rishikojnë/riorganizojnë më tej këta tregues, bazuar në dinamikën dhe specifikën e Shqipërisë, me rrethe të përshtatura sipas nevojave të tyre.
- KLGJ-ja, gjykatat ose OSHC-të duhet të zhvillojnë metodologji (*anketime, sondazhe, analizë përmbajtësore, statistika dhe analizë statistikore*) për monitorimin dhe matjen e integritetit gjyqësor, ndaj lista e kontrollit do të konsiderohet një dokument dinamik dhe jo teorik dhe abstrakt.
- Donatorët ndërkombëtarë duhet të vijojnë të mbështesin nivelin e politikave vendore ose OSHC-të e forumeve në Shqipëri për përafrimin më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi matjen e integritetit dhe performancës së gjyqësorit.



## 2. Organizata: Qendra Evropiane/EC

<b>Titulli i projektit</b>	Standarde të procesit të rregullt si një parakusht i funksionimit të shtetit ligjor
<b>Qëllimi i projektit</b>	Vlerësimi i funksionimit të elementeve kyçe të sistemit gjyqësor administrativ në përputhje me standardet e procesit të rregullt, përmirësimi i kapaciteteve për transferimin dhe replikimin e praktikave më të mira, dhe kontribuimi në formimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve, administratorëve të gjykatave, këshilltarëve ligjorë dhe studentëve të drejtësisë lidhur me standardet evropiane të një procesi të rregullt, me fokus të veçantë në zbatimin e praktikës gjyqësore “detyruese” të GJEDNJ-së.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017 - korrik 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tirana, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë

### Aktivitetet kryesore

- **Kreu monitorimin e gjykimit** mbi aktivitetin dhe performancën e të gjitha gjykatave administrative të shkallës së parë (6 GJASHP - Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë) dhe gjykatës së apelit (1 Gjykatë Administrative e Apelit në Tiranë) në Shqipëri, në periudhën janar-qershor 2018; monitoroi 550 seanca gjyqësore (për 192 çështje) - (u hartuan dhe shpërndanë 100 kopje të raportit)
- **Hartoi manualin** për “Standardet e GJEDNJ-së mbi procesin e rregullt” (sektori civil), i cili përmban një përmbledhje të 40 gjykimeve më të rëndësishme nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut, i cili në të ardhmen mund të përdoret nga profesionistët e drejtësisë që merren me sistemin gjyqësor shqiptar (322 kopje të shpërndara për gjyqtarët, prokurorët, avokatët).
- **Organizoi trajnime** për:
  - gjyqtarët, këshilltarët ligjorë, dhe nëpunësit e gjykatës (dy trajnime në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, 54 pjesëmarrës) mbi standardet e procesit të rregullt, duke theksuar në veçanti kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatës, prezumimin e pafajësisë, dhe barazinë e armëve.
  - studentët e drejtësisë (10 trajnime) për të thelluar njohuritë e tyre mbi standardet e procesit të rregullt dhe standardet evropiane të të drejtave të njeriut (101 studentë pjesëmarrës nga 10 Fakultete të Drejtësisë).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Për sa i përket numrit të seancave gjyqësore për çështje, monitorimi zbuloi se 33% e çështjeve të monitoruara për të gjitha gjykatat u mbyllën brenda 1 seancë, 40% brenda 2 seancash, 18% brenda 3 seancash, dhe vetëm 9% u mbyllën brenda 4 seancash, duke treguar një performancë të mirë lidhur me seancat për gjykim, pasi asnjë nga çështjet e monitoruara nuk i ka tejkaluar 4 seanca. Gjykata Administrative e Tiranës dhe e Gjirokastrës kishin performancën më të mirë, duke qenë se i mbyllën të gjitha çështjet brenda 3 seancash maksimumi. Performanca më e mirë në këtë aspekt ishte e Gjykatës Administrative të Gjirokastrës, e cila mbylli 59% të çështjeve brenda 1 seance, e Shkodrës me 56%, dhe deridiku e Tiranës me 37.5%. Pjesa tjetër e gjykatave ia doli t’i mbyllte çështjet e mbetura kryesisht brenda 2 seancash (Durrës 58%, Korçë 53% dhe Tiranë 50%). Gjykata e Vlorës kishte performancën më të dobët krahasuar me gjykatat e tjera, duke

qenë se 40% e çështjeve u mbyllën brenda 2 seancash dhe 50% brenda 3 seancash.

- Lidhur me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, gjykatat kishin performancë më të mirë, duke qenë se 62% e çështjeve të monitoruara u mbyllën brenda 1 muaji, 23% brenda 2 muajsh, dhe pjesa tjetër brenda 3-6 muajsh. Performancën më të mirë në këtë aspekt e kishte gjykata e Shkodrës, e cila mbylli 75% të çështjeve të monitoruara brenda 1 muaji, e ndjekur nga e Gjirokastrës me 71%, Durrësit me 66%, Tiranës me 60%, Korçës me 43% dhe Vlorës me 41%.
- Për sa i përket arsyeve për shtyrje të seancave gjyqësore, arsyeja më e zakonshme ishte kërkesa e të pandehurit në 57% të çështjeve të monitoruara në të gjitha gjykatat, emërimet e ekspertëve në 24% dhe kërkesa e paditësit në 16% të çështjeve.
- Gjykatat nxorën vendimin dhe e komunikuan atë brenda së njëjtës ditë të seancës së fundit gjyqësore.
- Shumica e gjykatave të monitoruara nuk janë të qasshme nga personat me aftësi të kufizuara, për shkak të mungesës së rampave dhe ashensorëve. Gjykatat nuk kishin mjaftueshëm salla gjyqi për mbajtjen e seancave gjyqësore.
- Kalendarin e seancave gjyqësore (që përmban informacion mbi palët, objektin e padisë, bazën ligjore, kalendarin e seancave gjyqësore, vendimin e gjykatës, datën dhe numrin e vendimit, etj.) nuk pasqyrohej/publikohej gjithmonë online në kohë reale dhe në këndin e informacionit të gjykatës. Gjykatat kishin mungesë të formularëve/modeleve të unifikuara të kalendarit të seancave gjyqësore.
- Mungesë gjyqarësh për të plotësuar strukturën gjyqësore të Gjykatave Administrative dhe mungesë e stafit administrativ; kjo situatë pritet të ndryshojë me ngritjen e KLGJ-së. (p.sh. Numri i gjyqarëve në Gjykatën Administrative të Apelit nuk përputhej (ishte shumë i ulët) me volumin e madh të vendimeve të apeluara).

## Rekomandime

- OSHC-të duhet të vijojnë të organizojnë trajnime me studentët e shkollës së drejtësisë mbi çështje të drejtave të njeriut.
- KLGJ-ja ose vetë gjykatat duhet të marrin masa për standardizimin e kalendarit të seancave gjyqësore për gjyqarët dhe ta publikojnë atë edhe në faqen e internetit të gjykatës, për të shmangur paqartësitë dhe për t'i bërë gjykatat më të qasshme. Gjithashtu, është e rëndësishme që kalendarin të publikohet në kohë.
- KLGJ-ja duhet të shtojë numrin e gjyqarëve në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë në 13 ose më shumë, nga 7 që janë aktualisht në detyrë, për të përballuar më mirë numrin e çështjeve të reja dhe ato të mbartura nga vitet e mëparshme.
- KLGJ-ja, në bashkëpunim me donatorë ndërkombëtarë dhe OSHC-të shqiptare më të specializuara mbi reformën në gjyqësor dhe politikën ligjore, duhet të kryejë një studim ose analizë shteruese mbi situatën e gjykatave administrative dhe drejtësisë administrative në Shqipëri, si dhe mundësisht të marrë në konsideratë mundësinë për shtimin e numrit të gjykatave të apelit, për të përmbushur më mirë kërkesat ligjore për kalendarin e gjykimit të çështjeve administrative në gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit.

### 3. Organizata: Instituti për Politika të Qëndrueshme/ISP

<b>Titulli i projektit</b>	Monitorimi i funksionimit të gjykatës së shkallës së parë në rrethin e Lushnjës
<b>Qëllimi i projektit</b>	Vlerësimi dhe paraqitja e provave cilësore dhe sasiore mbi cilësinë e gjykatës së shkallës së parë Lushnjë për çështjet civile.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Lushnjë

#### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi një raport monitorimi** mbi aktivitetin dhe performancën e Gjykatës së Rrethit Lushnjë, bazuar në të dhënat e mbledhura nga monitorimi i seancave gjyqësore të 30 çështjeve civile, 120 pyetësorë, 10 intervista me stafin administrativ, gjyqtarët, avokatët dhe shqyrtimi i dokumentacionit mbi kuadrin ligjor, Programin e Transparencës, TI-në dhe funksionet koordinuese, statistikat e çështjeve gjyqësore, infrastrukturën e gjykatës, etj.

#### Përmbledhje e gjetjeve

- Nga monitorimi i 30 çështjeve civile u vu re se numri i seancave të mbajtura për çështjet e monitoruara varionte nga 3 në 7 (*mesatarisht 4.5 seanca për gjyq, nga të cilat 55% prej tyre ishin seanca produktive*), seancat paraprake rezultuan joefikase në disa raste (20% e çështjeve të monitoruara u shtynë për shkak se palët nuk paraqitën prova në fillim të gjyqit ), afati kohor nga një seancë në tjetrën varionte nga 15 në 30 ditë, arsyeja kryesore për shtyrjen e seancave gjyqësore ishte mosparaqitja e palëve për shkak të vonesave ose mungesës së njoftimeve/thirrjeve në seancë gjyqësore, duke qenë se gjykata nuk përdorte metoda të shpejta për njoftimin e palëve, si email ose telefonata, si dhe për shkak të mungesës së kriterëve ligjore të disiplinës për t'i penalizuar ata për mosparaqitje në gjyq.
- GJRR Lushnjë ka mungesë gjyqtarësh dhe stafi administrativ (*nga 5 gjyqtarë, 4 prej tyre ishin në detyrë ndërsa 1 gjyqtar mungonte, dhe me raste kjo gjykatë ka funksionuar me 2 ose 3 gjyqtarë*), duke sjellë ngarkesë të tepërt pune për gjyqtarët që gjykojnë 750-800 çështje/vit, kohëzgjatje të tepërt të proceseve gjyqësore në shkelle të standardit për kohën e arsyeshme, dhe vonesa në arsyetimin e vendimeve të gjykatës, duke cenuar edhe cilësinë e vendimeve të gjykatës. Ajo ka edhe mungesë të gjyqtarëve ose seksioneve të specializuara (*çështje civile, penale, familjare, tregtare, të drejtësisë për të mitur*). Megjithatë, pavarësisht problemeve të vëna re dhe ngarkesës së përditshme të tepërt të punës, stafi i gjykatës ishte plotësisht i dedikuar, sillej me profesionalizëm, dhe ia dilte të mbante një fluks pune normal në gjykatë. Një aspekt pozitiv i monitoruar ishte zyra e posaçme për marrjen në pyetje ose intervistimin e të miturve të përfshirë në gjyqe.
- Në përgjithësi, përdoruesit e gjykatave ishin të kënaqur me qasjen në gjykatë (61%), shenjat orientuese në gjykatë (53%), kushtet e pritjes (61%), qartësinë e thirrjeve në gjyq (68%), sjelljen e stafit të gjykatës dhe nivelin e kompetencave (70%), sjelljen e gjyqtarëve dhe prokurorëve (61%), informacionin e dhënë nga sporteli i informacionit (90%), qartësinë e vendimeve të gjykatës (63%), korrektësinë e seancave gjyqësore lidhur me fillimin në kohë (61%), kohën që iu kushtua paraqitjes së argumenteve të tyre në gjyqin ku ata ishin të pranishëm (70%), si dhe me afatin kohor për nxjerrjen e vendimeve të gjykatës (44%), që nënkupton se ky proces duhet të përmirësohet. Ata e vlerësonin të kushtueshme qasjen në gjyqësor (76%) (pa marrë në konsideratë tarifën për avokat).

- Gjatë intervistave me stafin administrativ të gjykatës u vu re ngarkesë pune dhe orë pune të tepërta (deri në 10 orë/ditë), mungesë e përshkrimit të qartë të punës për TI-në në gjykatë, mungesë e sekretareve të dedikuara të gjyqit për çdo gjyqtar, paga të ulëta (*jo në përputhje me ngarkesën e tyre të punës dhe me detyrat që ata ushtrojnë*), si dhe mungesë e trajnimeve profesionale.
- Intervistat me avokatët konfirmuan të njëjtat gjetje si edhe intervistat me stafin e gjykatës dhe gjetjet nga monitorimi i seancave gjyqësore.

## Rekomandime

- Shtimi i numrit të gjyqtarëve në GjRR Lushnjë duke plotësuar vendet vakante (*sipas strukturës së paramiruar të gjykatës*) për trajtim në mënyrë më efektive të ngarkesës së punës së gjykatës.
- Specializimi i gjyqtarëve në çështje civile, penale dhe të të miturve.
- Gjykata duhet të përdorë të gjitha mjetet e komunikimit për të thirrur/njoftuar palët (*telefonatat ose mjetet elektronike të komunikimit për të qenë më të shpejtë dhe më të sigurtë*), si dhe për të marrë informacionin më aktual mbi adresën e palëve kur ato depozitojnë paditë.
- KLGJ-ja ose vetë gjykata mund të krijojë një sistem online për njoftimin/thirrjen e palëve në gjyq.
- Gjykata duhet të ketë qasje në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave.
- Gjykata/Gjyqtarët duhet të verifikojnë disponueshmërinë e palëve para se të vendosin për seancën e ardhshme dhe të përdorin njoftime të shpejta për ta për anulimin e seancës nëpërmjet telefonit/emailit.
- Vendimet e gjykatës duhet të publikohen vetëm pas formulimit/arsyetimit dhe vetëm më pas duhet t'iu dërgohen/dorëzohen palëve. KLGJ-ja ose vetë gjykata duhet të krijojë një sistem për regjistrimin/ndjekjen e kësaj procedure, dhe rrjedhimisht afati i ankimit/apelimit duhet të fillojë në momentin që palëve iu dërgohet vendimi i arsyetuar.
- Përmirësimi i infrastrukturës lidhur me çështjet e sigurisë, sallat e gjyqit, hapësirën e pritjes së publikut, qasjen në gjykatë të njerëzve me aftësi të kufizuara, etj., duke instaluar pajisje elektronike që shfaqin kalendarin e detajuar të gjyqit, ndryshime ose anulim të seancave gjyqësore.
- Gjykata duhet të përdorë mënyra më pak të ndërlikuara ose më të thjeshta të qasjes në dosjet e gjykatës.

#### 4. Organizata: Qendra për Zhvillim dhe Integrim Demokratik/QZHID

<b>Titulli i projektit</b>	Promovimi i një Sistemi Gjyqësor Transparent dhe Llogaridhënës për të ofruar Drejtësi për të gjithë
<b>Qëllimi i projektit</b>	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Sistemit Gjyqësor përmes mbështetjes së aktorëve të shoqërisë civile.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 – prill 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tropojë

##### Aktivitetet kryesore

- **Zhvilloi takime** me palët vendore të interesit (*një me autoritetet vendore dhe të tjerat me 50 përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë*) mbi efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien.
- **Hartoi një raport monitorimi** mbi aktivitetin, performancën dhe transparencën e gjykatës, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes:
  - Faqes së monitoruar të internetit të Gjykatës së Rrethit Tropojë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe të dhënave nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për periudhën 2014-2016.
  - Monitorimit të 42 seancave gjyqësore për vitin 2018 (*30 në GjRR Tropojë dhe 12 në Gjykatën e Apelit Shkodër*)
  - 63 intervistave të kryera me palët në gjyqe civile (*paditësit dhe të pandehurit*), stafin e gjykatës, avokatët dhe ekspertët, të fokusuar në transparencën dhe qasjen në gjykatë.
- **Hartoi një doracak për OSHC-të** mbi teknikat, parimet dhe standardet për monitorimin e gjyqësorit (*75 kopje të shpërndara*).
- **Organizoi 1 trajnim** mbi monitorimin e gjyqësorit për përfaqësuesit e OSHC-ve nga bashkia e Tropojës, organizatat me bazë komunitare dhe median vendore (*20 pjesëmarrës*).
- **Nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me OSHC-të** për monitorimin e gjyqësorit në të ardhmen.

##### Përmbledhje e gjetjeve

- Ky monitorim nxori në pah se numri i çështjeve të mbyllura për çdo vit ishte pak më i ulët se numri i çështjeve të depozituara, që tregon për performancë të mirë të gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjeve. Për vitin 2014 kishte 551 çështje të depozituara dhe 456 të mbyllura, për vitin 2015 kishte 802 çështje të depozituara dhe 736 të mbyllura, dhe për vitin 2016 kishte 723 çështje të depozituara dhe 635 të mbyllura. Gjithashtu, gjatë monitorimit u vu re se 81% e çështjeve u mbyllën brenda 2 muajsh, 17.5% e çështjeve brenda 2-4 muajsh. Mesatarisht, 98.5% çështjeve të monitoruara në GjRR Tropojë u mbyllën brenda 6 muajsh.
- Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore në GjRR Tropojë u vu re se 76% e gjyqeve mbareshin në sallat e gjyqit dhe 24% në zyrat e gjyqtarëve, duke cenuar në këtë mënyrë qasjen e njerëzve në seanca gjyqësore. Si rrjedhojë, gjyqtarët sillleshin ndryshe gjatë gjyqeve bazuar në fazën që ata mbanin seancat gjyqësore, duke cenuar solemnitetin e gjykatës. Në 81% të gjyqeve të monitoruara përdorej regjistrimi audio dhe në 19% të tyre ky regjistrim nuk përdorej për shkak të mungesës së energjisë elektrike dhe problemeve të tjera teknike.

- Shërbimet e gjykatës ishin të ngadalta në ofrimin e informacionit të kërkuar nga palët e interesuara dhe kishte vonesa në ofrimin e tij.
- GjRR Tropolje nuk e kishte (çdo ditë) funksionale faqen e internetit ku mund të publikohej i gjithë informacioni i nevojshëm për çështjet e mbyllura, gjyqet në vazhdim (*datat, palët, salla e gjyqit*), vendimet e gjykatës, shërbimet e gjykatës, etj., dhe ku palët mund të merrnin informacion drejtpërdrejt, pa paraqitur një kërkesë zyrtare.
- U vunë re probleme lidhur me infrastrukturën e gjykatës, si mungesa e ambienteve/sallave të disponueshme të gjykatës (*për shkak të numrit të lartë të çështjeve*), qasja e dobët në vendimet e gjykatës (*ishte e vështirë për të marrë informacion në kohë*), probleme me regjistrimin audio, etj.
- Mungesa e informacionit për qytetarët lidhur me institucionet ku ata mund të adresojnë shqetësimet e tyre, përveç gjykatave, si Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave.

### Rekomandime

- Për të garantuar plotësisht solemnitetin e gjykimit, GjRR Tropolje duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të zhvilluar seanca gjyqësore në sallën e gjyqit dhe jo në zyrat e gjyqtarëve.
- Gjykatat dhe KLGJ-ja duhet të marrin masa për të parandaluar problemet teknike që shkaktojnë ndërprerjen e regjistrimit audio të gjyqit, si dhe për të ngritur infrastrukturën për funksionimin e faqeve të internetit për të gjitha gjykatat në Shqipëri, duke përfshirë GjRR Tropolje.
- Për të garantuar plotësisht qasjen e publikut në gjykata, këto të fundit dhe KLGJ-ja duhet të marrin masa për të përmirësuar infrastrukturën e gjykatës.
- SHM-ja duhet të organizojë trajnim të vazhdueshëm për gjyqtarët, prokurorët, këshilltarët ligjorë dhe punonjësit e tjerë të gjykatës lidhur me të drejtat procedurale të palëve gjatë gjyqeve.
- DHKA-ja duhet të organizojë trajnime për avokatët lidhur me të drejtat procedurale të palëve gjatë gjyqeve.
- OSHC-të duhet të ndërmarrin iniciativa për ndërgjegjësimin dhe forcimin e kapaciteteve të punonjësve të tyre dhe aktivistëve të shoqërisë civile që operojnë në rrethin e Tropoljes, lidhur me rëndësinë e rolit të tyre në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të individëve, si dhe të organizojnë trajnime për forcimin e kapaciteteve mbi monitorimin e gjyqësorit dhe gjyqeve.
- OSHC-të duhet të organizojnë aktivitete për ndërgjegjësimin mbi të drejtat e tyre procedurale, solemnitetin e zhvillimit të gjyqit, të drejtën e pjesëmarrjes në gjyq dhe të qenit të barabartë me palët e tjera, etj., me qëllim rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor.

## 5. Organizata: Qendra për Zhvillimin Komunitar “Sot për të Ardhmen”

<b>Titulli i projektit</b>	JUSTICE not Just-Ice! - Rruga drejt një sistemi gjyqësor efikas dhe të drejtë
<b>Qëllimi i projektit</b>	Monitorimi dhe vlerësimi i procedurave, cilësisë së shërbimeve dhe efikasitetit të Gjykatës së Rrethit Pukë, për të përmirësuar informacionin për gratë dhe të miturit e disavantazuar mbi procedurat e gjykatës dhe shtetin ligjor, dhe për të rritur besimin në gjyqësor.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - prill 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Pukë

### Aktivitetet kryesore

- **Zhvilloi seanca informuese** me grupe të disavantazuara të grave dhe të miturve mbi qasjen në shërbimet e gjykatës (10 aktivitete, 396 persona të arritur).
- **Hartoi një raport monitorimi** mbi aktivitetin dhe performancën e Gjykatës së Rrethit Pukë [GJRR Pukë] për periudhën 2016-2017, nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga pyetësorë/ intervista (83 persona të intervistuar), shqyrtimi i faqes së internetit të gjykatës, Raporti Vjetor statistikor i gjykatave i hartuar nga MD-ja, dhe të dhënave nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.
- **Organizoi vizitë studimore** në mjediset e Gjykatës, Prokurorisë, Shërbimit të Provës dhe Komisarariatit të Policisë Pukë, për t'i informuar qytetarët mbi rolin dhe kompetencat e këtyre institucioneve (40 pjesëmarrës).
- **Organizoi një tryezë të rrumbullakët** për të prezantuar gjetjet nga monitorimi i gjykatës (40 pjesëmarrës).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Faqja zyrtare e internetit e Gjykatës së Pukës ishte funksionale, por informacioni i ofruar nuk ishte i plotë dhe jo i organizuar në mënyrë të qartë ose në përputhje me kërkesat ligjore.
- Në faqen e internetit të gjykatës nuk kishte informacion të publikuar lidhur me:
  - strukturën dhe performancën e gjykatës;
  - shërbimet e gjykatës ose standardet e kujdesit për klientin;
  - mekanizmat e monitorimit ose auditimit të gjykatës dhe buxhetin;
  - ankesat për aktivitetin e gjykatës;
  - llojet e informacionit që gjykata ka detyrimin ligjor t' i ofrojë publikut edhe në mungesë të një kërkesë zyrtare;
  - të drejtat e qytetarëve në sistemin gjyqësor;
  - llojet më të shpeshta të informacionit që kërkohet nga publiku/qytetarët;
  - listën e avokatëve ose informacionin për ndihmën ligjore.
- Gjatë intervistave me stafin e gjykatës u vu re se ata përballeshin me vështirësi për të ruajtur dhe përditësuar informacionin në faqen e internetit të gjykatës, për shkak të përfundimit të kontratës me shoqërinë, duke iu vështirësuar qytetarëve qasjen në të. Në Shqipëri ka vetëm një faqe interneti për të gjitha gjykatat e rretheve, e administruar në nivel kombëtar dhe që sjell vështirësi

për përditësimin e informacionit në nivel vendor. Stafit i gjykatës përballej me vështirësi për t'i informuar të gjithë qytetarët që kërkojnë informacion nga gjykata, për të ngarkuar informacion dhe të dhëna në sistemin ICMIS (*sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore*), si dhe për të hartuar raporte/statistika prej tij. Gjithashtu, nuk ishin organizuar trajnime për stafin e gjykatës për të mbështetur punën e tyre të përditshme ose për të përmirësuar performancën, veçanërisht trajnime lidhur me çështjet e shërbimit të klientit.

- Stafit administrativ i gjykatës ishte shumë i gatshëm për të përmirësuar situatën aktuale lidhur me qasjen në gjykatë, p.sh. duke përgatitur formularë për t'u plotësuar nga qytetarët që kërkojnë informacion nga gjykata, dhe për t'i vënë ato në dispozicion në Këndin e Informacionit të gjykatës.
- Intervistat nxorën në pah se 33% besonin se nuk kishte trajtim të barabartë në shërbimet e gjykatës, 28% besonin se komunikimi me stafin e gjykatës nuk ishte efikas, 14% besonin se procedurat e gjykatës/qasjes nuk ishin shumë të qarta, 14% besonin se kishte diskriminim në shërbimet e gjykatës dhe 11% besonin se komunikimi me stafin e gjykatës ishte i papërshtatshëm (joetik). Përveç kësaj, korrupsioni ishte fjala më e përdorur nga të intervistuarit. Megjithatë, kur u pyetën posaçërisht për GjRR Pukë rezultoi se në shumicën e rasteve ky ishte një perceptim dhe paragjykim i zakonshëm bazuar në situatën e përgjithshme të gjyqësorit në ditët e sotme dhe në procesin e vetingut, dhe rrjedhimisht nuk lidhej drejtpërdrejt me GjRR Pukë.
- Seancat informuese treguan se qytetarët nuk kanë informacion të detajuar për procedurat e gjykatës, koordinatori për të drejtën e informimit pranë gjykatës nuk luante rolin e tij rëndësishëm për t'i informuar qytetarët se si të marrin informacion, ndërsa qytetarët kishin mungesë informacion lidhur me qasjen në gjykatë.
- Seancat informuese, monitorimi i gjykatës dhe takimet me stafin e gjykatës nxorën në pah mungesën e informacionit nga ana e qytetarëve për çështje lidhur me të miturit në konflikt me ligjin, dhe stafit i gjykatës nuk ishte trajnuar për këto çështje; ata kishin edhe mungesë të informacionit të detajuar se si të adresojnë dhe trajtojnë çështjet e DM-së.

## Rekomandime

- Rritja e kapaciteteve teknike (*burimeve njerëzore*) të gjykatës lidhur me shërbimet e gjykatës, veçanërisht informacionin për shërbimet e gjykatës dhe cilësinë e tyre.
- Përditësimi i rregullt, mundësisht çdo ditë, i informacionit përmbajtësor të ofruar në faqen e internetit të gjykatës për të rritur transparencën dhe lehtësuar qasjen e qytetarëve në informacion, duke përfshirë udhëzime për ta bërë atë më miqësore me përdoruesin. Kjo duhet të vlejë po njësoj edhe për informacionin lidhur me shërbimet e ofruara në gjykatë.
- Rritja e kapaciteteve të stafit duke ofruar më shumë trajnim mbi sistemin e menaxhimit të çështjeve nga këndvështrimi i përdoruesve të gjykatës dhe publikut, duke përmirësuar vetëbesimin, dhe reflektuar transparencë dhe llogaridhënie të sistemit të drejtësisë në përgjithësi.
- Rritja e efikasitetit dhe profesionalizmit të stafit të gjykatës lidhur me çështjet e drejtësisë për të miturit, përmes punësimit me kohë të plotë të një psikologu, që mund t'i adresojë ato në mënyrë më kompetente.
- Koordinatorit për të drejtën e informimit duhet të ketë një rol më proaktiv ndaj publikut, për ta informuar atë sa herë që ka një kërkesë për informacion.



## 6. Organizata: Qendra EDFAT:

<b>Titulli i projektit</b>	DREJTËSI CILËSORE - DREJTËSI NË KOHË
<b>Qëllimi i projektit</b>	Vlerësimi i kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore dhe cilësisë së vendimeve të gjykatës në gjykatat e Tropojës, Kukësit dhe Lezhës, si dhe ndërgjegjësimi dhe reflektimi i palëve të interesit, veçanërisht profesionistëve të drejtësisë, mbi çështjet ligjore për të përmirësuar efikasitetin e proceseve gjyqësore.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill - dhjetor 2018
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tropojë, Kukës, Lezhë

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi një raport monitorimi** mbi performancën e gjykatës dhe cilësinë e vendimeve të gjykatës, bazuar në të dhënat e mbledhura nga shqyrtimi i 60 dosjeve të gjykatës (20 për secilën gjykatë) së Tropojës, Kukësit dhe Lezhës (çështje civile dhe penale).
- **Organizoi një tryezë të rrumbullakët** me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit, palëve të tjera të interesit, profesionistëve ligjorë dhe studentëve të drejtësisë në zonën e projektit (Tropojë, Kukës dhe Lezhë) për të diskutuar mbi gjetjet e monitorimit të gjykatave (40 pjesëmarrës).
- **Organizoi seminare të hapura** për të diskutuar mbi gjetjet dhe raportin përfundimtar (u organizuan 2 seminare të hapura në universitete me pjesëmarrjen e 41 studentëve).
- **Publikoi artikuj** në media për të paraqitur problematikat kryesore të identifikuara nga monitorimi i gjykatave (2 artikuj të shtypur dhe të publikuar online).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Nga shqyrtimi i dosjeve të gjykatës u vu re se në GjRR Tropojë çështjet penale ishin mbyllur kryesisht (80%) brenda 2 seancash, ndërsa për çështjet civile vetëm 2 % e çështjeve të monitoruara ishin mbyllur brenda 1-2 seancash, që tregon për një performancë më të mirë të kësaj gjykate lidhur me çështjet penale. Në GjRR Kukës, çështjet penale ishin mbyllur kryesisht (90%) brenda 1 seance, dhe të njëjtat të dhëna vlejné edhe për çështjet civile, që tregon për një performancë shumë të mirë të kësaj gjykate në zgjidhjen e çështjeve. Në GjRR Lezhë, çështjet penale ishin mbyllur kryesisht (75%) brenda 3 seancash, që do të thotë se kjo gjykatë nuk kishte një performancë të mirë krahasuar me dy gjykatat e tjera.
- Për sa i përket kohëzgjatjes së seancave, nga monitorimi u vu re se GjRR Kukës kishte performancën më të mirë për çështjet penale, me një mesatare ditësh për mbylljen e një çështjeje prej 22 ditësh, e ndjekur nga GjRR Tropojë me 24 dhe GjRR Lezhë me 51 ditë për mbylljen e një çështjeje; ndërkohë që edhe për çështjet civile ishte pothuajse e njëjta situatë, me GjRR Kukës që kishte performancën më të mirë duke i mbyllur ato brenda 33 ditësh, GjRR Tropojë brenda 54 ditësh, ndërsa mbyllja e çështjeve civile në GjRR Lezhë merrte më shumë kohë (83 ditë).
- Për sa i përket cilësisë së vendimeve të gjykatës, gjatë analizës u evidentua se arsyetimi i vendimeve ishte i dobët dhe shpesh i paplotë, duke qenë se nuk i adresonin të gjitha çështjet, faktet, referencat ligjore, etj., disa vendime ishin identike me vendimet e mëparshme madje edhe kur rrethanat e çështjes ishin të ndryshme, vendimet që kishin rezultuar në caktimin e dënimit për të akuzuarin nuk ishin shtjelluar në detaje në përputhje me faktet dhe rrethanat, dhe me mënyrën se si ishte

kryer vepra penale, kishin të njëjtën përmbytje, rrethanat lehtësuese ose rënduese mbi të cilat ishte caktuar dënimi nuk ishin shtjelluar ose mbuluar në mënyrë të detajuar, vendimet nuk ishin të organizuara në pjesë/seksione, që do të thotë se faktet për çështjen ishin përzier me procedurën ligjore ose me elemente të tjera të vendimit, vendimet që përcaktonin çështjet e problematikave të drejtësisë për të miturit nuk përmbanin raportin psikologjik për të miturin ose nuk e citonin atë shprehimisht. Krahas këtyre problematikave të identifikuar, vendimet e shqyrtuara nxorën në pah gabime të mëdha gramatikore ose të terminologjisë ligjore.

## Rekomandime

- Gjyqtarët duhet të vijojnë të ngrejnë kapacitetet e tyre profesionale duke marrë pjesë në trajnime të organizuara nga SHM-ja, veçanërisht mbi formulimin e vendimeve të gjykatës, si dhe mbi tema të tjera lidhur me çështje civile, penale, ose me lloje të tjera mosmarrëveshjesh, organizimin e çështjeve, fakteve, analizës dhe përfundimeve në një format të kuptueshëm, lehtësisht të lexueshëm (nga palët, gjykatat e apelit dhe persona të tjerë të interesuar), në gjuhë të qartë dhe pa humbje të përmbytjes ligjore të çështjes, etj.
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë ose dhomat e tjera vendore duhet të organizojnë trajnime për avokatët, për të forcuar aftësitë dhe njohuritë e tyre profesionale mbi çështje specifike lidhur me proceset gjyqësore për mosmarrëveshje civile ose penale, aftësitë e ndërgjyqësimit, hartimin e dokumenteve ligjore, marrjen në pyetje nga pala e akuzës, etj., për të bërë mbrojtje më të mirë të çështjes në gjyq.
- OSHC-të duhet të vijojnë të monitorojnë aktivitetin e gjykatës dhe të rrisin ndërgjegjësimin mbi monitorimin e gjykatës dhe çështje të tjera lidhur me performancën, efikasitetin dhe transparencën e gjykatës, duke i bërë gjykatat më llogaridhënëse dhe më të qasshme për publikun.

## 7. Organizata: Qendra për Edukimin Social dhe Mbrojtjen e Mjedisit/SEEP

<b>Titulli i projektit</b>	Më shumë vëmendje
<b>Qëllimi i projektit</b>	Rritja e vëmendjes së aktorëve të drejtësisë për të drejtat themelore të fëmijëve me prindër të divorcuar.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Vlorë

### Aktivitetet kryesore

- **Zhvilloi monitorimin e gjyqit dhe hartoi raportin e monitorimit** mbi aktivitetin e gjykatës dhe proceset gjyqësore - 110 seanca gjyqësore u monitoruan në GjRR Vlorë, Gjykatën e Apelit Vlorë dhe GjRR Sarandë (u zhvilluan 50 ditë monitorimi, nga të cilat 30 ditë në GjRR Vlorë, 10 ditë në GjRR Sarandë dhe 10 ditë në Gjykatën e Apelit Vlorë), dhe u mbledhën të dhëna nga pyetësorë dhe intervista (2.500 qytetarë, 15 gjyqtarë, 300 avokatë, 12 përmbartues të përfshirë).
- **Shpërndau fletëpalosje informuese** mbi të drejtat e individit për ndihmë ligjore falas dhe procesin e rregullt (të shpërndara në 7 bashkitë e Rrethit të Vlorës, 3300 qytetarë të informuar)
- **Realizoi (një) emision televiziv** për të diskutuar mbi projektin, interesin më të lartë të fëmijës

dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatës nga koordinatori i projektit dhe avokati ekspert, i cili u transmetua në “Eden 3 TV” (Vlorë) dhe ‘Saranda TV’ (Sarandë).

- **Realizoi një spot televiziv:** publicitetet mbi të drejtën e qasjes në sistemin gjyqësor dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatës.

## Përmbledhje e gjetjeve

- 57.16% e të intervistuarve deklaruan se nuk e kishin paguar detyrimin për ushqim, ndërsa 42.84 % e kishin paguar (50.7% e tyre e kishin paguar në mënyrë sporadike dhe 49.2 % e paguanin në vazhdimësi në afatin e përcaktuar). Arsyet kryesore për mospërmbushjen e detyrimit për ushqim lidheshin me pamundësinë ekonomike (paaftësinë paguese) për shkak të papunësisë, konflikteve me ish bashkëshortin, ndërprerjen e marrëdhënies së prindërve të divorcuar me fëmijët e tyre.
- Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore u vu re se gjyqi për divorcin ose detyrimin për ushqim kryhej në kushte infrastrukturore të këqija (salla të vogla gjyqi, pa ajrim dhe me mungesë të solemnitetit të gjykimit).
- Avokatët që përfaqësonin klientët e tyre në gjyqet e divorcit zakonisht fokusoheshin më shumë në procesin e divorcit sesa në të drejtat dhe interesin më të lartë të fëmijëve. Asistenca ligjore që ata ofronin në këto çështje vijonte deri në fund të gjykimit, jo më pas, ndërsa problematikat me detyrimin për ushqim vijonin edhe më pas, ndaj prindërit që pretendojnë detyrimin për ushqim mbeten pa asistencë ligjore të specializuar gjatë kësaj faze.
- Psikologët e caktuar nga gjykata/gjyqtarët në çështjet e divorcit, si në Gjykatën e Rrethit Sarandë edhe në atë Vlorë, nuk ishin trajnuar për çështje të mbrojtjes së fëmijës, dhe në disa raste as nuk ishin të licensuar për ta ofruar këtë shërbim në gjykatë/gjyq dhe kishin mungesë të profesionalizmit (*ndonjëherë raportet e tyre nuk i adresojnë plotësisht çështjet/pyetjet e ngritura nga gjykata, dhe në shumë raste ato ishin identike me raportet e mëparshme*).
- Gjyqtarëve iu mungon specializimi në çështjet familjare. Në gjykatat e Sarandës dhe Vlorës, jo të gjithë gjyqtarët e ofrojnë ndërmjetësimin si një alternativë për ta zgjidhur konfliktin para se të përfundojnë në gjyq; për më tepër, gjyqtarët caktonin rregullisht të njëjtët psikologë në gjyqet e divorcit, jo psikologë të tjerë të paraqitur në listën e lëshuar nga Urdhri/Shoqata e Psikologëve, gjyqtarët kanë marrë vendime për çështjen bazuar në shumë pak prova të paraqitura, vendimet e gjykatës ishin shtjelluar pothuajse në të njëjtën mënyrë për çështje të ndryshme, e drejta e prindërve për t’u takuar me fëmijët e tyre paraqitej në vendimin e shqyrtuar të gjykatës pothuajse në të njëjtën mënyrë, madje edhe pse rrethanat nuk ishin të ngjashme. Gjithashtu, gjyqtarët kanë mungesë trajnimesh mbi problematika/çështje familjare.
- Përmbaruesit - Gjatë monitorimit u vu re se ekzekutimi i vendimeve të gjykatës ishte shumë i vështirë për shkak të adresave jo të sakta të deklaruara nga debitori, prindërve që jetojnë jashtë vendit, mungesës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe rrjedhimisht mungesës së informacionit mbi pasuritë e prindërve, mungesës së të ardhurave nga prindërit për shkak të papunësisë, etj.
- Ndihma ligjore: nga monitorimi i gjyqit rezultoi se pavarësisht se palët kanë të drejtën e qasjes në ndihmën ligjore në rastet kur ata nuk mund ta përballojnë atë, nuk kishte institucione shtetërore/zyra/zyrtarë në çdo qytet që mund t’ua ofronin qytetarëve. Në shumicën e çështjeve të monitoruara, palët nuk kishin formim ligjor dhe nuk dinin si të silleshin gjatë gjyqit.

## Rekomandime

- Ekziston nevoja për të forcuar masat ndëshkuese të parashikuara me ligj për prindërit që nuk paguajnë detyrimet për ushqim, përderisa vendosja e gjobave nuk është efikase. Krahas kësaj,

shteti duhet të marrë masa për legalizimin dhe regjistrimin e aseteve të qytetarëve, si parakusht për ekzekutimin më të mirë të vendimeve të gjykatës nga përmbaruesit.

- Nevojitet ofrimi i asistencës financiare (nga shteti) për prindërit e divorcuar që nuk kanë të ardhura për të paguar shërbimin për ushqim, dhe lehtësimi i mundësive për punësimin e tyre.
- Gjithashtu, nevojitet ngritja dhe adoptimi i një sistemi për mbledhjen e detyrimeve për ushqim nga prindërit që jetojnë jashtë vendit. Përmbaruesit duhet të kenë të drejtën për të kërkuar adresën dhe vendndodhjen e prindërve që kanë detyrime për ushqim, si brenda edhe jashtë vendit.
- Psikologët duhet të jenë të pranishëm në takimet me prindërit. Duhet krijuar kushtet dhe mjediset e duhura për takimet me prindërit, dhe takimet duhet të mbahen në prani të përmbaruesve.
- Për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës, gjykata duhet të vendosë se kur do të monitorohen pagesat e detyrimit për ushqim nga shërbimet sociale shtetërore, veçanërisht për rastet kur prindërit nuk e paguajnë atë.
- MD-ja ose Zyra e Përmbarimit duhet të ndërmarrin veprime për të propozuar dhe miratuar ndryshime në legjislacionin mbi procedurat e përmbarimit lidhur me zbatimin e vendimeve të gjykatave për detyrimin për ushqim, duke siguruar procedura zbatimi të shpejta dhe në kohë pas dhënies së vendimit të formës së prerë, dhe duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe nevojën e fëmijës për pagesat për ushqim. Gjithashtu, Zyra e Përmbarimit, MD-ja ose OSHC-të duhet të ofrojnë trajnime për përmbaruesit mbi procedurat e reja.
- Noterët duhet ta përpilojnë marrëveshjen për divorcin konsensual në përputhje me ligjin.
- Institucionet shtetërore duhet të rishikojnë politikatat e tyre mbi pagesën jetike minimale për fëmijët e prindërve të divorcuar, dhe të miratojnë kriteret për përllogaritjen e detyrimeve për ushqim për fëmijët në faza të ndryshme të jetës së tyre.
- OSHC-të ose institucionet përkatëse, si SHM-ja, Dhoma e Avokatisë ose Shoqata e Psikologëve duhet të organizojnë trajnime të detyrueshme për gjyqtarët, avokatët dhe psikologët mbi të drejtat e fëmijëve gjatë gjyqeve të divorcit dhe ekzekutimit të vendimit të gjykatës për detyrimet për ushqim, si dhe të rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështje të tilla.

## 8. Organizata: Njerëz në Fokus/PF

<b>Titulli i projektit</b>	Shërbime më të mira të Gjykatës Administrative për qytetarët e Shkodrës
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i performancës së Gjykatës Administrative (të shkallës së parë)/GJASHP, Apelit/GJA dhe Gjykatës së Rrethit/GJRR Shkodër duke ofruar shërbime cilësore dhe efikase për qytetarët/përdoruesit.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017- qershor 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Shkodër (Monitorimi i 3 Gjykatave të Shkodrës - Gjykata e Rrethit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit)

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi një raport monitorimi** mbi cilësinë e shërbimeve administrative të ofruara nga tre gjykatat në Shkodër (GJASHP, GJRR dhe GJA) dhe performancën e gjykatës, bazuar në të dhënat e mbledhura nga intervistat me stafin administrativ të tre gjykatave të monitoruara, anketimi/

pyetësorët me përdoruesit e gjykatës, për të matur performancën e shërbimeve të gjykatës administrative (në total, në Shkodër u përfshinë 300 përdorues - 100 përdorues të GJASHP-së, 100 të GJA-së dhe 100 të GJRR-së), nga fokus grupet për të eksploruar situatën e shërbimeve të gjykatës administrative, për të vlerësuar perceptimin e përdoruesve të gjykatës mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe për të ofruar sugjerime/mënyra për përmirësimin e tyre, praktikën e “vëzhgimit në fshehtësi” për monitorimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit (160 kopje).

- **Organizoi 1 seancë trajnimi** me të rinjtë në Shkodër mbi çështje të monitorimit të gjykatës nga këndvështrimi i përdoruesve (24 pjesëmarrës).
- **Zhilloi fushatë ndërgjegjëse në zonat urbane dhe rurale të Shkodrës** për të ofruar informacion mbi të drejtat e qytetarëve për shërbime gjyqësore cilësore: 5 kanale televizive (TVSH, TVSH24, Zëri i Amerikës, Star Plus, Rozafa TV, TV1 channel) transmetuan gjatë lajmeve aktivitetin publik që prezantoi gjetjet nga rezultatet e projektit të monitorimit të gjykatës dhe ekspertët e intervistuar të projektit, 1 artikull u publikua në një portal online mbi gjetjet e projektit, u shpërndanë fletëpalosje (1000), informim në median sociale (6374 nga fushata online e ndërgjegjësimit).

### Përmbledhje e gjetjeve

- Monitorimi i Gjykatave të Shkodrës evidentoi problematika lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara për përdoruesit. Megjithatë, gjatë monitorimit u vu re angazhim i stafit të gjykatës. Këto problematika lidheshin kryesisht me mungesën e stafit administrativ, si sekretare/asistentë, dhe me mungesën e trajnimeve profesionale për ta mbi etikën dhe shërbimin e klientit.
- Gjithashtu, monitorimi nxori në pah infrastrukturën e papërshtatshme të gjykatës, si mungesa e ndenjësive në hapësirën e akomodimit, mungesën e shenjave orientuese, mungesën e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara, etj., (përveç GJA-së që u ndërtua së fundmi), mungesën e sporteleve të informacionit (të gjitha gjykatat e monitoruara kishin vetëm një sportel informacioni për ofrimin e shërbimeve), mungesën e sallave të gjyqit, e ndërthurur me mungesën e solemnitetit të gjyqimit gjatë gjyqit (përveç GJA-së), mungesën e sistemit të menaxhimit të radhës, mungesën e sigurisë fizike në gjykatë duke qenë se detektorët metalikë shpesh janë të fikur dhe policët në hyrje të institucionit nuk i kontrollojnë individët, orët e kufizuara për përdoruesit për të marrë shërbime, mungesën e shërbimeve administrative të standardizuara, informacionin e kufizuar në faqen e internetit të gjykatës, mungesën e mekanizmit të feedback-ut për shërbimet e gjykatës (asnjë prej gjykatave nuk mblidhte feedback/përshtypje përmes pyetësorëve/kutisë të ankesave/anketimit). Krahas këtyre, sistemi ICMIS (sistemi i menaxhimit të çështjeve) nuk është miqësor me përdoruesin, nuk gjeneron statistika dhe në disa raste pengon punën e gjykatës administrative për shkak të vështirësive në ngarkimin e të dhënave.
- Shumica e përdoruesve (71%) që u pyetën mbi funksionimin e gjykatës gjatë 5 viteve të fundit deklaruan se aktiviteti i gjykatës nuk ka ndryshuar, ndërsa për 23% të tyre funksionimi i gjykatës ishte përmirësuar, dhe për 3% ishte përkeqësuar.

### Rekomandime

- Hartimi i formularëve të standardizuar që janë të lehtë për t'u kuptuar dhe plotësuar për secilin shërbim që ofron gjykata.
- Ofrimi i informacionit standard përmes të gjitha kanaleve të komunikimit (sporteli i informacionit, këndi i informacionit, faqja e internetit, telefoni, emaili).
- Rimodelimi ose riprojektimi i Këndit të Informacionit në një mënyrë më të dobishme për qytetarët, për të tria gjykatat e monitoruara, duke reklamuar informacionin bazë të gjykatës.

- Përditësimi dhe bërja e faqes së internetit të gjykatës më miqësore me përdoruesin, e cila, ndër të tjera, duhet të ofrojë informacion të dobishëm për qytetarët, si mekanizmi i ankesave, kontaktet për ndihmën ligjore falas, informacion për çdo shërbim administrativ, etj.
- Nxitja e komunikimit përmes emailit dhe telefonit (*mblidhni dhe merrni informacion*) brenda afateve kohore ligjore, bazuar në procedurën e standardizuar të paramiruar.
- Përditësimi i Rregullores së Gjykatës me përshkrim të detajuar pune për stafin administrativ të Gjykatës.
- Hartimi i një procedure të qartë për mekanizmat e ankesave mbi ofrimin e shërbimit administrativ, për të ofruar feedback lidhur me çdo ankesë të depozituar nga përdoruesit (*kutia e ankesave, takim me kancelarin, takim me kryegjyqtarët, etj.*).
- Shtimi i orëve të shërbimit për përdoruesit e gjykatës, veçanërisht për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Rrethit Shkodër, gjatë gjithë orëve zyrtare të punës.
- Publikimi dhe disponueshmëria online e kontakteve për të gjitha institucionet shtetërore dhe OSHC-të, që ofrojnë ndihmë ligjore falas, nëpërmjet të gjitha kanaleve të mundshme të komunikimit.
- Nxitja e mundësive të stazhit për studentët e shkollës së drejtësisë në Fakultetin e Drejtësisë së Shkodrës, të cilët fillimisht mund të trajnohen dhe më pas mund t'i ndihmojnë gjykatat në ofrimin e informacionit për qytetarët (*Qasja e trajnimit dhe mentorimit - "Meeter Greeter"*).
- Ngritja e një mekanizmi të brendshëm të gjykatës për të matur në mënyrë periodike kënaqshmërinë e përdoruesve.
- Shtimi i burimeve njerëzore, i numrit të stafit administrativ në gjykatën përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për përdoruesit.
- Forcimi i kapaciteteve të stafit administrativ. Zhvillimi i trajnimeve dhe workshop-eve periodike mbi procedurat e ofrimit të shërbimit, si dhe trajnimit mbi etikën dhe komunikimin.
- Riprojektimi i mjediseve të gjykatës, duke ngritur një sportel të ri informacioni për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Rrethit Shkodër, dhe përmirësimi i shenjave orientuese dhe akomodimit për publikun dhe përdoruesit e gjykatës.
- Adoptimi i një "Sistemi të menaxhimit të radhës" nëpërmjet biletave.
- Përmirësimi i sistemit aktual TI (*ICMIS*) për ta bërë më miqësor me përdoruesin për gjykatën dhe qytetarët.

## 9. Organizata: Komiteti Shqiptar i Helsinkit/KSHH

<b>Titulli i projektit</b>	Rritja e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit të Institucioneve të Reja Qeverisëse të Drejtësisë - <i>Monitorimi i ngritjes dhe funksionimit të organeve të reja qeverisëse të sistemit të drejtësisë</i>
<b>Qëllimi i projektit</b>	Monitorimi i ngritjes dhe funksionimit të organeve të reja qeverisëse të gjyqësorit në Shqipëri, pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe ligjeve të reja mbi kontekstin e reformës në gjyqësor, për të rritur transparencën e zbatimit të reformës në gjyqësor lidhur me publikun, median dhe shoqërinë civile, dhe nxitja e përfshirjes më të madhe në këtë proces të ngritjes dhe funksionimit të Këshillit të ri të Lartë Gjyqësor/KLGJ-së, Këshillit të Lartë të Prokurorisë/KLP-së dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi/KED-së.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	<i>prill 2018 – mars 2019</i>
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tiranë

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi një raport monitorimi** mbi procedurat e kryera nga institucionet shtetërore për ngritjen dhe funksionimin e KLGJ-së, KLP-së dhe KED-së, dhe performancën e tyre pas ngritjes. Monitorimi përfshiu edhe ekzekutimin e kompetencave tranzitore të PP-së. Monitorimi u krye nga një rrjet profesionist i ekspertëve vendorë, ndërsa metodologjia u zhvillua nga një ekspert ndërkombëtar.
- **Ndërgjegjësoi** dhe mobilizoi OSHC-të dhe qytetarët mbi procesin e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të KLGJ-së, KLP-së dhe KED-së, duke publikuar dhe prezantuar gjetjet e raportit të monitorimit për ngritjen e organeve të reja qeverisëse në gazeta dhe kanale televizive (*p.sh. Agjencia Telegrafike Shqiptare, gazeta Panorama, Televizioni RTSH, Televizioni Vizion Plus, Televizioni Top Channel*), në median sociale (*12 reagime dhe 779 shikues*) dhe në Konferencën Vjetore të KSHH-së.

### Përmbledhje e gjetjeve

- **Monitorimi i KLGJ-së dhe KLP-së** nxori në pah vonesa kohore për ngritjen e tyre më të gjata krahasuar me afatet kohore ligjore, për shkak të vonesave në procesin e vetingut të gjyqtarëve dhe vështirësive për të gjetur kandidatët që përmbushin kriteret, veçanërisht për kandidatët jomagjistratë (*avokatë, akademikë, shoqëri civile*), procesit të përsëritur të vlerësimit (*fillimisht nga komisionet e posaçme dhe më pas nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit*) për kandidatët jomagjistratë për KLGJ dhe KLP, pengesës nga ana e opozitës lidhur me procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë nga Kuvendi, dhe rrjedhimisht procesi u përmbyll përmes shortit, duke shmangur dialogun konstruktiv dhe anashkaluar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë bazuar në meritë.
- **Monitorimi i qeverisjes së gjyqësorit** evidentoi se sistemi i gjyqësorit përballej me shumë problematika dhe vonesa për shkak të ngritjes me vonesë të KLGJ-së (2.5 vjet), duke filluar me vendet vakante të paplotësuara në Gjykatën e Lartë dhe në gjykata të tjera të krijuara nga procesi i vetingut, probleme në emërimin e magjistratëve të rinj (*problematika që u zgjidhën me ngritjen e KLGJ-së*), probleme lidhur me procedimet disiplinore, afatet kohore dhe kuorumin për procedimet e nisura ndaj gjyqtarëve, vonesat në përfundimin e vlerësimit të gjyqtarëve, problematika me transferimin e gjyqtarëve (*gjyqtarë që delegohen/emërohen për periudha të caktuara nga njëra gjykatë*

në tjetrën), ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve, etj.

- **Monitorimi i Prokurorit të Përgjithshëm/kompetencave tranzitore të PP-së** për shkak të reformës në drejtësi dhe emërimit të Prokurorit të ri të Përgjithshëm të Përkohshëm (*bazuar në shqyrtimin e vendimeve dhe urdhrave të nxjerrë nga PP-ja dhe në mbulimin e gjerë mediatik*) zbuloi se disa vendime dhe urdhra të PP-së nuk ishin publikuar në faqen zyrtare të internetit të PP-së, ose nuk ishin të disponueshme për publikun, kishte mungesë transparence, madje edhe kur ky informacion kërkohej zyrtarisht nga KSHH-ja, këto vendime/urdhra nuk kishin arsyetim ose kishin arsyetim të dobët dhe referencat e tyre ligjore nuk ishin të qarta, ndaj 4 prej këtyre urdhrave u shfuqizuan kur u apeluan në gjykatë.
- **Monitorimi i takimeve të KLGJ-së dhe KLP-së** nxori në pah se këto institucione janë përballur me një ngarkesë të madhe pune, mungesë infrastrukture, buxheti, personeli, logjistike, etj. Megjithatë, atyre iu është ofruar mbështetje e madhe dhe bashkëpunim i frytshëm nga misionet ndërkombëtare. Takimet janë mbajtur në një atmosferë proaktive diskutimesh dhe etike, kryesisht në përputhje me kërkesat ligjore. Për sa i përket transparencës, lejohej vetëm filmimi i mbledhjeve të tyre konstituente, me pretendimin e mbrojtjes (KLP) së të dhënave personale të personave të prekur, duke shkelur kërkesat kushtetuese për lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit; megjithatë, të dyja institucionet ofronin informacion online për mbledhjet e tyre (*KLGJ-ja nëpërmjet një përmbledhjeje të procesverbalit të zbardhur dhe KLP-ja nëpërmjet publikimit të regjistrimit audio të mbledhjeve*). KLGJ-ja dhe KLP-ja kanë ngritur 4 komisione të përhershme, por procedura nuk ka qenë plotësisht e qasshme nga monitoruesit e KSHH-së. KLGJ-ja dhe KLP-ja kanë operuar ndryshe lidhur me vendet vakante të krijuara për shkak të procesit të vetingut. KLP-ja i publikoi vendet vakante për t'i plotësuar, ndërsa KLGJ-ja ia delegoi kompetencat e saj zëvendës anëtarëve.
- **Monitorimi i ngritjes dhe funksionimit të KED-së** evidentoi vonesa, të cilat bllokuan vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese/GJK-së për shkak të numrit të lartë të vendeve vakante (*aktualisht, GJK-ja ka mbetur vetëm me 1 anëtar*), pikëpyetje lidhur me momentin kur kandidatët e viteve pasardhëse do të fitojnë legjitimitetin e mandatit të tyre njëvjeçar, të ndërthurura me mungesën e transparencës në faqet zyrtare të internetit të KLGJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese, lidhur me publikimin e listës së kandidatëve që përmbushin kriteret për KED-në. Shorti i vitit 2019 për anëtarët e rinj të KED-së nga Kuvendi i Shqipërisë ishte transparent dhe u monitorua nga OSHC-të. Aktualisht, KED-ja funksionon me 7 nga 9 anëtarë. Media u lejua të ishte e pranishme vetëm gjatë mbledhjes së parë; të gjitha mbledhjet e tjera u mbajtën me dyer të mbyllura, siç e parashikon ligji. Megjithatë, përmbledhjet e mbledhjeve të publikuara deri më tani për KED 2019 ishin shumë të kufizuara në informacion dhe mjaft të përgjithshme, dhe iu mungonte transparencja. Vendimet e KED-së të marra në vitin 2019 ishin të arsyetuara dobët, iu mungonte qartësia dhe ishin shumë të përgjithshme.
- **Monitorimi i ngritjes së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë/ILD-së** zbuloi vonesa mbi 2-vjeçare, për shkak të procesit të vetingut dhe vonesa në ngritjen e KED-së, duke sjellë mungesën e inspektimit të shkeljeve disiplinore nga gjyqtarët dhe prokurorët. KED-ja nuk ka qenë transparente në ofrimin e informacionit mbi baza dhe referenca ligjore për thirrjen e fundit për aplikime për kandidatë të KLGJ-së, duke shkelur edhe afatet kohore të miratuara nga vetë ajo.

## Rekomandime

- KLP-ja dhe KLGJ-ja duhet të ushtrojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase të gjitha kompetencat që parashikon ligji, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e PP-së së ri dhe anëtarëve të SPAK/Strukturës së Posaçme Antikorrupsion.
- Kuvendi duhet të ndryshojë ligjet për të plotësuar vakumin e krijuar si rezultat i vendimit të



Gjykatës Kushtetuese për statusin e gjyqtarëve dhe institucioneve qeverisëse, si dhe të rishikojë dispozitat kundërshtuese ose të paqarta për funksionimin e institucioneve qeverisëse të sistemit të drejtësisë.

- OSHC-të duhet të vijojnë të monitorojnë në vazhdimësi funksionimin e institucioneve qeverisëse të drejtësisë, t'i informojnë qytetarët për rezultatin e monitorimit dhe të advokojnë për përmirësimin e mënyrës së funksionimit të tyre.

## 10. Organizata: Instituti për Kontratën Sociale/SCI

<b>Titulli i projektit</b>	Përmirësimi i dhënies dhe zbatimit të dënimeve alternative/DA
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i sasisë dhe cilësisë së dënimeve alternative të dhëna nga gjykatat e synuara të rrethit, dhe monitorimi i 6 Zyrave të Shërbimit të Provës në këto rrethe.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 - mars 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tropojë, Dibër, Krujë, Pogradec, Përmet dhe Sarandë

### Aktivitetet kryesore

- **Hartoi një raport monitorimi** mbi zbatimin e dënimeve alternative të dhëna nga gjykatat e 6 juridiksioneve të synuara (*Tropojë, Dibër, Krujë, Pogradec, Përmet dhe Sarandë*) dhe të zbatuara nga zyrat e SHP-së, në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe praktikat më të mira për dënimin alternativ. Raporti i monitorimit u bazua në të dhënat e mbledhura nga çështjet/gjyqet e monitoruara, shqyrtimin e vendimeve të gjykatës dhe raportet e SHP-së, si dhe në 6 Fokus Grupe me palët mbrojtëse (60 pjesëmarrës), në 44 takime me palët e interesit (përfaqësues të zyrave të Shërbimit të Provës/SHP - Shërbimi i Provës, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët në Dibër, Tropojë, Pogradec, Krujë, Përmet dhe Sarandë, Sekretari i Përgjithshëm i MD-së, kreu i Programit të Formimit të Vazhdueshëm të SHM-së, etj.) dhe në 27 intervista me palët e interesit (gjyqtarë, prokurorë, Drejtori i Përgjithshëm i SHP-së në Shqipëri dhe përfaqësues të Shkollës së Magjistraturës)

### Përmbledhje e gjetjeve

- Në rrethin e Tropojës, dënimet alternative (DA) përdorshin gjerësisht (61% për vitin 2015, 89% për 2016 dhe 88% për 2017), krahasuar me rrethet e tjera të monitoruara, gjë që pasqyron një mesatare të DA-ve të dhëna në 25% të çështjeve për vitin 2015, 49% për 2016 dhe 55% për 2017. Për pjesën e mbetur të rretheve, të marra individualisht, aplikimi i DA-ve ka qenë nën 54% për të gjitha vitet. Rrethi me aplikimin më të ulët të DA-ve ishte Saranda për vitet 2015, 2016 dhe 2017, me përkatësisht 13%, 24% dhe 30% të DA-ve të dhëna.
- Përmbajtja e neneve 59 dhe 60 të Kodit Penal/KP është kontradiktore, dhe gjykatat e kanë të vështirë ta aplikojnë kur japin DA.
- Sipas përmbajtjes aktuale të dispozitave përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, rezulton se SHP-ja nuk përmendet si një nga subjektet procedurale gjatë procedimeve penale ose shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Specialistët e SHP-së nuk marrin pjesë në gjyq dhe dokumentet e tyre nuk janë subjekt i marrjes në pyetje nga pala e akuzës, siç është akti i ekspertimit.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i DA-ve pa një vendim të formës së prerë ka krijuar probleme në

praktikë. Prokurorët nuk kanë veprim të unifikuar në këtë aspekt.

- Iniciativat për angazhimin e komuniteteve dhe OSHC-ve në procesin e zbatimit dhe monitorimit të DA-ve kanë qenë sporadike dhe jo të mirorganizuara.

## Rekomandime

- Kuvendi i Shqipërisë duhet të përshpejtojë miratimin e një ligji organik për Shërbimin e Provës, që është jetik për statusin e tij.
- Kuvendi i Shqipërisë duhet të ndryshojë KP-në dhe KPP-në për të shmangur mospërputhjet midis neneve 59 dhe 60 të KP-së.
- Kuvendi i Shqipërisë duhet të ndryshojë KP-në në mënyrë që figura e veprës penale të kryer nga i pandehuri të mos vlerësohet nga masa e dënimit që vendos gjykata, por me masat sanksionuese që parashikohen në dispozitat e Kodit Penal.
- Kuvendi i Shqipërisë duhet të ndryshojë legjislacionin për të përcaktuar qartësisht pozicionin procedural të specialistëve të SHP-së në procesin e gjykimit penal dhe natyrën e dokumentacionit që ata paraqesin në gjykatë dhe prokurori.
- Institucionet trajnuese (SHM, DHKA) duhet të organizojnë më shumë trajnime me ekspertë të kualifikuar për gjyqtarët, avokatët dhe stafin e SHP-së mbi Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, bazën ligjore dhe praktikën më të mira ndërkombëtare për zbatimin e DA-ve nga shtetas të huaj që nuk banojnë në Shqipëri dhe masat alternative për paraburgim, për një kuptim të unifikuar dhe praktikë të zakonshme për zbatimin e tyre.
- OSHC-të ose institucionet përkatëse, si KLGJ-ja, KLP-ja, SHP-ja, etj., duhet të studiojnë efikasitetin e lirisë së madhe të veprimit të dhënë gjyqtarit në caktimin e DA-ve.
- OSHC-të duhet të vijojnë t'i nxisin të gjitha organet e zbatimit të ligjit të aplikojnë të gjitha llojet e DA-së, dhe të aplikojnë më tej caktimin e masave plotësuese në përputhje me DA-në, të parashikuara në nenin 59 të KP-së.
- SHP-ja duhet të reduktojë ngarkesën e punës së stafit të saj, nëpërmjet rekrutimit të stafit të nevojshëm, sipas praktikave dhe kriterëve të përcaktuara në ligj, të ndërthurura me infrastrukturë dhe kushte më të mira pune.
- Prokuroria duhet të mbikëqyrë aktivitetin e zyrave rajonale të SHP-së duke përdorur formularë alternativë ndërveprues të mbikëqyrjes, jo vetëm përmes marrjes së raporteve për ekzekutimin e DA-ve.
- OSHC-të duhet të vijojnë të kryejnë fushata informuese dhe edukuese për publikun e gjerë, OSHC-të e tjera dhe institucionet e qeverisjes vendore në lidhje me kuadrin ligjor të DA-ve.

## 11. Organizata: Instituti i Migracionit, Zhvillimit dhe Integritet/IMZHI

<b>Titulli i projektit</b>	Zgjidhja e re alternative e mosmarrëveshjeve në bashkitë e Kurbinit dhe Përmetit
<b>Qëllimi i projektit</b>	Kufizimi i ndikimit negativ të funksioneve të sistemit ligjor, reduktimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe sigurimi i disponueshmërisë dhe përdorimit të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill - dhjetor 2018
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Kurbin dhe Përmet ( <i>përkatesisht qytetet e Lezhës dhe Tepelenës</i> )

### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi 6 ditë të hapura** me palë kyçe të interesit për të rritur ndërgjegjësimin mbi praktikën restauruese dhe ndërmjetësimin, për të identifikuar dhe shpërndarë praktikën më të mira, për të ngritur rrjete dhe lehtësuar bashkëpunimin më të mirë ndërmjet tyre (55 pjesëmarrës).
- **Organizoi 4 workshop-e** me stafin edukativ dhe të paraburgimit për të identifikuar rastet kur mund të aplikohen teknikat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, për të rritur ndërgjegjësimin mbi këto çështje, për të ngritur kapacitetet e administratës publike, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit, të cilët ishin shpesh në kontakt me qytetarët që kishin nevojë për qasje në Institut për të marrë shërbime të DR-së (40 pjesëmarrës).
- **Organizoi 20 takime dhe 6 ditë të hapura me palët kyçe të interesit** për të pasuruar njohuritë, për të shkëmbyer përvojat dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi me institucionet e zbatimit të ligjit (*gjykatat, policinë, prokurorët, etj.*), për të pasur praktikë efektive dhe të suksesshme të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin në qytetet e Lezhës dhe Tepelenës.
- **Hartoi një raport monitorimi** mbi kushtet e të burgosurve në mjediset e burgimit dhe paraburgimit, dhe mbi të drejtat e tyre për qasje në drejtësi (*në mjediset e burgimit në Lezhë, Tepelenë dhe në Komisaratin e Policisë Përmet*). Të dhënat u mbledhën nga monitorimi, i cili përfshiu 121 intervista dhe formularë monitorimi, dhe 15 vizita të kryera në godinat e burgimit dhe paraburgimit.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Monitorimi i institucionit të vuajtjes së dënimit në Lezhë evidentoi se një qeli kishte zakonisht 5 të dënuar/burgosur. 97.6% e të intervistuarve në qendrën e burgimit/IEVP (të anketuarit) deklaruan se atyre iu ishte garantuar e drejta për të folur; 2.4% e të anketuarve deklaruan se kjo e drejtë nuk iu garantua duke qenë se gjykata i dëgjoi ata vetëm në seancën e parë, por nuk i kushtoi vëmendje kërkesës së tyre. 7% e të anketuarve pretendonin se kishin qenë viktimë të dhunës në mjediset e IEVP-së, ndërsa pjesa e mbetur prej 93% mohuan të kishin qenë viktimë të dhunës. Për sa i përket të drejtës së tyre për proces të rregullt, 93% e të anketuarve pranuan se iu ishte ofruar ndihmë ligjore dhe 7% mohuan që t'i ishte ofruar kjo e drejtë. 69% e tyre pohuan se nuk kishin pasur mundësi financiare për të paguar për ndihmë ligjore dhe 31% e të anketuarve pranuan se kishin pasur mundësi financiare për ta përfutur atë privatisht.
- Monitorimi i institucionit të vuajtjes së dënimit në Tepelenë evidentoi se një qeli kishte zakonisht 5 të dënuar/burgosur. 77% e të intervistuarve në qendrën e burgimit/IEVP (të anketuarit) deklaruan se atyre iu ishte garantuar e drejta për të folur; 16% e të anketuarve deklaruan se kjo e drejtë

nuk iu garantua dhe për 7% kjo e drejtë respektohej pjesërisht duke qenë se gjykata i dëgjoji ata vetëm në seancën e parë, por nuk i kushtoi vëmendje kërkesës së tyre. 5% e të anketuarve pretendonin se kishin qenë viktimë të dhunës në mjediset e IEVP-së, ndërsa 93% mohuan të kishin qenë viktimë të dhunës, dhe 2% e të anketuarve deklaruan se kishin qenë dëshmitarë të një shtate dhune. Për sa i përket të drejtës së tyre për proces të rregullt, 54% e të anketuarve pranuan se iu ishte ofruar ndihmë ligjore dhe 46% mohuan që t'i ishte ofruar kjo e drejtë. 64% e tyre pohuan se nuk kishin pasur mundësi financiare për të paguar për ndihmë ligjore dhe 36% e të anketuarve pranuan se kishin pasur mundësi financiare për të përfituar atë privatisht.

- Nga monitorimi i Komisarariatit të Policisë Përmet u vu re se në një qeli ndodheshin zakonisht 3 persona. Për të gjithë 23 të anketuarit (100%) ishte garantuar e drejta e fjalës dhe asnjë prej tyre nuk kishte qenë viktimë e dhunës. Të gjithëve (100%) iu ishte ofruar ndihmë ligjore, por vetëm 78% e tyre e kishin përfituar, ndërsa 22% e tyre kishin zgjedhur të kontaktonin një avokat privat. 83% e tyre pohuan nuk kishin pasur mundësi financiare për të paguar një avokat privat dhe 17% pretendonin se kishin paguar për ndihmë ligjore me paratë që kishin marrë hua nga familjarët dhe të afërmit.

## Rekomandime

- OSHC-të që punojnë në fushën e masave alternative ndaj burgimit dhe ndërmjetësimit duhet të vijojnë të ofrojnë asistencë dhe informacion për qytetarët, lidhur me zgjidhjet e reja alternative të mosmarrëveshjeve, si një formë e re e qasjes në sistemin e drejtësisë, veçanërisht për grupet e cënueshme.
- Institucionet shtetërore përkatëse duhet të ofrojnë shërbime dhe programe rehabilitimi për grupet e cënueshme, përmes bashkëpunimit me kryegjyqtarët e gjykatës, gjyqtarët, avokatët dhe të gjitha palët e interesit.
- OSHC-të duhet të organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese për të rritur angazhimin qytetar për zgjidhjen e problemeve lidhur me drejtësinë, dhe për t'i përfshirë qytetarët në këtë proces.
- OSHC-të, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet trajnuese, duhet të rrisin aftësitë e profesionistëve të drejtësisë, si avokatë, gjyqtarë, prokurorë, këshilltarë ligjorë, si dhe punonjës policie, mbi praktikën e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese, duke organizuar tryeza të rrumbullakëta të ndryshme, trajnime dhe workshope.
- OSHC-të duhet të jenë më proaktive dhe të advokojnë për ndryshime ligjore për të lehtësuar dhe adresuar shqetësimet madhore të identifikuara brenda burgjeve, duke vepruar si urë lidhëse ndërmjet shtetit dhe komunitetit të burgjeve, të kontribuojnë në ndërgjegjësimin për shkeljet aktuale të të drejtave të njeriut në qendrat e burgimit dhe të të nxisin iniciativa për të drejtat e njeriut në mbarë Shqipërinë.
- OSHC-të duhet të vijojnë t'i ndërgjegjësojnë qytetarët përmes medias së shkruar dhe asaj vizive.

## 12. Organizata: Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe të Torturës/QSHRTT

<b>Titulli i projektit</b>	Fëmijët në sistemin e drejtësisë: Monitorimi i sistemit të mbrojtjes ligjore të fëmijës dhe qasjes së barabartë në drejtësi gjatë proceseve civile, administrative dhe penale.
<b>Qëllimi i projektit</b>	Kontribuimi me mekanizma juridike transparente dhe llogaridhënese që sigurojnë qasje në drejtësi për fëmijët në nevojë dhe rrisin ndërgjegjësimin dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, përmes monitorimit të sistemit të mbrojtjes ligjore të fëmijëve dhe qasjes së barabartë në drejtësi gjatë proceseve gjyqësore civile, administrative dhe penale për fëmijët në konflikt me ligjin.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	dhjetor 2017 – korrik 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Tiranë, Durrës, Kavajë, Elbasan, Lezhë, Korçë, Vlorë

### Aktivitetet kryesore

- **Zhvilloi monitorimin e gjyqit dhe hartoi raportin e monitorimit** mbi të drejtat e fëmijëve dhe qasjen e tyre në gjykatë; të dhënat u mbledhën nga gjykatat e Tiranës, Durrësit, Kavajës, Elbasanit, Lezhës, Korçës, Vlorës (60 çështje). Pjesë e raportit të monitorimit ishin edhe të drejtat e fëmijëve dhe qasja e tyre në mjediset e burgimit/paraburgimit dhe institucionet korrigjuese për të miturit në Tiranë, Kavajë, Lezhë, Korçë, Vlorë (40 vizita në burgje), si dhe raporti i vlerësimit të nevojave mbi pengesat dhe sfidat në qasjen në drejtësi për fëmijët dhe mënyrat e kapërcimit të tyre gjatë proceseve gjyqësore (400 kopje, botim në dy gjuhë).
- **Zhvilloi konsultim** me palët përkatëse të interesit për të mbledhur këndvështrimet e tyre mbi sfidat dhe pabarazitë me të cilat përballen fëmijët kur ndërveprojnë me sistemin e drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/DPP, Ministria e Drejtësisë, Policia e Shtetit/PSH dhe Ministria e Punëve të Brendshme)
- **Organizoi 1 ToT/trajnim të trajnuesve** për 15 ekspertë të ekipit shumëdisiplinor (paraburgim dhe burgim) mbi metodologjitë dhe protokollat standarde për identifikimin e rasteve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhe qasjen në drejtësi.
- **Ofroi ndihmë ligjore dhe përfaqësim në gjykatë** për çështjet e identifikuar gjatë monitorimit të seancave gjyqësore dhe paraburgimit (përfaqësim në gjykatë për 5 çështje; 18 çështje u referuan në institucione të tjera, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndihmë ligjore për 40 çështje).
- **Publikoi dhe shpërndau materiale promovuese:** 4 fletëpalosje të printuara në 150 kopje secila, 5 fragmente të shtypit të shkruar, 1 poster.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Gjatë monitorimit të ndihmës ligjore u adresuan problematikat/sfidat e mëposhtme:
  - mungesa e avokatëve jashtë zonave urbane:
  - ngurrimi i dhomës së avokatëve për t'i lejuar profesionistët ligjorë që të plotësojnë mungesën e avokatëve të disponueshëm.
  - avokatë të keqpaguar.
  - ndonjëherë njerëzve iu mungon besimi në cilësinë e shërbimeve të ndihmës ligjore.
  - njerëzit nuk e dinë se shërbimet e ndihmës ligjore janë të disponueshme pa pagesë ose me

pagesë të ulët, ose se ku të kërkojnë ndihmë ligjore.

- Monitorimi i mjediseve të burgimit dhe paraburgimit evidentoi:
  - mungesën e kuptimit të qartë ndërmjet barazisë, paanshmërisë dhe drejtësisë lidhur veçanërisht me fëmijët/të miturit.
  - ambiente burgimi të mbipopulluara, paraburgim i tejzgatur, cilësi të dobët të mbrojtjes, sistem jo të ndjeshëm ndaj nevojave të veçanta të të miturve për arsimim, shëndetësi, shëndet mendor, rehabilitim dhe alternativa.
  - procese gjyqësore të ngadalta, mungesë efikasiteti dhe paanshmërie gjatë procedurave të gjyqit dhe paraburgimit lidhur me vështirësitë në zbatimin e legjislacionit të ri për drejtësinë penale për të miturit në konflikt me ligjin, zbatimin e dënimeve alternative, programet e rehabilitimit para dhe pas lirimit, komunikimin e dobët me fëmijët, etj.

## Rekomandime

- MD-ja duhet të ofrojë ndihmë ligjore efikase falas dhe buxhet të nevojshëm për çështje ku përfshihen fëmijë dhe kërkohet drejtësi. MD-ja, në bashkëpunim me KLGJ-në, duhet të krijojë një sistem të menaxhimit të çështjeve të drejtësisë për të mitur për të ofruar të dhëna të unifikuara nga sistemi, informacion mbi vazhdimësinë/progresin e çështjeve të drejtësisë për të mitur, si dhe kërkim dhe studime të orientuara.
- MD-ja (si autoriteti kryesor që merret me çështjet e drejtësisë për të mitur, në bashkëpunim me OSHC-të dhe institucionet e tjera shtetërore të fushës) duhet të miratojë një sistem të unifikuar treguesish dhe standardesh për qasjen e të miturve në institucionet e drejtësisë, duke përfshirë institucionet administrative dhe gjykatat e të gjitha niveleve, për të qenë në gjendje të ndjekin dhe të zhvillojnë një sistem performance lidhur me sistemin e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri.
- MD-ja duhet të finalizojë legjislacionin dytësor dhe të zhvillojë një qasje ndërsektoriale me të gjitha strukturat e përfshira për mbrojtjen e të drejtave të drejtave të fëmijëve.
- MD-ja, OSHC-të dhe institucionet e tjera shtetërore të fushës në nivel kombëtar dhe vendor duhet të vijojnë të rrisin ndërgjegjësimin mbi kuadrin ligjor lidhur me çështjet e drejtësisë për të mitur.

### 13. Organizata: Fondacioni Progres/FP

<b>Titulli i projektit</b>	Trajtimi i veprave penale të kryera nga të miturit përmes drejtësisë cilësore
<b>Qëllimi i projektit</b>	Monitorimi i efikasitetit të gjykatave në Dibër dhe Mat për periudhën 2015-2016, me fokus të veçantë në çështje lidhur me veprat penale të kryera nga të miturit, dhe vlerësimi i cilësisë së vendimeve të gjykatave lidhur me veprat penale të të miturve.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 – shkurt 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Dibër, Mat

#### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi 6 seanca informuese** me palët vendore të interesit (*tre në secilin qytet*) në qytetet e Peshkopisë dhe Burrelit, për të diskutuar mbi situatën dhe kushtet aktuale për të miturit në konflikt me ligjin në këto rrethe, se sa të informuar janë të miturit dhe familjet e tyre mbi të drejtat e tyre, si përparojnë/zhvillohen proceset gjyqësore dhe ku ata mund të kërkojnë ndihmë ose informacion për nevojat e tyre, si mund të përfshihen familjet e tyre për të parandaluar rikryerjen e këtyre veprave penale të të miturve dhe mundësimi i riintegrit të tyre në shoqëri, cili është roli i institucioneve edukuese në këtë aspekt, etj.
- **Hartoi një raport monitorimi** mbi cilësinë e vendimeve të gjykatës për çështje penale të të miturve në gjykatën e rrethit të Tiranës (të gjitha çështjet penale të të miturve u transferuan në Tiranë, për shkak të mungesës së një seksioni të posaçëm dedikuar të miturve në gjykatat e rrethit Dibër dhe Mat, për vitet 2015 dhe 2016). Gjatë vitit 2015, në Dibër u regjistruan 23 çështje të lidhura me autorët e mitur, ndërsa në Mat u regjistruan 15 çështje të tilla, ndërsa gjatë vitit 2016, në Dibër u regjistruan 25 çështje dhe në Mat 10 çështje. Gjetjet e raportit të monitorimit u prezantuan në tryezën e rrumbullakët të organizuar me palët e interesit (*12 pjesëmarrës*) dhe gjatë workshop-it të organizuar me studentët e fakulteteve të drejtësisë, shkencave sociale, ekonomisë, dhe me profesionistë si avokatë, gazetarë, ekspertë socialë, dhe përfaqësues të OSHC-ve (*25 pjesëmarrës*).
- **Zhvilloi një fushatë në median sociale** duke përdorur faqen e Facebook-ut, Twitter-in dhe Instagram-in për shpërndarjen e informacionit mbi projektin.
- **Realizoi dhe transmetoi një video** (*6 minutëshe*), e cila përmbledhonte shkurtimisht projektin dhe gjetjet e tij.

#### Përmbledhje e gjetjeve

- Gjatë monitorimit u vu re se në GjRR Dibër kishte 23 çështje penale të depozituara mbi drejtësinë për të mitur për vitin 2015 dhe 25 për vitin 2016, ndërsa në GjRR Mat 15 çështje për vitin 2015 dhe 10 për vitin 2016.
- Analiza e vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (*për 4 çështje në rrethin e Dibrës dhe Matit gjatë periudhës 2015-2016*), zbuloi se GjRR Dibër dhe Mat:
  - kishin mungesë të seksioneve/gjyqtarëve të specializuar për çështjet e të miturve;
  - zbulonin identitetin e fëmijës për publikun/median gjatë gjyqit dhe në vendimet e gjykatave, në shkelje të kërkesave të KDM-së;
  - vendimeve të gjykatës iu mungonte analiza e detajuar e rrethanave sociale dhe emocionale

- të të miturit që kishte kryer veprën penale, dhe nuk ishin arsyetuar ose ishin arsyetuar dobët lidhur me parimet e interesit më të lartë të fëmijës dhe proporcionalitetit. Për më tepër, gjyqtarët morën vendim për dënim me burg të të miturve duke mos zbatuar nenin 52 të Kodit Penal 'Përjashtimi i të miturit nga dënimi' (*u zbatua vetëm në një çështje dhe i mungonte analiza e konstatuar në rrethana*). Vendimet e gjykatës kanë mungesë të analizës së plotë ligjore dhe shqyrtimit të provave, të referencave mbi praktikën gjyqësore/doktrinën ligjore ndërkombëtare lidhur me kriteret ku ato bazoheshin për të analizuar rrezikshmërinë e të miturit, dhe mungesë të analizës së rrethanave të marra në konsideratë në caktimin e masës së dënimit (*duke vendosur thjesht një renditje zyrtare*)
- kishin mungesë të praktikës gjyqësore të konsoliduar (*prandaj ka një mungesë të vendimeve cilësore që duhen marrë si “precedentë” /shembuj ose standard për t’u vendosur në gjykimet ndaj të miturve*).

## Rekomandime

- Shtimi i iniciativave të bashkëpunimit ndërmjet shkollave, organizatave jofitimprurëse/OSHC-ve dhe institucioneve vendore për të organizuar aktivitete ndërgjegjësuese mbi të drejtat e të miturve, qasjen e të miturve në institucionet e drejtësisë, ndihmën ligjore dhe këshillimin psikologjik, përfshirjen e familjeve të tyre për të parandaluar rikryerjen e veprës penale dhe për të mundësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.
- OSHC-të duhet të monitorojnë funksionimin e njësive të mbrojtjes së fëmijës mbi efikasitetin e mbështetjes që ato iu ofrojnë të miturve dhe të ofrojnë rekomandime dhe trajnime për të përmirësuar performancën e tyre.
- OSHC-të duhet të organizojnë trajnime me psikologët, punonjësit socialë dhe mësuesit që merren me të miturit.
- OSHC-të duhet të organizojnë fushata ndërgjegjësuese dhe takime mbi problemet e veprave penale të kryera nga të miturit në shkolla, ku ftohen edhe prindërit, dhe t’i përfshijnë ata në punë vullnetare.
- OSHC-të duhet të kryejnë studime ose analiza për të identifikuar problemet e të miturve që nuk frekuentojnë shkollat.
- KLGJ-ja duhet të marrë në konsideratë mundësinë që të ngrejë seksione për çështjet e të miturve në GjRR Dibër dhe Mat, t’iu mundësojë gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe palëve të tjera të interesit të specializohen në këto çështje dhe të ulë kostot për paditësit dhe të pandehurit.
- KLGJ-ja, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ose institucione të tjera trajnuese kombëtare/ndërkombëtare të çështjes së drejtësisë për të mitur, duhet të organizojë trajnime të specializuara mbi formulimin e vendimit të gjykatës për një rrjedhshmëri dhe arsyetim më të mirë logjik të paraqitjes së fakteve dhe provave, duke paraqitur argumente të bazuara në këto fakte dhe ligj, dhe mbi gjetjen/ose mosgjetjen fajtor (*ose mungesën e fajit*), bazuar në fakte dhe ligj.
- Studiuesit, universitetet ose institucionet e tjera shtetërore të interesuara duhet të kryejnë studime të detajuara mbi çështje të drejtësisë për të mitur.



## 14. Organizata: Antigonea

<b>Titulli i projektit</b>	Një qasje gjithëpërfshirëse në përmirësimin e sistemit të drejtësisë
<b>Qëllimi i projektit</b>	Ofrimi i mbështetjes dhe këshillimit për zbatimin e masave alternative për burgimin e të miturve, përmirësimi i njohurive ligjore rreth ligjeve të reja të ndryshme dhe ndryshimeve ligjore me fokus të veçantë në reformën në drejtësi dhe drejtësinë për të mitur, dhe rritja e efikasitetit dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë për qytetarët.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill 2018 – shkurt 2019
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Gjirokastrë, Përmet, Sarandë

### Aktivitetet kryesore

- **Ofroi këshillim psikosocial** për të miturit gjatë ekzekutimit të masave alternative në Gjirokastrë, Përmet dhe Sarandë (23 çështje).
- **Organizoi 20 seanca informuese** me bashkitë, universitetin, shkollat e mesme në Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Delvinë, Finiq, Dropull. Përveç grupeve të cënueshme, si gratë dhe fëmijët, aktivitetet u ndoqën edhe nga studentë dhe përfaqësues të institucioneve vendore, si përfaqësues të bashkive ose njërive të mbrojtjes së fëmijës, mësues, prindër dhe punonjës policie (516 pjesëmarrës). Për seancat informuese u hartua një paketë materiale informuese për të rritur nivelin e informacionit ligjor për pjesëmarrësit, duke përfshirë informacion mbi KDM-në, të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijës, ndihmën ligjore, të drejtat procedurale të fëmijëve në çështjet civile dhe penale, ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese, këshillimin psikosocial, etj.
- **Hartoi një raport monitorimi** mbi të drejtat e viktimave gjatë gjyqit, me fokus të veçantë te të miturit, bazuar në të dhënat e mbledhura nga monitorimi i 76 gjyqeve/çështjeve penale në tre gjykatat e rrethit, konkretisht GJRR Sarandë, Gjirokastrë dhe Përmet.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Monitorimi nxori në pah një numër të ulët viktimash që morën pjesë në gjyq në dy gjykatat kryesore në jug të Shqipërisë (Sarandë dhe Gjirokastrë). Gjithsesi, edhe në rastet kur ata ishin të pranishëm, ata nuk morën pjesë në mënyrë aktive në gjyq për të kërkuar plotësisht të drejtat e tyre dhe për të deklaruar versionin e tyre të plotë të historisë (vetëm në rastet kur ata përfaqësoheshin nga një avokat, ata merrnin pjesë në mënyrë aktive). Në këto raste, të drejtat e tyre njiheshin dhe pranoheshin nga gjykatat.
- Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët nuk ishin të trajnuar si duhet lidhur me të drejtat e viktimave në proceset gjyqësore (të drejtat procedurale dhe materiale), për të bërë mbrojtjen efikase të të drejtave të tyre.
- Të pandehurit për çështje penale ishin të pranishëm në 74% të gjyqeve. Në rastet kur ata nuk ishin të pranishëm gjatë gjyqit, gjykata emëronte një avokat *ex officio* (në 86% të çështjeve), që do të thotë se ata nuk kishin mundësi të merrnin vetë një avokat.
- Gjithashtu, gjatë monitorimit të 76 çështjeve në tre gjykatat e synuara u vu re prania e psikologut në gjyqet e të miturve (75% të çështjeve), që garanton standardet e parashikuara në parimin

e procesit të rregullt; vetëm në 27% të çështjeve të monitoruara gjykata aplikonte dënime alternative, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, rrezikshmërinë e të pandehurve, etj., që është një fillim i mbarë pas miratimit të Kodit të ri të Drejtësisë për të Mitur, ndërsa për gjyqe/gjykime të veçanta (p.sh. gjykim i shkurtuar, dhe gjykim i drejtpërdrejt në pak raste; në asnjë prej gjykimeve të monitoruara nuk u zbatua marrëveshja për pranimin e fajësisë ose urdhri penal) monitorimi evidentoi aplikim shumë të ulët të dënimeve alternative (4% në Sarandë, 17% në Përmet, dhe 0 në Gjirokastrë), që nënkupton se gjykatat kanë aplikuar gjerësisht procesin e rregullt.

## Rekomandime

- Duhet të ofrohet trajnim i vazhdueshëm për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët lidhur me ndryshimet e reja mbi të drejtat procedurale të viktimave, për ta aplikuar këtë legjislacion me efikasitet, veçanërisht kur përfshihen viktima të mitur, me qëllim minimizimin e dënimeve me burgim. Trajnimet duhet të mbulojnë edhe çështje lidhur me dënimet alternative, që synojnë rehabilitimin dhe riedukimin e të pandehurve, dhe gjykimet e veçanta, si një teknikë e re e parashikuar me legjislacion për të ulur kostot e gjyqit.
- DHKA-ja duhet të përgatisë sa më shpejt që të jetë e mundur listat e avokatëve *ex officio*, të cilët janë trajnuar si duhet mbi çështje të DM-së dhe t'i dërgojë ato pranë gjykatave, në mënyrë që gjyqtarët të caktojnë avokatë të specializuar mbi çështje të DM-së për të mbrojtur të drejtat e të miturve. DHKA-ja duhet të organizojë trajnime periodike mbi çështje të DM-së siç parashikohen në KDM, dhe mbi të drejtat e të miturve gjatë të gjitha fazave të gjyqit (*hetimi paraprak, gjykimi dhe zbatimi i vendimit të gjykatës*).
- Punonjësit e policisë, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të trajnohen si duhet për të angazhuar psikologët dhe për të përfshirë prindërit/të afërmit e të miturve (të pandehurve) në konflikt me ligjin gjatë gjithë fazave të gjyqimit, për të garantuar plotësisht mirëqenien dhe interesin e tyre më të lartë.
- Urdhri i Psikologut duhet të organizojë trajnime të vazhdueshme të psikologëve, të cilët ofrojnë shërbimet e tyre gjatë seancave gjyqësore, veçanërisht gjatë seancave që përfshijnë të miturit në konflikt me ligjin.
- Institucionet publike dhe OSHC-të duhet të zhvillojnë fushata ndërgjegjësuese mbi të drejtat e të pandehurve dhe mundësitë potenciale për ndihmë ligjore, për të përmirësuar dhe garantuar plotësisht të drejtat e tyre.

## 15. Organizata: Shoqata e Gazetarëve Profesionalë Rajonalë/ARPJ

<b>Titulli i projektit</b>	Ndikimi i medias në respektimin e Standardeve të të Drejtave të Njeriut nga gjykatat dhe prokuroritë
<b>Qëllimi i projektit</b>	Përmirësimi i qasjes në drejtësi për grupet e cënueshme rrit rolin e medias dhe kapacitetet e saj mbi të drejtat e njeriut, hetimet gjyqësore dhe të drejtën e qytetarëve për informim.
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	prill - dhjetor 2018
<b>Zona e ndërhyrjes</b>	Sarandë, Pogradec, Përmet

### Aktivitetet kryesore

- **Organizoi 3 aktivitete promovuese** për prezantimin e projektit në tre qytetet e synuara (57 pjesëmarrës).
- **Organizoi 3 workshop-e** në Pogradec, Përmet dhe Sarandë me gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe gazetarë mbi Manualin e të Drejtave të Njeriut si udhëzues i detyrueshëm për punën e tyre të përditshme, dhe mbi ndikimin e medias lidhur me respektimin e të Drejtave të Njeriut (64 pjesëmarrës).
- **Organizoi 3 forume publike** në televizione vendore për të rritur ndërgjegjësimin mbi vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të gjykatës, komunikimin e gjykatës me publikun dhe grupet e cënueshme (27 përfitues të drejtpërdrejtë dhe 3.000 persona me aftësi të kufizuara dhe persona nga komuniteti rom dhe egjiptian të mbuluar si përfitues jo të drejtpërdrejtë)
- **Publikoi 3 kronika gazetareske investigative** mbi çështjet kryesore të diskutuara gjatë workshop-eve lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.
- **Realizoi dhe transmetoi spote televizive** (të transmetuara për një muaj) në tre televizione vendore të qyteteve të synuara mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut nga gjyqtarët dhe prokurorët.
- **Zhvilloi trajnim për gazetarët** lidhur me qasjen që ata kanë për marrjen e informacionit në gjykatë dhe në prokurori, dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në përputhje me nenin 10 të KEDNJ-së (1 seancë, 12 gazetarë).
- **Organizoi 3 workshope** në Sarandë, Përmet dhe Pogradec me personat me aftësi të kufizuara, përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, dhe me kancelarë gjykatash lidhur me cilësinë e komunikimit dhe shërbimeve të gjykatës (94 pjesëmarrës).
- **Hartoi raportin e monitorimit** mbi të drejtat e qytetarëve për qasje në gjykatë/prokurori, qasje në ndihmën ligjore dhe cilësinë e shërbimeve të gjykatës për Sarandën, Pogradecin dhe Përmetin, me fokus të veçantë mbi të drejtën e informimit.

### Përmbledhje e gjetjeve

- Bashkia e Sarandës, Pogradecit dhe Përmetit kanë mungesë zyrash që ofrojnë ndihmë ligjore dhe shërbime ligjore falas.
- Qytetarëve iu mungon informacioni mbi qasjen në institucionet e drejtësisë, si në gjykatë ose prokurori.
- Prokuroritë e Sarandës, Pogradecit dhe Përmetit nuk kanë faqe zyrtare interneti.

- Gjykatat e Sarandës dhe Përmetit nuk kanë një hapësirë/zonë të dedikuar për pritjen e publikut para gjyqit ose për prokurorët.
- Gjykatat e Sarandës, Pogradecit dhe Përmetit i regjistrojnë seancat e tyre në një audiokasetë, por jo gjithmonë ato kanë cilësi të mirë.
- Në gjykatat e Sarandës, Pogradecit dhe Përmetit, si dhe në prokuroritë përkatëse nuk funksionojnë “Gjyqtari i Medias” dhe “Prokurori i Medias”, siç parashikohet me ligj.
- Të intervistuarit në Sarandë, Pogradec dhe Përmet, dhe përdoruesit e gjykatës, (*duke përfshirë opinione dhe kronika televizive*) pohuan se cilësia e shërbimeve të ofruara nga gjykata/prokuroria nuk ishte e kënaqshme (70%), disa ishin pjesërisht të kënaqur (22%) dhe vetëm pak prej tyre deklaruan se ishin të kënaqur (10%). 62% e të anketuarve e morën në kohë njoftimin për gjyq dhe për 77% të të anketuarve, seancat gjyqësore nuk filluan në orën e përcaktuar; të gjithë gazetarët e intervistuar deklaruan se media ishte lejuar të merrte pjesë vetëm gjatë minutave të para të seancës/gjyqit; pas seancave gjyqësore, të gjitha palët e intervistuar mund të merrnin kasetën/CD-në e regjistrimit.

### Rekomandime

- MD-ja duhet të ofrojë ndihmë ligjore efikase falas për qytetarët gjatë proceseve gjyqësore ose në prokurori, për të lehtësuar qasjen e tyre në institucionet e drejtësisë, si dhe të ofrojë mbrojtje ligjore cilësore për qytetarët, siç parashikohet me ligj.
- Gjykatat e Sarandës dhe Përmetit duhet të ristrukturojnë hapësirën e tyre për të akomoduar publikun, palët, avokatët dhe prokurorët.
- KLGJ-ja dhe KLP-ja, në bashkëpunim të ngushtë me gjykatat dhe prokuroritë në *Pogradec, Përmet dhe Sarandë*, duhet të fillojnë të zbatojnë kërkesat ligjore dhe të emërojnë gjyqtarin e medias dhe prokurorin e medias, siç e parashikon ligji, për të lehtësuar informimin e publikut mbi çështje të veçanta me interes dhe mbi aktivitetin e tyre.
- OSHC-të duhet të vijojnë të zhvillojnë aktivitete ndërgjegjësuese për publikun, si dhe trajnime për profesionistët e medias mbi të drejtat e njeriut dhe çështje të tjera ligjore, si gazetaria investigative.

## V. PËRFUNDIME

### PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËNGRANTE MBI QASJEN NË DREJTËSI

Qasja efiçase në institucionet e drejtësisë mbetet ende një sfidë për Shqipërinë, për të gjithë qytetarët, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara, të cilave iu mungojnë burimet financiare ose arsimimi. Komuniteti i gjerë dhe profesionistët e drejtësisë kanë mungesë të informacionit, ndihmës ligjore dhe ndërgjegjësimi të duhur për çështje të mbrojtjes ligjore për viktimat e krimeve, veçanërisht për viktimat e dhunës në familje, trafikimit, etj. Gjithashtu, profesionistët e drejtësisë kanë mungesë informacioni mbi ndryshimet ligjore më të fundit në këto çështje. AQSGJFQDSH-ja mbështeti aktivitete për të rritur rolin e OSHC-ve në adresimin e çështjeve lidhur me qasjen e qytetarëve në drejtësi, si dhe për të kontribuar në realizimin më të mirë të drejtave të njeriut. Pavarësisht mbështetjes së AQSGJFQDSH-së dhe përpjekjeve të institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe OSHC-ve të tjera, mbetet ende shumë për të bërë për të siguruar qasje efiçase në institucionet e drejtësisë për të gjithë qytetarët, veçanërisht për grupet e cenueshme, si personat me të ardhura të ulëta, të miturit, komunitetin rom, personat me aftësi të kufizuara, personat me sëmundje kronike, viktimat e krimeve, etj.

**Ndihma ligjore** - Qytetarëve shqiptarë iu mungon ndihma ligjore efiçase falas e ofruar nga shteti (*parësore dhe dytësore*), veçanërisht në zonat e thella. Deri më tani, ndihma ligjore falas është ofruar kryesisht nga OSHC të specializuara, veçanërisht për kategoritë e marginalizuara (*me të ardhura të ulëta, personat me aftësi të kufizuara, me nivel të ulët arsimor, romët, viktimat e dhunës, viktimat e krimeve, etj.*) dhe është kryesisht një iniciativë e nxitur nga donatorët. Institucionet shtetërore nuk janë në gjendje t'i ndihmojnë ose informojnë qytetarët se si të kërkojnë të drejtat e tyre dhe se si mund të përfitojnë nga legjislacioni në fuqi. Pavarësisht miratimit të ligjit të ri për ndihmën ligjore të ofruar nga shteti (*që hyri në fuqi në qershor të vitit 2018*), Ministria e Drejtësisë duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme për ta bërë atë efiçase për të gjitha kategoritë e qytetarëve, veçanërisht për të miturit në konflikt me ligjin ose në kontakt me ligjin, dhe komunitetet e marginalizuara, duke siguruar buxhetin dhe stafin e nevojshëm të trajnuar. Trajnimet, workshop-et dhe aktivitetet ndërgjegjësuëse duhet të organizohen nga institucionet shtetërore dhe OSHC-të e specializuara në fushën e të drejtave të qytetarëve, si regjistrimi i lindjeve, kujdestaria ligjore, divorci, pensionet, etj. Iniciativat e QSGJFQDSH-së kanë kontribuar në rritjen e qasjes në ndihmën ligjore përmes mbështetjes së OSHC-ve që e ofrojnë atë aktualisht, trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjësuëse, si dhe ngritjes së klinikave të reja ligjore. Këto përpjekje duhet të vijojnë të jenë pjesë e programeve të ardhshme, dhe të mbështeten nga donatorët ose qeveria, për të përmirësuar qasjen në drejtësi.

**Edukimi Ligjor i Publikut** - Publiku nuk është i edukuar mbi çështjet ligjore. Institucionet publike nuk kanë plane konkrete dhe koordinim për ofrimin e tij. ELP-ja është ofruar gjerësisht nga OSHC-të dhe është mbështetur nga donatorët. AQSGJFQDSH-ja mbështeti procesin e hartimit dhe konsultimit të kryer nga OSHC-të anëtare të Koalicionit "Drejtësi për të Gjithë", për miratimin e Strategjisë së ELP-së nga Kuvendi i Shqipërisë. Megjithatë, vendi ka një nevojë të ngutshme për ELP, duke qenë se Shqipëria po i nënshtrohet një reforme ligjore dhe institucionale tërësore mbi gjyqësorin për të luftuar korrupsionin dhe për të vendosur shtetin ligjor. Krahas ELP-së, nevojitet edhe miratimi i Planit të Veprimt dhe vënia në dispozicion e buxhetit për zbatimin e tij nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera përkatëse. Edukimi mbi çështje të edukimit ligjor dhe të drejtave të njeriut duhet të ketë në fokus të veçantë edhe komunitetet e të rinjve, dhe të jetë pjesë e programit të shkollave të tyre dhe e kurrikulave universitare, si një parakusht për qasje më të mirë në institucionet e drejtësisë.

**Drejtësia për të Mitur** - Profesionistët e drejtësisë (*gjyqtarë, prokurorë, avokatë*), stafi i Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës, psikologët, punonjësit socialë dhe qytetarët, veçanërisht në zonat e thella, kanë mungesë informacioni mbi çështje të drejtësisë për të mitur. Ka një përdorim të ulët të masave të drejtësisë restauruese dhe alternativave të ndërmjetësitimit për të miturit në kontakt ose në konflikt me ligjin. Krahas kësaj, fëmijët me prindër të divorcuar përballen edhe me shumë vështirësi për përmbushjen e detyrimeve për ushqim nga ana e prindërve, për shkak të mekanizmave të hartuara dhe zbatuara dobët për ekzekutimin e vendimeve mbi detyrimet për ushqim, si dhe për shkak të prindërve me të ardhura të ulëta ose të papunë, prindërve që jetojnë jashtë vendit, mungesës së qasjes në ndihmën ligjore dhe asistencën psikologjike gjatë gjykimit dhe veçanërisht pas procedurave të divorcit, mungesës së gjyqtarëve të specializuar për çështjet familjare, etj. Aktualisht, programet që ofrojnë asistencë për të miturit dhe fushatat ndërgjegjësuese zhvillohen kryesisht nga OSHC-të, duke qenë se ndihma ligjore shtetërore nuk është ende funksionale. AQSGJFQDSH-ja kontribuoi për rritjen e ndërgjegjësitimit, përmirësimin e shërbimeve dhe zgjerimin e qasjes në institucionet e drejtësisë, alternativat e ndërmjetësitimit dhe programet e riintegritimit për të miturit, duke ofruar ndihmë ligjore, këshillim psikologjik dhe trajnime për profesionistët. Megjithatë, këto aktivitete duhet të vijojnë, në mënyrë që të miturit të përfitojnë vazhdimisht nga avantazhet e këtyre programeve. Institucionet shtetërore përkatëse, veçanërisht Ministria e Drejtësisë, duhet të marrin masa për të konsideruar planifikimin e këtyre shërbimeve lidhur me buxhetin dhe infrastrukturën, dhe më pas të nisin zbatimin e tyre, duke rekrutuar burime njerëzore të trajnuara si duhet, si dhe të bashkëpunojnë ngushtë me OSHC-të që ofrojnë shërbime në këtë zonë.

**Dhuna në familje** mbetet një problem i vazhdueshëm për shoqërinë shqiptare. Viktimave të dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht në zonat rurale, nuk iu ofrohet asistencë ligjore dhe psikologjike. Gjithashtu, mësuesve iu mungojnë aftësitë dhe trajnimet se si të menaxhojnë situatat kur fëmijët përjetojnë dhunë në familje. Pavarësisht përpjekjeve të deritanishme për të rritur ndërgjegjësimin, për të ofruar ndihmë ligjore, asistencë psikologjike dhe për të trajnuar profesionistët, ka ende një nevojë të ngutshme që institucionet shtetërore, veçanërisht Ministria e Drejtësisë, të ofrojnë ndihmë ligjore efikase falas, të organizojnë trajnime dhe fushata të mëdha ndërgjegjësuese për adresimin e çështjeve të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të krimeve, në bashkëpunim me OSHC-të e specializuara në këtë fushë. Kuvendi i Shqipërisë duhet të marrë në konsideratë edhe miratimin e një ligji të ri për mbrojtjen e viktimave të krimeve, bazuar në qasjen miqësore për viktimat, e ndërthurur me kompensimin e përshtatshëm. Aktualisht, raporti i studimit mbi nevojat për hartimin e një ligji të posaçëm për viktimat e trafikimit, i kryer nga OSHC-të e mbështetura nga AQSGJFQDSH-ja, është zyrtarisht pjesë e Planit Kombëtar të Veprimeve për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2018-2020.

**Personat me aftësi të kufizuara** në Shqipëri përballen edhe me pengesa për qasjen në institucionet e drejtësisë dhe në institucionet e tjera administrative për të realizuar të drejtat e tyre, si barazia para ligjit, qasja në dokumente dhe procese gjyqësore, procesi i rregullt, etj. Legjislacioni shqiptar dhe praktika gjyqësore e gjykatave shpesh nuk përputhen plotësisht me standardet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Megjithëse AQSGJFQDSH-ja ofroi mbështetje për adresimin e këtyre çështjeve, duhen mbështetur edhe iniciativat e ardhshme, fillimisht duke rishikuar legjislacionin shqiptar për përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, kurrikulat e shkollave të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës duhet të rishikohen, për të përfshirë informacion specifik mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për të ofruar njohuritë më të mira për profesionistët e drejtësisë, ndërsa një grup pune duhet të inspektojë të gjitha mjediset e gjykatave në Shqipëri për të identifikuar të gjitha elementet që i pengojnë këta persona të kenë qasje në gjykata, si dhe t'i adresojë gjetjet për përmirësim pranë KLGJ-së/KLP-së.

**Të drejtat e pacientëve** dhe qasja e tyre në institucionet e drejtësisë dhe kujdesit shëndetësor pasqyrojnë mungesë besimi, skepticizëm, mungesë informacioni dhe vështirësi në bashkëpunimin me institucionet e tjera të shëndetit publik. Pavarësisht mbështetjes së AQSGJFQDSH-së për të rritur ndërgjegjësimin dhe

për të përmirësuar qasjen në institucionet e drejtësisë për pacientët me sëmundje kronike ose pacientët e tjerë, ka një nevojë për rritje të mëtejshme të njohurive, ndërkohë që nevojitet edhe ndihmë ligjore e specializuar falas për pacientët me sëmundje kronike dhe pacientët e tjerë se si të garantohet e drejta e tyre për kujdes shëndetësor përmes autoriteteve të drejtësisë, si dhe rritje e kapaciteteve të medias për të raportuar shkeljet në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe rritje e ndërgjegjësimit e llogaridhënies së autoriteteve të shëndetit publik.

Edhe **komuniteti LGBTI** përballet me pengesa në qasjen në shërbimet ligjore falas, ata i tremben paragjykimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, shumë të rinj të komunitetit LGBTI “jetojnë në hije” dhe nuk mund të kërkojnë ndihmë ligjore në rast nevojë, ndonjëherë ata nuk kanë mundësi të marrin një avokat për shkak të kostove të larta, dhe besimi i tyre në qeverinë vendore ose në institucionet e drejtësisë është i ulët. Megjithatë, ata i besojnë më shumë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit, dhe shumë më shumë OSHC-ve që punojnë në këtë fushë. AQSGJFQDSH-ja kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e qasjes së komunitetit LGBTI në Shqipëri në institucionet e drejtësisë dhe ato administrative. Megjithatë, institucionet shtetërore, së bashku me OSHC-të e specializuara në këtë fushë, duhet të luajnë një rol më proaktiv për këtë komunitet përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe trajnimeve për promovimin e mënyrave për qasje më të mirë në drejtësi. Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë duhet të promovojë dhe ofrojë ndihmë ligjore falas, duke garantuar mekanizma konkretë për të përfituar prej saj.

**Familjet në gjakmarrje** në Shqipëri nuk përfitojnë ndihmë ligjore falas ose ndonjë lloj tjetër asistence shtetërore, si edukimi i duhur ose ndihma ekonomike. Kultura e hakmarrjes është më e zakonshme se ajo e faljes dhe pajtimit, presioni social është negativ dhe mungon bashkëpunimi midis popullsisë vendase dhe institucioneve të drejtësisë. Deri më tani, këta persona dhe familjet e tyre kanë pasur mbështetje kryesisht nga OSHC-të që ofronin shërbime pajtimi dhe ndërmjetësimi. Megjithatë, nevojitet një program kombëtar pajtimi i fokusuar në drejtësinë restauruese, programet edukative dhe kulturore sistematike bazuar në menaxhimin jo të dhunshëm të mosmarrëveshjeve, edukimin në paqe, respektin për njeriun, garantimin e qasjes në shërbimet bazë (*spitale, mjediset e punë, shkolla, etj.*) dhe krijimin e një fondi kompensimi/mbështetjeje për familjet që janë në zi si rrjedhojë e hakmarrjes.

## **PËRFUNDIMET E PROJEKTEVE TË FINANCUARA ME NËNGRANTE MBI MONITORIMIN E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË**

15 projektet e financuara në kuadër të AQSGJFQDSH-së kryen monitorimin e performancës së gjykatave, ngritjes dhe funksionimit të institucioneve të reja qeverisëse të drejtësisë (*KLGI, KLP, KED*), përcaktimit të mjeteve për monitorimin e integritetit gjyqësor dhe monitorimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur. OSHC-të zbuluan se institucionet e drejtësisë ishin bashkëpunuese si gjatë periudhës së monitorimit ashtu edhe gjatë paneleve të diskutimit mbi gjetjet e tyre dhe mënyrat e përmirësimit të performancës së tyre. Gjetjet e monitorimit të institucioneve të drejtësisë u përcollën mjaft mirë te publiku falë mbulimit të gjerë nga media (*vendore dhe kombëtare*), media sociale, angazhimit të tyre për të shprehur shqetësimet në intervista, fokus grupe, seanca informuese, diskutime mbi monitorimin dhe trajnimet e kryera me profesionistët e drejtësisë për ngritjen e kapaciteteve të tyre mbi çështje gjyqësore. Institucionet e drejtësisë kanë bërë përpjekje për të përmirësuar situatën aktuale, bazuar në gjetjet, rekomandimet dhe praktikën më të mira të ofruara nga OSHC-të. Monitorimi zbuloi se institucionet e drejtësisë (*gjykatat, prokuroritë, Zyrat e Shërbimit të Provës, mjediset e paraburgimit të policisë, etj.*) po përballeshin me vështirësi serioze, si mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare, performanca e dobët e ndërthurur me ngarkesën e madhe të punës dhe mungesën e trajnimit të stafit, mungesën e sallave të gjyqit, mungesën e këndit të

informacionit për informimin e përdoruesve, mungesën e kalendarit të përditësuar të gjyqeve, mungesën e hapësirës së pritjes së palëve, mungesën e faqeve të përditësuara të internetit, mungesën e sistemit funksional të menaxhimit të çështjeve, vonesat e gjyqtarëve në nxjerrjen e vendimeve të arsyetuara të gjykatës, arsyetimin e dobët të vendimeve të gjykatës, infrastrukturën e dobët, kushtet e vështira për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, etj. Gjithashtu, institucionet e drejtësisë e matin zakonisht performancën e tyre nëpërmjet analizës së tyre vjetore individuale. Megjithatë, ato nuk vendosin objektiva/ synime në fillim të vitit për të orientuar aktivitetin e tyre vjetor në vlerësimin e performancës së tyre kundrejt këtyre piketave. Atyre iu mungojnë edhe vlerësimet e jashtme nga këndvështrimi i përdoruesve. Sistemit gjyqësor shqiptar i mungojnë vlerësimet bazuar në treguesit dhe metodologjitë ndërkombëtare, si mjetet e KKEED-së që do të mundësonin jo vetëm informim mbi performancën e tyre, por do të ofronin edhe një platformë të gjërë krahasimi me vendet e tjera evropiane.

Monitorimi i **gjykatave të ndryshme të shkallës së parë** (*Lushnjë, Tropojë, Pukë, Shkodër, Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Vlorë*) nga projektet AQSGJFQDSH evidentoi se shumica dërrmuese e çështjeve të monitoruara ishin mbyllur brenda një kohe të arsyeshme (*brenda 4 muajsh*). Megjithatë, ky nuk është një tregues që paraqet plotësisht performancën e tyre, duke qenë se vetë gjykatat dhe OSHC-të që kryen monitorimin e gjykatave nuk morën në konsideratë çështjet e mbartura nga vitet e mëparshme, çështjet e vazhdueshme që depozitohen, dhe për më tepër as procesin e vetingut (*numër i lartë gjyqtarësh të shkarkuar, vende vakante dhe vonesa të institucioneve të sapongritura në emërimin e gjyqtarëve të rinj*) që e frenoi disi të gjithë sistemin gjyqësor shqiptar. Vetë gjykatat e kishin vlerësuar performancën e tyre çdo vit duke hartuar *Analizën e tyre Vjetore*. Megjithatë, këto të dhëna janë ende në pritje që prej vitit 2017 dhe këtyre dokumenteve iu mungojnë informacione/të dhëna mbi treguesit e standardizuar ose metodologjitë, si mjetet KKEED, informacion që, përveç të dhënave në nivel vendor dhe kombëtar, mund të ofrojë edhe të dhëna për performancën e gjykatës si krahasim me gjykatat/vendet e tjera evropiane. Gjatë monitorimit u vu re mungesë e stafit të gjykatës, mungesë e infrastrukturës së përshtatshme të gjyqësorit që çon në mungesën e solemnitetit të gjykimit, si mungesa e faqes funksionale të internetit që mund të ofrojë informacion mbi aktivitetet e gjykatës, mungesa e sporteleve të informacionit, mungesa e sallave të gjyqit, mungesa e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara dhe e hapësirave të pritjes, probleme me regjistrimin audio dhe sistemin ICMIS (*sistemi i menaxhimit të çështjeve*), vonesa në nxjerrjen e vendimeve të arsyetuara të gjykatës, mungesë e cilësisë së vendimeve të gjykatës, etj. Në këtë aspekt, për suksesin e reformës në vazhdim në gjyqësor është jetike mbështetja ndërkombëtare përmes programeve të specializuara, për të ngritur dhe forcuar aftësitë profesionale mbi standardet ndërkombëtare të gjyqësorit, e ndërthurur me aktivitete monitoruese të nxitura nga donatorët, të zhvilluara nga OSHC-të vendore.

Monitorimi i performancës së **gjykatave administrative** (shkalla e parë dhe apeli) evidentoi performancë të mirë të këtyre gjykatave lidhur me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore (59% e çështjeve ishin mbyllur brenda 1 muaji dhe 26% brenda 2 muajsh), gjyqet ishin shtyrë kryesisht për shkak të kërkesës së palëve (57%) dhe caktimit të ekspertit (26%), gjykata e nxirrte dhe e komunikonte vendimin në të njëjtën datë të seancës së fundit gjyqësore. Megjithatë, ato përballen me një numër të madh çështjesh të mbartura nga vitet e mëparshme, me mungesë të stafit gjyqësor dhe administrativ, mungesë të infrastrukturës së duhur të gjykatës dhe sallave të gjyqit, mungesë të kalendarit të standardizuar të gjyqeve që duhet të publikohet çdo ditë online, mungesë të qasjes së personave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së rampave dhe ashensorëve, etj.

AQSGJFQDSH-ja mbështeti edhe monitorimin e **performancës së ofrimit të shërbimeve administrative të gjykatës**, si një aktivitet mbështetës për gjyqësorin. Zakonisht, gjykatat nuk e vlerësojnë rregullisht performancën e tyre administrative, ato përqendrohen më shumë në aktivitetin gjyqësor sesa në atë administrativ. Gjatë monitorimit të shërbimeve administrative të gjykatës u vu re mosrespektimi i afateve kohore ligjore për ofrimin e shërbimeve, për shkak të volumit të madh të përditshëm të punës, mungesës së stafit, mungesës së sporteleve të informacionit, orëve të kufizuara të



shërbimeve të gjykatës, mungesës së sistemit të menaxhimit të radhës, të monitoruesve në hyrje/hapësirën e pritjes për të ofruar informacion, të trajnimeve veçanërisht për çështje të komunikimit dhe etikës, dhe mungesës së mekanizmit të feedback-ut mbi shërbimet e gjykatës (*pyetësorë/kuti ankesash/anketim*).

Për më tepër, **ICMIS (sistemi i menaxhimit të çështjeve)** nuk është miqësor me përdoruesin, pasi nuk gjeneron statistika dhe në disa raste ka penguar punën e stafit administrativ; faqet e internetit të gjykatës ofrojnë informacion të pakët mbi shërbimet e gjykatës; përdoruesit përballen me nepotizëm që diferencon ofrimin e shërbimit të tyre, pra njerëzit që kanë njohje personale me stafin marrin shërbim më të mirë. Reforma në gjyqësor përfshin edhe iniciativa lidhur me shërbime më të mira administrative të gjykatës, që do të adresohen nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja. Prandaj, nevojitet më shumë mbështetje nga donatorë ndërkombëtarë dhe OSHC për ta ndihmuar stafin e gjykatës në punën e tyre të përditshme, nëpërmjet trajnimeve dhe mbështetjes financiare për infrastrukturë më të mirë, e cila lehtëson qasjen e përdoruesve në gjykatë.

Matja dhe monitorimi i **integritetit gjyqësor** mbetet ende një nga sfidat më të mëdha për sistemin gjyqësor shqiptar. Deri më tani, ka pasur përpjekje për krijimin e mekanizmave sporadike për të matur aspekte të ndryshme të integritetit gjyqësor. Gjithsesi, ato kanë rezultuar të pamjaftueshme dhe të pjesshme, dhe iu mungon panorama e plotë e situatës. AQSGJFQDSH-ja mbështeti iniciativën për të kryer studime dhe shqyrtuar modele të tjera ose standarde ndërkombëtare të parashikuara për të matur integritetin gjyqësor, e cila u përmbyll me hartimin e “Listës së kontrollit të masave mbrojtëse kundër korrupsionit në gjyqësor”, një dokument dedikuar matjes/vlerësimit të performancës së gjyqtarëve në Shqipëri. Lista e kontrollit përmban shtatë tregues kryesorë mbi pavarësinë dhe paanshmërinë, llogaridhënien, transparencën dhe pjesëmarrjen efikase, efikasitetin, kompetencat dhe dedikimin, menaxhimin e brendshëm të gjykatës dhe të personelit jogjyqësor dhe të burimeve (*financiare dhe teknike*) të gjyqësorit. Ajo mundëson matjen e treguesve të performancës së gjykatës, duke përfshirë, ndër të tjera, buxhetin e gjykatës, ndihmën ligjore, stafin gjyqësor, përdoruesit e gjykatës, teknologjinë e informacionit, kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimin e vendimeve. Matja e këtyre elementeve synon të përmirësojë qasjen në gjykata, ta bëjë ofrimin e drejtësisë më efikas, të përmirësojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, të rrisë pavarësinë, drejtësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Aktualisht, ky dokument përfaqëson një model abstrakt të treguesve kolektivë për të mbajtur nën kontroll gjyqësorin, por megjithatë mbetet një gur themeli për matjen e integritetit gjyqësor, i cili do të gjenerojë të dhëna sistematike dhe analiza afatgjata. Lista e kontrollit u pilotua pjesërisht (*vetëm në Gjykatën e Lartë, me tre gjyqtarë në detyrë për shkak të procesit të vetingut*) lidhur me treguesit e performancës dhe arritjeve, dhe nxori në pah se këta tregues ishin përcaktuar me saktësi. Megjithatë, ata mund të shtohen ose ndryshohen në të ardhmen, bazuar në specifikat dinamike të gjyqësorit. Të gjithë treguesit e listës së kontrollit, individualisht ose kolektivisht, mund të përdoren nga institucionet e reja qeverisëse të drejtësisë, si KLGJ-ja, KLP-ja, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, vetë gjykatat dhe OSHC-të, për të matur integritetin gjyqësor. Gjithashtu, aktorët e drejtësisë mund të eksplorojnë qasje të ndryshme metodologjike mbi aktivitetin e tyre të ardhshëm, për të monitoruar dhe matur integritetin gjyqësor.

**Monitorimi i Shërbimit të Provës** evidentoi se masat alternative për dënimet me burgim/alternative (DA) ndryshojnë nga njëri rreth në tjetrin (*p.sh. Tropoja dhe Përmeti kishin aplikuar gjithnjë e më shumë DA-të gjatë periudhës 2015-2017, ndërsa Saranda i përdorte më pak ato*). Aktualisht, nuk ka ligj që rregullon SHP-në në Shqipëri, prandaj Kuvendi i Shqipërisë duhet të miratojë legjislacionin përkatës për të qartësuar rolin e zyrës së SHP-së në prokurori dhe gjykatë, për një shërbim dhe përdorim më të mirë të DA-ve. Për më tepër, ngarkesa e punës e stafit të SHP-së është e lartë për shkak të mungesës së stafit, infrastruktura nuk është e përshtatshme për shkak të buxhetit të kufizuar, stafi nuk është trajnuar mbi çështje profesionale dhe komunikimin/etikën, etj. Shqipërisë i mungojnë studimet mbi efikasitetin e DA-ve të dhëna nga gjyqtarët, mbi shkaqet e rikryerjes së veprës penale ose çështje të tjera lidhur me DA-të, qoftë nga institucionet shtetërore, ose nga OSHC-të. Duke qenë se DA-të sjellin një mendësi të re mbi politikën penale shtetërore,

mbështetja nga donatorë/projekte ndërkombëtare përmes institucioneve të drejtësisë dhe OSHC-ve vendore është e mirëpritur, për të reflektuar standardet më të mira ndërkombëtare dhe teknikat e punës.

**Monitorimi i ngritjes së institucioneve të reja qeverisëse të drejtësisë,** veçanërisht i dy institucioneve kyçe si KLGJ dhe KLP, evidentoi vonesa më të gjata sesa afatet kohore ligjore, për shkak të procesit të vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët dhe moskalimit të vetingut nga këta kandidatë, vështirësive për të gjetur kandidatë që përmbushin kriteret ligjore, procesit të përsëritur të vlerësimit (*fillimisht nga komisionet e posaçme dhe më pas nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit*) për kandidatët jomagjistratë, mungesës së monitorimit të këtij procesi nga shoqëria civile, pengesës nga opozita në përzgjedhjen e kandidatëve jomagjistratë nga Kuvendi dhe shkeljes së etikës gjatë debateve, ndaj ky proces u përmbyll përmes shortit, duke shmangur dialogun konstruktiv dhe anashkaluar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë bazuar në meritë. Vonesat prekën të gjithë qeverinë e gjyqësorit në Shqipëri, duke filluar me vendet vakante në Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe gjykata të tjera për shkak të vetingut, dhe ndikuan në emërimin e magjistratëve që kishin përfunduar Shkollën e Magjistraturës, procedimet disiplinore të ndërmarra nga ish KLGJ-ja, vlerësimin e gjyqtarëve, problematika me transferimin e gjyqtarëve (*gjyqtarë që delegohen/emërohen për periudha të caktuara nga njëra gjykatë në tjetrën*), ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, procesin e transferimit, etj. Aktualisht, KLGJ-ja dhe KLP-ja po përballen me një ngarkesë pune të madhe, mungesë infrastrukture, buxheti, personeli, logjistike, etj.; megjithatë, ato kishin bashkëpunim të frytshëm dhe asistencë nga komisionet ndërkombëtare. Takimet janë mbajtur në një atmosferë proaktive diskutimesh dhe etike, kryesisht në përputhje me kërkesat ligjore. Ato vijojnë të ofrojnë informacion online për publikun (*KLGJ-ja përmes një përmbledhjeje të procesverbalit të zbardhur, KLP-ja përmes një regjistrimi audio të takimeve, ndërsa KED-ka publikon informacion shumë të përgjithshëm dhe të kufizuar, vendime të arsyetuara dobët dhe ndonjëherë të paqarta*). Inspektorati i Lartë i Drejtësisë/ILD-ja nuk është miratuar ende, duke shkaktuar vonesa mbi 2-vjeçare dhe probleme lidhur me inspektimin e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**Monitorimi i sistemit të mbrojtjes ligjore të të miturve** evidentoi mungesë efikasiteti të procedurave gjyqësore dhe të paraburgimit, politika të dobëta të komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun, qendra paraburgimi të mbipopulluara, zbatim të dobët të dënimeve alternative krahasuar me dënimin me burgimin, cilësi të dobët të mbrojtjes ligjore dhe arsytimit të vendimeve të gjykatës, mungesë informacioni mbi ndihmën ligjore falas, mungesë të programeve të rehabilitimit para dhe pas lirimit, mungesë të profesionistëve të specializuar të drejtësisë mbi çështje të drejtësisë për të mitur, të ndërthurura me sistemin jo të ndjeshëm mbi nevojat e veçanta të të miturve për programe të edukimit, kujdesit shëndetësor, shëndetit mendor dhe rehabilitimit. Shumica dërrmuese e iniciativave të deritanishme mbi drejtësinë për të mitur janë ndërmarrë nga OSHC-të, duke qenë se legjislacioni mbi drejtësinë për të mitur është miratuar së fundmi. Megjithatë, autoritetet shtetërore, veçanërisht Ministria e Drejtësisë, duhet të garantojnë vijimësi institucionale në menaxhimin e çështjeve ku përfshihen të mitur dhe të kërkojnë drejtësi, të finalizojnë legjislacionin dytësor dhe të ofrojnë një qasje ndërsektoriale me të gjitha strukturat e përfshira për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Nevojitet një sistem i unifikuar treguesish dhe standardesh për të zhvilluar një sistem të vlerësimit të performancës mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri, dhe një sistem të unifikuar të menaxhimit të të dhënave, i cili ofron informacion mbi çështjet dhe orienton kërkimin/studimet, i ndërthurur me fushatë ndërgjegjësuere dhe programe të zgjeruara trajnimi për profesionistët e drejtësisë, lidhur me çështje të drejtësisë për të mitur.

Pritet që situata aktuale të ndryshojë rrënjësisht me ngritjen dhe funksionimin e plotë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët do të adresojnë të gjitha këto mungesa dhe do të vendosin standarde të unifikuara të matshme mbi performancën për sistemin gjyqësor shqiptar.

## Shtojca 1: Lista e kontakteve të OSHC-ve

Nr.	Emri i organizatës	Pika e kontaktit	Emaili
1	Qendra Psiko-Sociale “Vatra”	Brikena Puka	brikena_puka@yahoo.com
2	Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës	Erinda Bllaca	ebllaca@yahoo.com
3	Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve - AFCR	Rasim Gjoka	rasimgjoka@gmail.com
4	Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (ALTRI)	Eda Nocka	qendra.altri@gail.com
5	Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)	Rajmonda Bozo	rbozo@tlas.org.al
6	Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore	Eriona Haxhia	eriona_haxhia@ipls.org
7	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara	Blerta Cani	adrf@albmail.com
8	Të Ndryshëm dhe të Barabartë	Mariana Meshi	mmeshi@yahoo.co.uk
9	Fondacioni Qendra Evropiane	Ina Xhepa	inaxhepa@euro-centre.eu
10	Njerëz në Fokus	Armelia Barci	armeliabarci@gmail.com
11	Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë (QSNNN)	Hile Curri	shoqata_qsnnn@hotmail.com
12	Komuniteti Papa Xhovani XXIII Shkodër	Mira Prekperaj	progetti@apg23.org ;operazionecolomba.al@ apg23.org
13	MERIDIA	Fernando Antenucci	info.meridiaalbania@yahoo.it
14	YMCA - Young Man Christian Association	Egla Lula	ymcatirana@gmail.com
15	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza	Iris Luarasi	luarasi@gmail.com ;linjakeshillimit@gmail.com
16	Shoqata “Së bashku për Jetën”	Eglantina Bardhi	info@togetherforlife.org.al ;ebardhitgf@yahoo.com
17	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Erida Skendaj	office@ahc.org.al; e.skendaj@ahc.org.al
18	Instituti për Kontratën Shoqërore	Olda Ceta	socialcontractinstitute@gmail.com; oldaceta@gmail.com
19	Qendra Streha	Elvis Popaj	strehalgbt@gmail.com
20	Instituti i Migracionit, Zhvillimit dhe Integritimit	Enkelejt Avdyli	qendrainzhi@gmail.com
21	Qendra për Zhvillim dhe Integrim Demokratik Kukës	Zyrjan Alushi	zyrjanalushi@yahoo.com

22	Qendra për Zhvillimin Komunitar “Sot për të ardhmen”	Fabiola Laco Egro	info@cdc-tff.org; fabiolaegro@gmail.com; fabiola.laco@cdc-tff.org
23	Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale	Drita Braho	cdrw@albmail.com
24	Instituti për Politika të Qëndrueshme	Isijda Sinjari	info@isp-albania.org; isijda.sinjari@isp-albania.org
25	Rrjeti i Grave në Demokraci	Blerina Balilaj Borovina	wdnalbania@gmail.com
26	EDFAT - Qendra Evropiane për Drejtësi, Forum, Asistencë e Trajnime	Lisjona Rrapollari	projects@edfat.org; lisjona.rrapollari@gmail.com
27	Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik	Delina Nano	info@ipsed.al; delina.nano@ipsed.al
28	Fondacioni Progres	Juljan Aga	info@progress.org.al
29	Gazetarët Profesionistë Rajonalë	Fatos Puto	shoq.gazetareve@gmail.com; fatosputo@gmail.com
30	Qendra Kulturore Mediatike Antigonea	Emgjellush Serjani	antigoneafoundation@gmail.com
31	Romano Kham	Brisilda Taco	rromanokham@gmail.com
32	Qendra Lëvizja Rinore Pukë	Lindita Hyseni	lrd.albania@gmail.com; lindita_hyseni@yahoo.com
33	SEEP/OJF Vlorë	Simo Ribaj	albaniaseep@gmail.com
34	Shoqata “Për ju nëna dhe fëmijë” Kukës	Hume Elezaj	perjunenadhefemije@yahoo.com